- **Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Për të adresuar sfidat dhe rreziqet e sigurisë kuantike në nivel global është i rëndësishëm bashkëpunimi ndërkombëtar. Organizmat ndërkombëtare, siç është Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) dhe Interpoli, mund të luajnë një rol kyç në koordinimin e përpjekjeve për të promovuar sigurinë kuantike në nivel ndërkombëtar.
- **Investime në hulumtim dhe zhvillim:** Për të zhvilluar teknologji të reja dhe inovative për mbrojtjen e të dhënave dhe infrastrukturës është e nevojshme të investohet në hulumtim dhe zhvillim për teknologjitë kuantike, përfshirë sigurinë kuantike. Qeveritë, industria private, dhe institucionet akademike mund të bashkëpunojnë për të financuar dhe për të kryer studime dhe zhvillim në këtë fushë.

Përfundime

Duke përfunduar, teknologjia kuantike komplekse dhe inovative, ashtu siç është një përplasje e fortë, me atë klasike dhe koston financiare mund të bëhet një ndërmjetës i fortë i për sigurinë e të dhënave, informacionit dhe transmetimit të tij, si dhe infrastrukturës kritike. Është një mjet që u ofron studiuesve dhe zhvilluesve mundësi për të gjetur mjete, fakte dhe prova për të vërtetuar teoritë kuantive në lidhje me sigurinë. Nga ana tjetër përparimi i kësaj teknologjie mund të ndihmojë në krijimin e pajisjeve jetike për arritjen e qëllimeve akoma më komplekse. Në këtë mënyrë, mundësohet të pranohet bashkë-komunikimi i ndërsjellë midis shkencës dhe ligjeve të fizikës me teknologjinë kuantive, në aftësinë e tyre për të mbështetur zhvillimin te njëra-tjetra.

Është e rëndësishme të theksohet se integrimi efektiv i teknologjisë kuantive në sigurinë e të dhënave, komunikimit, informacionit, shpërndarjes dhe shfrytëzimit nuk duhet të ketë të bëjë thjesht me përdorimin e pajisjeve më të fundit, por edhe me përdorimin e teknologjisë kuantive si një mjet për të përmirësuar përgatitjen e individëve për sfidat dhe krijimin e kapaciteteve intelektuale dhe përdoruesve modern. Besojmë se ky zhvillim nuk do të ketë të ndalur, shkenca premtion shumë për të ardhmen, ashtu si kundër sot inteligjenca artificiale, pra sisteme eksperte që zhvillojnë një dialog me përdoruesin, tani është një fakt.

Bibliografia

1. Daniel Gottesman & Hoi-Kwong Lo “From Quantum Cheating to Quantum Security”
2. J. Preskill, “Battling Dekoherence: The Fault-Tolerant Quantum Computer”
3. B. Schneier, Applied Cryptography (2nd ed., Wiley, New York, 1996)
4. L. K. Grover, “In Proc. of the 28th Annual ACM Symposium on the Theory of Computing (STOC), (ACM Press, New York, 1996).
5. E. Biham, “In Proc. of the 31th Annual ACM Symposium on Theory of Computing” (STOC) (ACM Press, New York, 2000).
6. <https://www.binarysecurity.no/>
7. <https://www.paconsulting.com/insights/what-is-quantum-technology>
8. <http://www.physicstoday.org/pt/vol-53/iss-11/p22.html> c 2000
9. <http://www.odci.gov/csi/books/venona/preface.htm>

Modernizimi i Forcave të Armatosura nën ndikimin gjeopolitik dhe transformimin teknologjik

Kolonel Msc. Hysni GJERGJI,
Shef Departamenti në IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Punimi ka synim të sjellë për lexuesin ushtarak udhëtimin transformues të NATO-s përmes transformimit teknologjik dhe digjital, si faktori kryesor modernizues. Në samitin e Uashingtonit në korrik 2024 u arrit në përfundimin se deri në vitin 2030, modernizimi dhe transformimi digjital i NATO-s do t'i lehtësojë operacionet në shumë fusha të aleancës, duke siguruar ndërveprueshmëri, rritje të ndërgjegjësimit dhe vendimmarrje të bazuar në më shumë të dhëna. Në frymën e zhvillimeve teknologjike përtej vitit 2025, punimi pasqyron qasjen, nivelin dhe rëndësinë që ka pësuar modernizimi i forcave të armatosura, nga luftërat botërore deri në epokën e inteligjencës artificiale.

Ky punim është bazuar në gjetjet më të mira të instituteve të shteteve aleate që përcaktojnë dhe paraqesin parimet e modernizimit të forcave të armatosura, duke prezantuar kuptimin praktik dhe tendencat e së ardhmes së konceptit DOTMLPF-P. Për përgatitjen e këtij materiali shkencor janë bërë hulumtime në rolin e pazëvendësueshëm që kanë pasur disa nga personalitetet më të larta të ushtrisë në shekuj, si, Hans von Seeckt, shef i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë gjermane gjatë Luftës së Parë Botërore, si dhe drejtuesit më të lartë të ushtrisë dhe shtetit amerikan George Marshall, Dwight Eisenhower, George Paton etj.

Modernizimi përmbushet dhe kryhet me sukses, kur iniciativat e digjitalizimit aktual dhe progresiv janë të zbatuara me sukses në të gjithë komponentët e

DOTMLPF-P dhe rrisin aftësinë e FA-ve për të përmbushur misionin e saj. Ky punim do të ndihmojë studentët ushtarakë, kursantët e kolegjit dhe ushtarakët e tjerë të mësojnë dhe të zhvillojnë një kuptim më praktik të modernizimit të ushtrisë nga shembujt historikë deri në kushtet e transformimeve digjitale dhe ndryshimeve gjeopolitike. Për më tepër, trajtimi i mëposhtëm është i vlefshëm në epokën bashkëkohore të çështjeve të paqëndrueshme të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale, të ndërlikuara, si dhe nga kufizimet e burimeve të mbrojtjes.

Parë në këtë kontekst, gjykoj se ky punim do të jetë e dobishme për ushtarakët profesionistë që do të bashkohen në procesin e modernizimit të ushtrisë, si dhe do të ndihmojë në përpjekjen e pandërprerë të MM për të transformuar në mënyrë progresive FA të RSH.

Fjalët kyçe: DOTMLPF-P, NATO, RAND, modernizim, doktrinë, lidhshmëri, trajnim, organizim, elemente kritike.

1. Teoria e modernizimit dhe korniza DOTMLPF-P

Për të ruajtur avantazhin e saj përballë fuqive ushtarake armike, forcat e armatosura të çdo shteti duhet të modernizohen dhe të prodhojnë më shumë aftësi luftarake, trajnime bashkëkohore dhe ndërveprueshmëri përmes operacioneve me shumë domene. Çfarë është modernizimi i forcave të armatosura? Është transformimi progresiv i elementeve kritike me anë të të cilave forca e armatosur përcakton, ndërton dhe vepron sipas kornizës: Doktrina, Organizimi, Trajnimi, Materiali, Udhëheqja dhe Arsimi, Personeli. Në mënyrë të veçantë, modernizimi zhvillohet kur sipërmarrjet e transformimit progresiv, të zbatuara me sukses në të gjithë komponentët DOTMLPF-P, i rrisin aftësitë e FARSH për të përmbushur misionin e saj.

Analiza e këtij përkufizimi të modernizimit dhe e kornizës DOTMLPF-P tregon kohezionin kolektiv për të lehtësuar dialogun në planifikimin dhe ekzekutimin e modernizimit të ushtrisë në rang kombëtar dhe në kuadër të aleancës. Përkufizimi i mëparshëm i modernizimit ndikohej nga literatura mbi teorinë e modernizimit dhe nga të kuptuarit se elementet e kornizës DOTMLPF-P përcaktojnë së bashku se si FA-të zhvillohen dhe veprojnë. Literatura mbi teorinë e modernizimit, në veçanti kontributi i Seymour Lipset¹ dhe WW Rostow², është vlerësuar si jashtëzakonisht i dobishëm dhe me ndikim. Punimet e këtyre dy studiuesve janë thelbësore për teorinë e modernizimit, e cila synon të promovojë të kuptuarit se si evoluojnë shoqëritë njerëzore.

Seymour Lipset, në *Political Man: The Social Bases of Politics*, e shikon dhe

¹ https://cis.ethz.ch/content/dam/ethz/special-interest/gess/cis/cis-dam/CIS_DAM_2015/WorkingPapers/Living_Reviews_Democracy/Wucherpennig%20Deutsch.pdf

² <https://godsonug.files.wordpress.com/2018/09/session-41.pdf>

analizon modernizimin e shoqërive njerëzore në varësi të zhvillimit të demokracisë. Ai shqyrton teoritë tradicionale se si demokracia evoluon në një shoqëri përmes analizës empirike të faktorëve shkaktarë, që janë arsimi dhe ekonomia. Qasja e S. Lipset tregon përdorimin që ne i bëjmë kornizës DOTMLPF-P për të studiuar dhe kuptuar modernizimin e ushtrisë. Ndërsa W.W. Rostow, në librin e tij, *Fazat e rritjes ekonomike*, thekson se shoqëritë modernizohen duke përparuar në disa faza të rritjes socio-ekonomike dhe të ndikuar nga politika. Rostow i identifikon këto faza si: shoqëria tradicionale; kushtet paraprake për periudhën e ngritjes; ngritja; procesi i maturimit; dhe maturimi përfundimtar.

Me teorinë e Rostow, ne mund të kuptojmë dinamikën e shkakut dhe ndikimit që formëson modernizimin e ushtrisë. Teoria e modernizimit e lehtëson analizën intelektuale se si shoqëritë evoluojnë politikisht dhe socio-ekonomikisht. Me kalimin e kohës, teoricienë të ndryshëm kanë identifikuar dhe argumentuar se çfarë e përbën modernizimin e shoqërive njerëzore, duke filluar që nga shkaqet, trajektorja e ndryshimit, fazat e ndryshimit dhe implikimet e faktorëve të tjerë. Megjithatë, ajo që unë vlerësoj të dobishme për rastin e Shqipërisë dhe FA të RSH, është pikëpamja e pranuar përgjithësisht e modernizimit si një tranzicion progresiv, nga e tashmja në të ardhmen të aspekteve të ndryshme, si gjeopolitike, ekonomike, shoqërore, ushtarake etj. Teoria e modernizimit ofron bazën teorike për të kuptuar se FA-të, si pjesë e shoqërisë njerëzore, evoluojnë dhe modernizohen në mënyrë progresive. Korniza e transformimit DOTMLPF-P është një qasje efektive që FA-të, në të gjithë aleancën dhe jo vetëm në Shqipëri, përdorin për të konceptuar, planifikuar dhe zbatuar ndryshimet organizative. Nevojat e modernizimit ose ndryshimit të zbatuara në të gjithë komponentët DOTMLPF-P, do t'i mundësojnë edhe FA të RSH të evoluojë në mënyrë cilësore.

2. Doktrina si tërësia themelore e parimeve dhe nënkomponent i strategjisë ushtarake

Doktrina ushtarake përbëhet nga parime që e drejtojnë planifikimin dhe zbatimin e gamës së misioneve që një degë, armë apo shërbim i caktuar në FA mund të urdhërohet për të kryer. Sipas RAND³-it, doktrina ushtarake është “tërësia themelore e parimeve që udhëheqin FA-të për të përmbushur objektivat e sigurisë kombëtare . Studiuesi i çështjeve ushtarake, Barry R. Posen⁴, e përshkruan doktrinën, si “një nën komponent të strategjisë së madhe që merret në mënyrë eksplicite me instrumentet ushtarake”. Ndërsa strategjia e sigurisë kombëtare është mënyra se si një shtet planifikon të mbrojë veten dhe interesat e tij, doktrina nga ana e saj, e udhëzon se cilat mjete ushtarake

³ <https://www.pbs.org/wgbh/americanexperience/features/nash-rand/>

⁴ <https://www.foreignaffairs.com/authors/barry-r-posen>

të duhura do të përdorë forca e armatosur dhe si do t'i monitorojë ato mjete. Si qasje normative ndaj operacioneve luftarake, doktrina ndikon në strukturën organizative, trajnimin dhe pajisjen e një institucioni ushtarak, por mund të ndodhë e kundërta. Me fjalë të tjera, një komponent i kornizës së modernizimit DOTMLPF-P mund të nxisë modernizimin, ndërsa ndryshimet në aspekte të tjera të kornizës mund të nxisin ndryshime doktrinare. Doktrina nxit modernizimin përmes analizës dhe studimit të konfliktit të mëparshëm, mësimëve të nxjerra, analizës së kërcënimit, kërkesave operacionale, si dhe përmes eksperimentimit në degë të ndryshme të një shërbimi në Forcat e Armatosura.

Gjatë viteve ndërmjet Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, ushtria gjermane ilustroi një rast të ndryshimit doktrinar, i cili nxit modernizimin e ushtrisë. Në Reichswehr⁵, reforma doktrinare buronte nga një analizë dhe studim i përqendruar i luftës, i profesionit të armëve dhe i eksperimentimit të guximshëm. James Corum⁶ shkruan se shtabi i përgjithshëm gjerman kishte traditën më të fortë dhe më të mirë të studimit të luftës në mënyrë kritike, duke ofruar analiza objektive të operacioneve ushtarake. Në përputhje me traditën, oficerët gjermanë studiuuan dhe shkruan gjerësisht jo vetëm mbi sukseset, por edhe mbi gabimet strategjike, operacionale, taktike dhe teknologjike të bëra gjatë Luftës së Parë Botërore.

Shefi gjerman i Shtabit të Përgjithshëm Hans von Seeckt⁷, i emëruar në vitin 1920, besonte se Lufta e Parë Botërore vërtetoi se manovra ishte superiore ndaj fuqisë së zjarrit dhe e përfytyronte luftën e ardhshme si një çështje manovrimi të mekanizuar. Hans von Seeckt fokusoi një pjesë të konsiderueshme të Korpusit të Oficerëve të Ushtrisë në studimin e Luftës së Parë Botërore dhe në eksplorimin e ideve për përmirësimin e doktrinës së manovrimit duke përdorur teknologji të re. Ai emëroi mbi katërqind oficerë me përvojë luftarake, që ishin afërsisht 10 për qind e oficerëve të organizuar në komitete të ndryshme, për të studiuar doktrinën dhe taktikat e Luftës së Parë Botërore. Kjo rezultoi në hartimin e Rregullores së jashtëzakonshme të Ushtrisë, të titulluar “Udhëheqja dhe Beteja me Armët e Kombinuara”. Kjo rregullore ndryshoi fokusin e doktrinës gjermane nga manovra mbrojtëse në atë sulmuese, si dhe reformoi me guxim formacionet, manovrat dhe taktikat e njësisve ushtarake.

Me fjalë të tjera, një forcë (FT, FD, FAj) mund të identifikojë aplikime shtesë më të hollësishme të një inovacioni ekzistues teknologjik, si dhe të zhvillojë doktrinën për të shfrytëzuar aftësitë e këtij zhvillimi inovativ. Ky ishte rasti me teknologjinë e helikopterëve dhe zhvillimin e doktrinës ajrore në ushtrinë

⁵ <https://kids.britannica.com/students/article/Reichswehr/334371>

⁶ <https://securityanddefence.pl/Author-James%20S.-Corum/110229>

⁷ <https://nla.gov.au/nla.cat-vn981506>

amerikane, e cila përdori helikopterë gjatë Luftës së Koresë kryesisht për transport dhe për evakuim mjekësor. Pas luftës së Koresë, u vlerësua se teknologjia e helikopterëve mund të shfrytëzohej për manovra luftarake, përveç mbështetjes logjistike. Në lidhje me këtë, gjeneralletjenant James Gavin⁸, i cili më parë komandonte Divizionin e 82-të Ajror në Luftën e Dytë Botërore, vlerësoi se roli i mbështetjes logjistike të helikopterëve duhet të jetë dytësor, krahasuar me manovrën taktike luftarake. Në përputhje me propozimin, vlerësimin dhe analizën e Gavin, në mars 1955, ushtria amerikane botoi doktrinën që u quajt, *Qarkorja e Trajnimit 1-7: Përdorimi i Aviacionit të Transportit Ushtarak*. Ky botim doktrinar shprehte se roli i “aviacionit të transportit të ushtrisë ishte të lëvizte njësitë luftarake të forcave të armatosura në mënyrë operative nga ajri”.

3. Organizimi, struktura përbashkuese e individëve të ndryshëm për misionin e përbashkët

Komponenti organizativ i kuadrit DOTMLPF-P i referohet burimeve njerëzore, të mbështetura financiarisht brenda një force apo shërbimi, që janë ngritur për të përbushur një mision specifik. Sipas modelit të SHBA, ky komponent i përket një njësie ose elementi të përbashkët me funksione të ndryshme nga një strukturë përmes së cilës individët bashkëpunojnë për të përbushur misionin e përbashkët luftarak.

Ashtu si te doktrina, një ndryshim progresiv në FA mund të nxisë modernizimin në të gjithë kornizën, por ndryshimi mund të burojë dhe nga modernizimi brenda elementeve të tjera të kornizës. Me fjalë të tjera, FA-të ndonjëherë bëjnë ndryshime organizative në personel për të nxitur modernizimin dhe ato do të bëjnë ndryshime organizative në përgjigje të zhvillimeve të doktrinave.

Hans von Seeckt, në kohën që drejtonte shtabin e përgjithshëm gjerman, ndërmoi reforma organizative për të krijuar grupin e talenteve intelektuale të oficerëve, me qëllim modernizimin e ushtrisë përmes përvojës dhe aftësive të tyre teorike dhe ushtarake. Ai përfshiu rindërtimin dhe bashkimin e strukturave vartëse brenda ushtrisë dhe ruajti funksionet thelbësore, jetike për modernizimin e ushtrisë. Megjithatë Traktati i Versajës i kërkonte atij shpërbërjen e Shtabit të Përgjithshëm Gjerman, von Seeckt ruajti stafin e trajnuar dhe i shpërndau në strukturat që ai vlerësonte si të domosdoshme. Seksionet e tjera të Shtabit të Përgjithshëm të vjetër thjesht u transferuan në departamente të tjera, por asnjëherë nuk u hodhën poshtë, si burime njerëzore më shumë vlera.

Në përpjekjet e tij për të shfrytëzuar talentin intelektual në ushtrinë gjermane, Von Seeckt miratoi kriteret intelektuale dhe profesionale për reduktimin e

⁸ <https://www.uso.org/stories/188-james-m-gavin-a-legend-and-a-leader>

forcës në favor të mbajtjes së talenteve të spikatur. Ai këmbëngulte të kishin përparësi anëtarët e Korpusit të Shtabit të Përgjithshëm për shkak të përvojës së tyre në organizimin dhe planifikimin luftarak në vite. Përppjekjet e tij për riorganizim ndihmuan Gjermaninë të modernizohej duke ruajtur dhe përqendruar kapitalin intelektual njerëzor të disponueshëm në transformimin progresiv të doktrinës dhe komponentëve të tjerë të kornizës së modernizimit. Zbatimi i kapitalit intelektual në zhvillimin doktrinar çoi në zhvillimin dhe botimin e doktrinës së titulluar, *Udhëheqja dhe Beteja me Armët e Kombinuara*.

Ky ndryshim në doktrinë solli gjithashtu ndryshime në strukturën e formacioneve të njësive të ushtrisë si dhe rriti aftësinë e tyre të manovrimit, zjarrit dhe inteligjencës. Institucioni e përmirësoi konstruktin e personelit dhe pajisjeve duke rritur sasinë e artilerisë së motorizuar dhe mundësitë për zbulim në thellësi të kundërshtarit, rritjen e artilerisë së lëvizshme, forcat e zbulimit, infrastrukturën e komunikimit dhe avionët e vëzhgimit. Shembujt historikë të luftërave dhe historisë së ushtrive në vite tregojnë se një ushtri mund të bëjë ndryshime progresive organizative për t'u modernizuar, transformuar në komponentët e tjerë të DOTMLPF-P, por mund të nxisë gjithashtu edhe ndryshime në strukturat organizative brenda saj.

Në rastin e FARSH, përvojat dhe mësimet e nxjerra të përmendura më lart duhet të zbatohen në drejtim të mbajtjes në shërbim të oficerëve të trajnuar dhe të talentuar, përtej absurditetit të ligjit për pushtetet dhe autoritetet, që nuk i lejon të dalin në pension. Ekspertiza e oficerëve të veçantë në FARSH nuk mund të krijohet pa përvojë dhe qëndrimi për një kohë të gjatë në shërbimin ushtarak. Cilësia e projekteve, koncepteve, dokumenteve, doktrinave dhe manualeve do të jetë e varur nga ata të cilët i përgatisin.

4. Trajnimi, procesi që vetëm përditësohet dhe asnjëherë nuk përfundon në karrierën ushtarake

Komponenti i trajnimit si komponent i kornizës së modernizimit DOTMLPF-P meriton një vend të rëndësishëm, sepse është integral dhe përbashkues në normalizimin e ndryshimit në komponentët e tjerë. Trajnimi është plotësim i njohurive dhe aftësive që i nevojiten personelit ushtarak për të kryer detyrat e tyre, me qëllim funksionimin me sukses të forcës së caktuar, si dhe përmbushjen e misionit të kësaj force, e cila i nënshtrohet trajnimit. Nuk mund të ketë ndryshim të qëndrueshëm dhe evoluim cilësor në doktrinë, organizim, pajisje ose materiale pa përshtatjen dhe përditësimet e suksesshme të metodave të reja të trajnimit, në përmbushjen e misionit të FARSH. Pamundësia për t'u përshtatur në komponentin e trajnimit do të dëmtojë ndryshimet në doktrinë, organizim dhe pajisje, për shkak të ndikimit në misionin e FA-ve.

Përditësimi dhe evoluimi i trajnimit drejtohet dhe zhvillohet nga ndryshimet

progresive në doktrinë, materiale dhe pajisje. Adaptime të tilla zakonisht kërkojnë që FA të stërviten dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre, bazuar në modele të reja të përcaktuara nga doktrina dhe në pajisjet e reja të prezantuara. Shembull nga historia është rasti i ushtrisë amerikane, e cila për të ruajtur efektivitetin operacional në integrimin e doktrinës air mobile dhe helikopterëve, iu desh të ritrajnonte personelin ushtarak me përshtatje stërvitore, të cilat do të ishin thelbësore për suksesin e njësisë në betejën e vitit 1965 te Lugina e Drangit.

Rëndësia e komponentit “trajnim” ilustruhet në mënyrë të hollësishme nga modernizimi gjerman gjatë periudhës ndërmjet luftërave, 1919-1933. Drejtimi me mision është termi i përdorur për të përshkruar «vendimin e decentralizuar» të drejtimit me mision nga vartësit duke përdorur të ashtuquajturën «iniciativë të disiplinuar» dhe veprim të pavarur. Ushtria gjermane në këtë periudhë trajnoi drejtues ushtarakë në të gjitha nivelet për të menduar dhe gjetur zgjidhje të duhur brenda kornizës të misionit. Përmes kësaj risie udhëheqësit ushtarakë u vlerësuan si burra me mendim, vizion dhe veprim të pavarur si kur japin ashtu edhe kur marrin urdhra. Elasticiteti mendor ishte qëllimi kryesor i oficerëve dhe qasje e re ndaj stërvitjes dhe trajnimit, që do të kërkonte udhëheqës luftarakë dhe vizionarë, të cilët do të merrnin “iniciativën e disiplinuar” për të përmbushur qëllimin e komandantëve të tyre.

Aftësimi dhe trajnimi fizik është një nga fushat për të ruajtur gatishmërinë, rezistencën dhe moralin gjatë stërvitjeve të gjata verore dhe dimërore, në kufijtë e qëndrueshmërisë dhe mbijetesës fizike. Në rastin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mendoj se trajnimi individual poshtë nivelit të kompanisë për të ndërtuar një bazë të fortë njohurish taktike midis drejtuesve të rinj duhet të jetë një nga objektivat e trajnimit të personelit tonë në FA. Programi i trajnimit të njësisë të vogla, skuadrat, togat dhe kompanitë në përputhje me rregulloret e këmbësorisë së aleancës, mendoj se duhet të përshtatet vazhdimisht me ato në Forcat tona Tokësore, veçanërisht. Një nga manualet më të rëndësishme që mendoj se duhet të aplikohet në Akademinë e Forcave të Armatosura, për programet e oficerit të ri, është *Stërvitja në Nivel Taktik*, edhe si përgjigje e luftërave të parregullta dhe hibride të cilat drejtohen dhe ekzekutohen nga formacione të vogla.

5. Materialet dhe revolucionarizimi teknologjik i pajisjeve dhe teknologjisë ushtarake

Komponenti material i kornizës DOTMLPF-P fokusohet në pajisjet e nevojshme që FA-të janë mbështetur për të kryer me sukses misionin e tyre. Ky komponent ka një lidhje të fortë me komponentët e tjerë DOTMLPF-P, gjë që e bën të rëndësishëm vendin e tij në këtë kornizë. Teknologjia dhe revolucionarizimi shkencor i materialeve⁹ ndikojnë në ndryshime në doktrinë, organizim, trajnim

⁹ Kolonel Arben Dhuli, gazeta “Ushtria” 12 korrik 2024.

dhe komponentë të tjerë të kornizës, duke çuar në ndryshime më të gjera dhe institucionale. Siç u theksua më lart, në rastin e ushtrisë amerikane, zhvillimi veçanërisht në teknologjinë e helikopterëve nxiti ndryshime në doktrinën, organizimin dhe trajnimin e personelit me misionin e ri të tij.

Dinamika e lidhjes në komponentin material është ajo ku evolucioni doktrinar formon strategjinë e përmirësimit të pajisjeve ushtarake në një forcë të caktuar apo institucion ushtarak. Si rezultat i ndryshimeve në këndvështrimin doktrinar mbi luftën, është arritur edhe integrimi i teknologjisë ushtarake, si: te tanket, avionët, artileria, teknologjia dhe komunikimi. Teknologjisë i është dhënë një vend parësor në doktrinat operacionale në luftën e re të epokës digjitale në moshën e Chat Gbt.

Më herët këndvështrimi doktrinar mbi luftën e mbështetur në “manovër” në ushtrinë amerikane evoluoi për të përzgjedhur blerjen e pajisjeve, megjithëse u prit me skepticizëm nga disa udhëheqës të ushtrisë së asaj kohe. Eisenhower¹⁰ është një referencë e shkëlqyer edhe për këtë element. Ai komandoi një nga dy brigadat eksperimentale të tankeve në Fort Meade, Maryland, në vitet 1920. Duke shfaqur largpamësi operacionale për të ardhmen e luftës manovruese, Eisenhower besonte se tanket kishin potencial më të madh, për aplikimin e tyre në luftë, sesa thjesht mbështetja e këmbësoresë. Eisenhower dhe Patton¹¹ kundërshtuan doktrinën ekzistuese institucionale që e lidhte zhvillimin e tankeve vetëm me të qenit armë mbështetëse e këmbësoresë.

Kjo doktrinë kishte penguar përmirësimet e tankeve për sa i përket shpejtësisë së lëvizjes në fushën e luftimit ashtu edhe trashësisë së blindimit. Tanket kanë një rol të vlefshëm dhe më spektakolar, kështu që ata duhet të ishin më të shpejtë, që të sulmonin në befasi dhe të mbronin efektivet nga fuqia e zjarrit armik. Duke shfrytëzuar terrenin, ata mund të depërtojnë në pozicionet mbrojtëse të armikut dhe të shkaktojnë konfuzion, duke marrë vijën e parë të armikut, bëjnë të mundur avancim të këmbësoresë, por edhe përparime në pozicionet mbrojtëse. Eisenhower dhe Patton përfundimisht publikuan gjetjet e punës së tyre në revista profesionale, por u qortuan për sfidimin e doktrinës së manovrimit me qendër mbështetjen e këmbësoresë.

Një shembull tjetër se si ndryshimi doktrinar nxiti ndryshime në blerjen e materialeve është edhe përvoja e ushtrisë amerikane në Vietnam. Ushtrisë iu desh të përshtaste doktrinën dhe organizimin për të luftuar në mënyrë efektive në zonat bregdetare të Vietnamit, në jug të qytetit të njohur Saigon. Komanda Luftarake e Ushtrisë Amerikane zhvilloi një koncept për të adresuar sfidën e re

¹⁰ <https://www.airlant.usff.navy.mil/Organization/Aircraft-Carriers/USS-Dwight-D-Eisenhower-CVN-69/Namesake-Dwight-D-Eisenhower/>

¹¹ <https://www.nationalww2museum.org/war/articles/general-george-s-patton-jr-death>

duke përshtatur një brigadë të këmbësisë në një forcë lumore të pajisur me varka dhe armë detare për të kryer operacione lumore të paparashikuar deri në atë kohë.

6. Lidershipi dhe arsimimi, faktorët bazë në përafrimin e njerëzve me sistemet, burimet dhe vizionin e FA-ve

Komponenti i DOTMLPF-P fokusohet në mënyrën se si FA-të edukojnë dhe zhvillojnë liderët e saj në të gjitha nivelet. Lidershipi dhe edukimi janë pjesë përbërëse e modernizimit të ushtrisë, sepse drejtuesit e saj janë përgjegjës si për funksionimin e përditshëm, ashtu edhe për transformimin afatgjatë të FARSH, në rastin tonë. Drejtuesit e lartë të forcave të armatosura ofrojnë drejtim, i cili përfshin përafrimin e njerëzve, sistemeve, burimeve dhe vizionin në nivel FA-je, për t'u fokusuar në aktivitetet e përditshme transformuese. Kolegji i Luftës së Ushtrisë Amerikane e përkufizon udhëheqjen strategjike si “procesin e përafrimit të njerëzve, sistemeve dhe burimeve, duke mundësuar një kulturë të përshtatshme dhe inovative të nevojshme, me qëllim për të fituar avantazh në mjedisin konkurrues”.

Mënyra se si zgjidhen, arsimohen dhe punësohen liderët ushtarakë mbart implikime serioze për suksesin e misionit të FA-ve, si dhe për modernizimin institucional. Kjo është e dukshme në qasjet e të gjitha ushtrive të cilat e kanë zhvilluar atë në epokën e luftërave. Në përpjekjet për modernizim, FA-të lipset që sot krahas cilësisë në arsimin e oficerëve dhe nënoficerëve, me një fokus të veçantë duhet të trajtohet arsimimi teknik dhe teknologjik në fushën e AI. Ushtria profesionale e shekullit të 21-të do ketë nevojë gjithmonë për të promovuar edukimin teknik brenda korpusit të oficerëve dhe nënoficerëve. Ushtria profesioniste shqiptare si pjesë e NATO-s, do të drejtohet nga ushtarakët me shërbim afatgjatë, të kualifikuar qysh në fillim të karrierës së tre të cilët i janë nënshtruar një programi trajnimi të vazhdueshëm dhe të pandërprerë.

Përparimi i karrierës së nënoficerëve është gjithashtu shumë konkurrues në realitetin e sotëm. Duke besuar se e ardhmja e luftërave është ajo e parregullt, e cila zhvillohet kryesisht në nivelin taktik, roli i nënoficerit është rritur së tepërmi. Shembujt në arsimin e udhëheqësve në ushtrinë amerikane theksojnë rëndësinë jetike për modernizimin dhe efektivitetin e misionit me kalimin e viteve. Gjatë karrierës së tij, koloneli Xhorxh C. Marshall¹² zhvilloi reforma të thella arsimore të cilat e ndihmuan ushtrinë amerikane të rriste brezin e udhëheqësve luftarakë, që e drejtuan atë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

¹² <https://marshallcentralbania.org/>

Mandati i reformës Marshall në Shkollën e Këmbësorisë njihet si “reforma Benning”,¹³ sepse ai zbatoi ndryshime në kurrikulën e shkollës, bazuar në një këndvështrim të qartë dhe të saktë mbi karakterin në zhvillim të luftës në dekadat pas viteve 1920. Ai parashikoi që luftërat e ardhshme do të ishin luftëra me manovrueshmëri dhe lëvizshmëri të shpejtë, të mbushura me pasiguri, që do të kërkonin liderë luftarakë që ishin vizionarë, përshtatës dhe krijues. Ai përshtati kurrikulën e shkollës për të nxitur kreativitet tek oficerët duke futur ushtrimet ushtarake që ata duhej të zgjidhnin në të njëjtin nivel me atë që kishte përjetuar në Luftën e Parë Botërore. Ai besonte në trajnimin e oficerëve për të marrë vendime në kohë dhe efektive me pak informacion dhe rrethana të pasigurta.

George Marshall tregoi interes të veçantë në menaxhimin e oficerëve për të siguruar që ushtria të kishte udhëheqjen më të aftë që i nevojitej për të luftuar dhe fituar. Sipas Benjamin Runkle¹⁴, Marshall lloboi në Kongres për një amendament që të tërhiqte shumë oficerë të vjetër në shërbim, intelekti dhe aftësia fizike e të cilëve ai gjykonte se ishin të duhurat në drejtimin e operacioneve luftarake. Marshall krijoi një bord prej gjashtë oficerësh në pension, të udhëhequr nga ish-shefi i shtabit të ushtrisë Malin Craig dhe i ngarkoi ata të rishikonin vlerësimet e efikasitetit të oficerëve më të vjetër. Në gjashtë muajt e parë të tij, paneli tërhoqi në shërbim aktiv nga pensioni 195 kapitenë, majorë, nënkolonelë dhe kolonelë. Në perspektivën e Forcave të Armatosura Shqiptare, gjykoj që duhet të ndiqet e njëjta procedurë me oficerë kryesisht me grada të larta, të dalë në rezervë apo që plotësojnë moshën për të dalë në rezervë, duke i thirrur dhe mbajtur në shërbim aktiv pikërisht për arsye të lidërshiptit dhe edukimit të tyre cilësor.

7. Personeli, si forca e gjallë më e rëndësishme e një force të armatosur

Burimet njerëzore drejtuese janë forca më e madhe e gjallë e ushtrisë. Burimet e duhura njerëzore janë të nevojshme për personelin dhe udhëheqjen e njësisve luftarake dhe organizatave të tjera brenda një force të armatosur. Kjo e bën komponentin e personelit një element jetik të kornizës DOTMLPF-P. Në thelb, funksionimi i përditshëm i një institucioni ushtarak dhe modernizimi afatgjatë i tij, nuk mund të ndodhë pa ushtarakë të mirë dhe punonjës civilë të përkushtuar në radhët e tij. Ky kuptim i elementit të personelit në kornizën DOTMLPF-P çon në shqyrtimin e shqetësimeve të rekrutimit, përdorimit dhe mbajtjes së personelit ushtarak në një treg konkurrues pune.

Ushtria amerikane u përball me sfida të personelit që ishin problematike për t’i kapërcyer udhëheqësit e saj gjatë dy luftërave botërore. Gjenerali Marshall

¹³ <https://www.facebook.com/events/mcginnis-wickham-hall-karker-st-fort-benning-ga-31905/ocs-graduation/1477812052489999/>

¹⁴ <https://advanced.jhu.edu/directory/benjamin-runkle/>

merrej me vështirësitë në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit ushtarak, si kapitalin njerëzor për të mbështetur gatishmërinë dhe modernizimin e ushtrisë. Ai ishte këmbëngulës dhe i disiplinuar në përpjekjet e tij për të përgatitur ushtrinë për luftë, gjë që përkoi me marrjen e detyrës së tij si shef i shtabit të përgjithshëm në shtator 1939. Një nga hapat e para që ndërmori ishte rritja e burimeve njerëzore dhe pajisjeve të ushtrisë, ku përmes takimeve me presidentin dhe anëtarët e kongresit, ai prezantoi në mënyrë bindëse nevojat për përgatitjen e kohës së luftës. Departamenti i Luftës ofroi 3 miliardë dollarë, që e lejoj ushtrinë të blejë artikuj kritikë për një forcë prej dy milionë personel, si dhe të ndërtojë një bazë të industrisë ushtarake të aftë për të furnizuar një forcë totale me personel prej katër milionësh.

Cilësia e jetës është thelbësore për ruajtjen dhe rritjen e moralit të personelit, për të cilën Marshall promovoi edhe një sërë nismash të tjera të një institucioni ushtarak, p.sh., në trajnim. Ky ndryshim në marrjen e personelit lejoi që shërbimi të rekrutonte vetëm vullnetarë që ishin të gatshëm të shërbenin. Ky zhvillim bëri të nevojshme një ndryshim në qasjen e ushtrisë ndaj stërvitjes, pasi qasja ekzistuese e trajnimit, e quajtur Programi i Trajnimit të Ushtrisë (ATP), ishte e orientuar të trajnonte sasi masive të rekrutuarve, për urgjencën e paraqitur. ATP-ja tashmë me vullnetarizmin, kërkonte përshtatje me një qasje të re stërvitore që nuk ishte e fokusuar në trajnimin masiv të ushtarëve, brenda një kohe të shkurtër, por më tepër në trajnimin e sasive më të vogla të ushtarëve për një standard më të lartë të aftësive luftarake dhe fiziko psikologjike.

8. Objektet dhe infrastruktura ushtarake janë jetike për strehim, trajnim dhe gatishmërinë luftarake dhe logjistike

Ky element i kornizës DOTMLPF-P fokusohet në infrastrukturën që mbështet operacionet dhe aktivitetet e përditshme të FA si institucion. Ushtarët dhe jetesa e tyre në garnizone ka prioritet, i cili kërkon ndërtimin e objekteve të përshtatshme në strehimin, trajnimin, arsimin, gatishmërinë logjistike dhe veprimtarinë e përditshme. Është e pamundur të modernizohet FA pa objektet e duhura, gjë që e bën komponentin infrastrukturor, kritik dhe shumë të rëndësishëm për vendin e tij në kuadrin DOTMLPF-P.

Ushtria amerikane shfrytëzoi objektet e saj të mëparshme stërvitore për të zhvilluar ndoshta fushatën më të madhe stërvitore të kohës që u quajtën “Manovrat e Luizianës” të vitit 1941. Ashtu si shumica e stërvitjeve ushtarake të këtij lloji, Manovrat e Luizianës ndihmuan në identifikimin e fushave të përmirësimit të nevojshëm për ushtrinë, si motorizimi por nxorën në pah edhe atributet e performancës dhe potencialin e ardhshëm të drejtuesve të një brezi në rritje oficerësh. Një shembull i këtij potenciali ishte kolonel Eisenhower¹⁵

¹⁵ <https://millercenter.org/president/eisenhower>

me detyrën e Shefit të Shtabit gjatë Manovrave të Luizianës 1941. Ai shkruan se tenda e tij u bë një vend ku njerëzit vinin për t'i besuar shqetësimet e tyre. Kjo ndërthurje e lidërshiptit dhe aftësive ndërpersonale do ta ndihmonte më vonë Eisenhower-in të menaxhonte me sukses marrëdhëniet e punës dhe personalitetet komplekse të vartësve të tij si Komandanti Suprem i Aleatëve në Luftën e Dytë Botërore.

Një shembull për t'u analizuar është “Yuma Proving Ground”¹⁶, e cila është qendra kryesore e testimit të ushtrisë. Ky instalim ka rrezen më të madhe të artillerisë tokësore, ku ushtria bën testime qitje artillerie. Që nga viti 2020, Ushtria amerikane ka përdorur laboratorët e saj superiorë në bashkëpunim me objektet kryesore të testimit në Yuma Proving Ground, për të kryer një fushatë mësimi dhe eksperimentimi të quajtur “Project Convergence”¹⁷. Project Convergence është forca e përbashkët (JF) që eksperimenton me shpejtësinë, rrezen dhe dominimin e vendimeve, për të arritur përputhje dhe informuar mbi konceptin e luftimit të përbashkët dhe komandën dhe kontrollin (C2) e luftës në shumë domene. Ajo aktualisht përdor një sërë angazhimesh të përbashkëta, për të integruar inteligjencën artificiale, robotikën dhe armëve autonome, për të përmirësuar fushën e betejës dhe përsheptuar afatin kohor të vendimmarrjes.

Projekti është infrastrukturë kritike jo vetëm për faktin e modernizimit të vazhdueshëm të Ushtrisë, por edhe për forcën e SHBA-së dhe aleatëve të saj. Suksesi i projektit varet nga zhvillimi, testimi dhe pajisjet e eksperimentimit të institucionit. Kjo nënvizon edhe një herë rëndësinë kritike të elementit infrastrukturor të kornizës DOTMLPF-P për transformimin dhe modernizimin progresiv të FA. Sipas Komandës së Materialeve të Ushtrisë, OIB¹⁸ përbëhet nga objektet teknike dhe një fuqi punëtore e kualifikuar, që ndihmojnë ushtrinë të modernizojë dhe të gjenerojë gatishmëri operacionale përmes mirëmbajtjes dhe riparimit. Ndër këto objekte është “Anniston Army Depot”¹⁹, e cila ofron ekspertizë për automjete të rënda luftarake si dhe armët e kalibrit të vogël.

9. Politika si autoriteti vendimmarrës dhe miratues i planeve të modernizimit

Politika e ka autoritetin dhe mandatin institucional për të miratuar, financuar dhe nxitur modernizimin e ushtrisë. Politika ka rol kyç për të evoluuar dhe menaxhuar komponentët e tjerë të kornizës DOTMLPF-P. Ky rol meriton një vend parësor për politikën në kornizë si dhe nënvizon rëndësinë e tij për modernizimin e ushtrisë. Politikat mund të pengojnë ose nxisin një institucion

¹⁶ <https://home.army.mil/yuma>

¹⁷ <https://www.defense.gov/Spotlights/Project-Convergence-Capstone-4/>

¹⁸ <https://www.army.mil/standto/archive/2022/03/25/>

¹⁹ <https://anad.army.mil/>

ushtarak që e percepton dhe ndërvepron me ambiciet për përmirësim. Për shembull, *Army Acquisition Policy*²⁰ “ drejton kërkimin, zhvillimin, blerjen dhe menaxhimin e ciklit të plotë jetësor të pajisjeve të FA për të përmbushur kërkesat e miratuara në aftësitë luftarake. Kjo rregullore për arsye të politikës që përfshin thelbin e saj, ka përparësi ndaj rregulloreve të tjera të ushtrisë në lidhje me menaxhimin e programeve të blerjes së FA.

Ndryshimet në politikën e blerjes së FA e kanë ndihmuar atë të modernizohet duke i përmirësuar proceset e blerjes së materialeve. Edicioni 2018 i AR 70-1²¹ përfshin iniciativa të reja të blerjeve të cilat përmirësojnë efikasitetin, gatishmërinë, testimin, vlerësimin, integrimin e shkencës dhe teknologjisë në zhvillimin e aftësive dhe fokus më të madh në sigurinë kibernetike. Ndryshimet nga kongresi në politikën ushtarake të SHBA e ndihmuar ushtrinë të përgatitej për të fituar Luftën e Dytë Botërore. Këto ndryshime politikash ndodhën falë përpjekjeve lobuese të drejtuesve të gjeneralit Marshall. Për shkak të këmbënguljes së Marshall, “Shtetet e Bashkuara zbatuan politika të reja për të zhvilluar fuqinë njerëzore, për të ngritur industrinë, për të rritur shpenzimet e mbrojtjes, për të rikthyer fokusin te stërvitjet dhe gatishmëria, si dhe për të zhvilluar plane mobilizimi që do të shërbenin si bazë për përgatitjet e SHBA për luftë.

Marshall inicioi ndryshime politikash që e reformuan burokracinë e ushtrisë, përmirësuan vendimmarrjen e drejtuesve të lartë, pasi kur ai mori detyrën si Shefi i Shtabit të Ushtrisë, vuri re se shtabi i përgjithshëm i Departamentit, ishte bërë joefikas dhe jo operativ. Shumë oficerë kishin akses të drejtpërdrejtë te Shefi i Shtabit, ndërsa krerët e agjencive autonome ruanin privilegjet dhe humbnin kohë dhe energji në mosmarrëveshje të vogla. Pas sulmit japonez në Pearl Harbor, Marshall vërejti: “U deshën ditë të tëra për të marrë një letër vlerësuese nga departamenti i luftës, pasi nuk binin dakord të gjithë me draftin. Marshall ricaktoi një oficer të përgjithshëm, Joseph McNarney si ndërlihdës i cili zvogëloi numrin e individëve me akses të drejtpërdrejtë tek ai, nga gjashtëdhjetë në gjashtë dhe tre komanda të reja, Tokësore, Ajrore dhe Forcat mbështetëse të drejtuar nga gjeneralët Lesley McNair, Hap Arnold dhe Brehon Somervell. Si rezultat i këtij ndryshimi, ushtria tani është në gjendje të aplikojë talentin nga tërësia e kapitalit të saj njerëzor në armët luftarake, e pakufizuar nga normat e vjetra gjinore.

Ky është një shembull i shkëlqyer edhe për FARSH i cili tregon se si ndryshimet e politikave formësojnë mënyrën se si një institucion ushtarak percepton dhe ndërvepron me mundësitë e reja dhe të vazhdueshme për përmirësim.

²⁰ https://www.dami.army.pentagon.mil/site/ARTPC/docs/ar70_1.pdf

²¹ <https://dml.armywarcollege.edu/wp-content/uploads/2024/01/AR-70-1-Adaptive-Acquisition-Framework-2023.pdf>

Gjenerali James McConville²² në 2020 pohoi se modernizimi i Ushtrisë duhet të vazhdojë: “Ne duhet të modernizojmë tani. Nuk ka të bëjë me luftën e fundit, por më mirë. Bëhet fjalë për të fituar luftën e radhës. Për ta bërë këtë, ne duhet të transformohemi.”

Përfundime

- Modernizimi i FA nxit zhvillimin doktrinar përmes inovacionit teknologjik. Përpjekjet për modernizimin e ushtrisë do të vazhdojnë pa ndërprerje dhe gjithmonë gjeneratave të reja të drejtuesve do iu nevojitet përvoja e paraardhësve.
- Ky punim ndihmon brezat e profesionistëve që po hyjnë në strukturat e modernizimit të ushtrisë, për t'i krijuar atyre një kornizë praktike ndihmuese, si dhe për të vijuar përpjekjet e vazhdueshme dhe pandërprera të këtij procesi.
- Analizat e mëparshme të rolit të secilit element të DOTMLPF-P, të plotësuara me shembuj të reformave aktuale ushtarake të epokës digjitale, tregojnë se si modernizimi evoluon nga luftërat e shkuara, konfliktet në zhvillim dhe do të vazhdojë në të ardhmen.
- Fokusimi në një element ose komponent të DOTMLPF-P dhe shpërfillja e të tjerëve nuk këshillohet, sepse mund të shkaktojë një çekuilibër cenues për misionin, sepse elementët e kornizës janë të ndërlidhur dhe plotësues të njëri-tjetrit.
- Modernizimi i FARSH duhet të jetë zhvillimi progresiv i të gjitha elementeve kritike me anë të të cilave institucioni përcakton, ndërton dhe operon nga konteksti aktual, duke parashikuar për transformimin modernizues të ushtrisë së të ardhmes.

Bibliografia

1. “Military Doctrine” RAND, accessed 3 January 2022, <http://www.rand.org/topics/military-doctrine.html>.
2. Corum, *The Roots of Blitzkrieg*, 70.
3. Eisenhower, *At Ease*, 236.
4. Department of the Army, *Yuma Proving Ground*, accessed 3 August 2022.
5. Army Futures Command, “Project Convergence,” accessed 23 January 2023.

²² <https://www.dvidshub.net/video/769441/general-james-c-mcconville-2020-ausa-now-conference>

6. U.S. Army Materiel Command, “Army Organic Industrial Base Modernization Implementation Plan,” *Stand-To!* 25 March 2022.
7. Department of the Army, Army Regulation (AR) 70-1: *Research Development and Acquisition: Army Acquisition Policy* (Washington, DC: U.S. Government Printing Office, 10 August 2018).
8. Sean M. Zeigler et al., *The Evolution of U.S. Military Policy from the Constitution to the Present, Volume II: The Formative Years for U.S. Military Policy, 1898–1940* (Santa Monica, CA: RAND, 2019), 103.
9. Unger, *George Marshall*, 159.
10. Forrest C. Pogue, *George C. Marshall: Ordeal and Hope, 1939–1942* (New York: Viking Press, 1966), 293, as quoted in Unger, *George Marshall*, 159.
11. Unger, *George Marshall*, 160.
12. General James McConville in Rick Maze, “Urgent Push: McConville: ‘We Must Modernize Now,’” *Army Magazine*, 14 January 2021.

Rëndësia e dronëve në zbulimin dhe shuarjen e zjarreve

Kolonel Msc. David RROKU
Zëvendësdrejtor i IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Ky punim do të trajtojë krijimin dhe vlerësimin e një droni zjarrfikës për përgjigje emergjente. Droni ka për qëllim të mbështesë zjarrfikësit në kushte të rrezikshme, veçanërisht gjatë zjarreve në pyje kur afrimi i njerëzve mund të jetë i vështirë dhe i rrezikshëm. Droni ka një kamerë termike (një kamerë me rezolucion të lartë), një rezervuar uji në bord për shuarjen e flakëve me ujë. Për dizajnimin dhe zhvillimin e dronit janë përdorur metodat e avancuara të printimit 3D dhe simulimet kompjuterike. Aftësitë e dronit janë vënë në provë në një mjedis të sigurt dhe rezultatet treguan se sa i mirë është ai për luftimin e zjarreve. Shkrimi vazhdon me një diskutim të përdorimit të mundshëm të dronëve zjarrfikës në menaxhimin e fatkeqësive dhe çështjet që duhet të zgjidhen për të mundësuar përdorimin e tij të sigurt dhe efikas në situata praktike. Droni u krijua kryesisht për të luftuar zjarret; është i pajisur me spërkatës me gaz, uji dhe fikse. Gama e tij e funksionimit e lejon atë të shuajë me sukses flakët në struktura të mëdha dhe të arrijë lartësi të mëdha. Në mjedisin eksperimental, një zonë me bar u dogj qëllimisht dhe ritmi i përhapjes dhe intensiteti i zjarrit u menaxhuan duke ndryshuar shpejtësinë e erës dhe ngarkesën e karburantit. Dronët e përdorur për këtë qëllim kanë kamera infra të kuqe si dhe sensorë tymi. Efektiviteti i dronëve u vlerësua në bazë të prirjes së tyre për të dalluar dhe shuar flakët, si dhe në atë se sa shpejt dhe manovrueshëm mund të lëviznin nëpër rajonin e djegur.

Fjalë kyçe: Dronë, zjarrfikës, pajisje zjarrfikëse, menaxhimi i fatkeqësive.

Hyrje

Ndërsa teknologjia zhvillohet, po krijohen qasje të reja dhe kreative për të trajtuar çështjet dhe për të përmirësuar sigurinë në një sërë sektorësh. Beteja kundër zjarreve është një fushë ku teknologjia ka potencialin të ketë një ndikim të madh. Çdo pajisje që do ta bënte shuarjen e zjarrit më pa rrezik dhe produktive për zjarrfikësit do të ishte e paçmuar.¹

Luftimi i flakëve është një punë e rrezikshme dhe e vështirë. Përdorimi i dronëve është një teknikë inovative që po hulumtohet për shuarjen e zjarrit. Në disa përdorime, duke përfshirë fotografimin nga ajri, shërbimet e dorëzimit, madje edhe operacionet e kërkimit dhe shpëtimit, dronët tashmë janë dëshmuar shumë të dobishëm. Sidoqoftë, përdorimi i dronëve në luftimin e zjarreve është një përdorim shumë i ri dhe i paprovuar. Ndërsa ideja e dronëve të shuarjes së zjarrit është ende në fazën e saj eksperimentale, ka avantazhe të mëdha potenciale. Dronët janë të aftë të pajisen me kamera dhe sensorë që mund të lokalizojnë me shpejtësi dhe saktësi pikat e nxehta dhe vendndodhjet e tjera të mundshme të problemeve. Ato mund të përdoren gjithashtu për të transportuar materiale zjarrfikëse si uji, shkumë, apo edhe kimikate që rezistojnë zjarrin në vendin e zjarrit, të cilat mund të ndihmojnë në shuarjen e flakëve më shpejt dhe me efikasitet².

Përdorimi i dronëve në luftimin e zjarreve mund të kontribuojë gjithashtu në sigurinë e zjarrfikësve. Duke dhënë imazhe nga lart të zjarrit dhe vendndodhjeve aty pranë, dronët mund të ndihmojnë zjarrfikësit të zbulojnë kërcënimet e mundshme dhe t'i shmangin ato. Për më tepër, zjarrfikësit në terren mund të marrin informacion në kohë reale nga dronët, duke u mundësuar atyre të marrin vendime më të informuara se ku për të përqendruar përpjekjet e tyre. Pavarësisht nga avantazhet e mundshme të dronëve zjarrfikës, disa çështje ende duhet të zgjidhen, p.sh., dronët duhet të jenë në gjendje të funksionojnë në situata me temperaturë të lartë dhe të durojnë ekspozimin ndaj zjarreve dhe tymit³.

Përveç kësaj, ata duhet të jenë në gjendje të manovrojnë nëpër mjedise sfiduese si ndërtesat ose pyjet duke shmangur rreziqet. Ka konsiderata shtesë ligjore dhe rregullatore që duhen adresuar. Aktualisht ka kufizime se ku dhe si mund të përdoren dronët në shuarjen e zjarrit, dhe përdorimi i tyre është shumë

¹ K. Valavanis, G. Vachtsevanos, “Aplikacionet UAV”, Në Manualine Mjeteve Ajrore pa pilot. Valavanis Springer: Berlin, Gjermani, vëll. 3, fq. 2639–2641, 2015

² E. Lygouras, A. Gasteratos, K. Tarchanidis, Mitropoulos, A. ROLFER: “Një sistem mbështetës i shpëtimit ajror plotësisht autonom” Mikroproces. Microsyst, vëll. 61, fq. 32–42, 2018

³ J. Tomotani, “Përdorimi i mjeteve ajrore pa pilot në operacionet ekërkimit”, J. Geek Stud, vëll. 2, f. 41–53, 2015

i rregulluar⁴. Por, ndërsa teknologjia vazhdon të rritet dhe të maturohet, parashikohet që këto ligje të bëhen më fleksibël dhe të lejojnë më shumë përdorim të dronëve në operacionet e shuarjes së zjarrit. Në këtë shkrim, do të studiojmë zhvillimi i dronëve zjarrfikës dhe përdorimi i mundshëm i tyre në mjediset reale të shuarjes së zjarrit.

Më poshtë do të trajtojmë problemet teknologjike që duhet të zgjidhen, si dhe konsideratat ligjore dhe rregullatore që duhet të merren parasysh. Sigurisht që do të shikojmë gjithashtu llojet e ndryshme të dronëve zjarrfikës që janë aktualisht në treg, së bashku me avantazhet dhe dizavantazhet e secilit prej tyre⁵. Gjatë gjithë këtij shkrimi, do të jap përditësime mbi zbulimet më të reja në teknologjinë e dronëve të shuarjes së zjarrit dhe do të ndajmë pikëpamjet e profesionistëve në këtë industri. Objektivi është të ofrojmë një pasqyrë të plotë të avantazheve të mundshme të dronëve të zjarrfikësve, si dhe vështirësive që duhet të kapërcehen që kjo teknologji të bëhet realitet.

Ekologjia dhe jetët e njerëzve janë të rrezikuar seriozisht nga zjarret në pyje⁶. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile vlerëson se kohët e fundit janë shtuar zjarret në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe janë djegur me mijëra hektar pyje dhe kullota, si dhe janë rrezikuar shumë shtëpi banimi. Zjarret në pyje po bëhen gjithnjë e më të rënda dhe më të shpeshta, gjë që thekson nevojën për zgjidhje kreative për ndalimin e këtyre katastrofave. Për të rritur efikasitetin dhe sigurinë e operacioneve të shuarjes së zjarrit, përdorimi i dronëve është shfaqur si një alternativë e mundshme⁷. Zjarrfikësit mund të analizojnë situatën, të hartojnë një plan veprimi dhe të ndërmarrin veprime të menjëhershme me përdorimin e dronëve që mund të ofrojnë monitorim dhe mbikëqyrje në kohë reale të zjarrit. Në këtë botim eksperimental, ne përshkruajmë krijimin dhe vlerësimin e një droni zjarrfikës që synon të mbështesë zjarrfikësit në rrethana të rrezikshme. Droni ka një kamerë termike, një rezervuar uji në bord për shuarjen e flakëve me ujë dhe një kamerë me rezolucion të lartë.

1. Mënyra e kërkimit

Në luftën kundër zjarreve dhe zjarreve të tjera në shkallë të gjerë, dronët e shuarjes së zjarrit janë një mjet vendimtar. Këta dronë mund t'i ofrojnë personelit

⁴ E. Lygouras, A. Gasteratos, K. Tarchanidis, Mitropoulos, A. ROLFER: “Një sistem mbështetës i shpëtimit ajror plotësisht autonom,” Mikroprocesi. Microsyst, vëll. 61, fq. 32–42, 2018

⁵ A. Carrio, C. Sampedro, A. Rodriguez-Ramos, P. Campoy, “Një përmbledhje e metodave dhe aplikimeve të tëmësuarit të thellë për mjetet ajrore pa pilot”, J. Sens, f. 1–13, 2015

⁶ E. Petritoli, F. Leccese, L. Ciani, “Analiza e besueshmërisë dhe emirëmbajtjes së mjeteve ajrore pa pilot”, Sensorët, vëll. 18, f. 56-71, 2018.

⁷ S. Saponara, “Sistemet e ndjeshmërisë dhe lidhjes për drejtimin e asistuar dhe autonome dhe automjetet pa pilot”, Sensors, vëll. 18, f. 19-29, 2018.

zjarrfikës informacione dhe ndihmë jetike, duke i mundësuar atyre të shuajnë flakët me sukses dhe më të sigurt. Një nga avantazhet kryesore të dronëve zjarrfikës është aftësia e tyre për të dhënë të dhëna dhe fotografi në kohë reale nga ajri⁸. Ky informacion mund të ndihmojë për të kuptuar më mirë madhësinë dhe shtrirjen e zjarrit, vendndodhjen e pikave të nxehta dhe vlerësimin e rreziqeve të mundshme ose vështirësitë që lidhen me shuarjen e zjarrit. Dronët mund të përdoren gjithashtu për të ofruar furnizime, të tilla si uji ose parandalues zjarri, në zona që janë të vështira ose të rrezikshme për t'u arritur nga forcat zjarrfikëse⁹. Krijimi dhe përdorimi i dronëve zjarrfikës pengohet nga disa boshllëqe kërkimore. Zhvillimi i teknologjive më të sofistikuar të imazhit dhe sensorëve që mund të ofrojnë informacion më të saktë rreth zjarreve është një fushë thelbësore studimi. Kjo përfshin krijimin e kamerave termike që mund të identifikojnë zonat e nxehta dhe aplikimin e algoritmeve të mësimin të makinerive për të vlerësuar të dhënat e zjarrit në kohë reale¹⁰.

Dështimet e Rusisë në arritjen e qëllimeve të saj. Liderët rusë, përfshirë presidentin Putin, nënvlërësuan aftësitë ushtarake të Ukrainës dhe unitetin e Perëndimit. Edhe pse Rusia fitoi territore të mëdha në fillim, nuk arriti të përmbushë qëllimin e saj për të eliminuar regjimin ukrainas. Supozimi i gabuar se shumica e popullsisë së Ukrainës do të mbështeste një regjim pro-rus ishte një dështim i madh i inteligjencës që çoi në përdorimin e forcës shumë të vogël për të arritur qëllimet e caktuara.

Ofensivat e hershme ruse në Ukrainën lindore arritën të kapnin territor të konsiderueshëm, por përpjekjet për të përparuar drejt Odesës dështuan. Mësimi është se gabimet e agresionit rus në Ukrainë theksojnë kompleksitetin e luftës moderne dhe rëndësinë e inteligjencës së saktë, si dhe ndikimin e mbështetjes ushtarake ndërkombëtare.

Lufta patriotike në Ukrainë dhe ndikimi i korrupsionit në përpjekjet për anëtarësim në NATO. Lufta në Ukrainë ka theksuar problemet e korrupsionit politik dhe administrativ, që kanë ndikuar në përpjekjet e vendit për anëtarësim në NATO. Pushtimi rus ka përkeqësuar ekonominë dhe ka krijuar një krizë humanitare dhe ekonomike globale. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) tregon se korrupsioni në Ukrainë është i përhapur në forma politike dhe burokratike. Korrupsioni politik përfshin devijimin e ndihmës dhe shpërdorimin e fondeve, ndërsa korrupsioni burokratik ndodh në nivele administrative dhe përfshin ryshfetin².

Gjatë luftës, janë shpërthyer raste të shumta korrupsioni, duke përfshirë skandalet që çuan në shkarkimin e zyrtarëve të lartë. Në gusht 2023, presidenti Zelenski pezulloi drejtuesit e zyrave të rekrutimit për shkak të mbi njëqind

² Transparency International, 2009, page 37

rasteve korrupsioni. Këto zhvillime kanë nxitur përpjekje për të luftuar korrupsionin, por ky fenomen mbetet një sfidë për sigurinë dhe përpjekjet për anëtarësim në NATO. Mësimi është se, ndërsa Ukraina ka bërë përparime, lufta ka theksuar nevojën për reforma të vazhdueshme për të parandaluar që korrupsioni të dëmtojë përpjekjet për anëtarësim në NATO.

Diferencat në teknologjitë ushtarake të vendeve të NATO-s dhe ndikimi në rezultatet e luftës në Ukrainë. Pritshmëritë për një revolucion të teknologjisë ushtarake në këtë luftë nuk janë realizuar. Përdorimi i teknologjisë së re nga Rusia dhe Ukraina ka treguar se teknologjitë ekzistuese janë më të rëndësishme në këtë konflikt.

NATO-ja ka ofruar mbështetje për Ukrainën me teknologji që i përshtatet situatës së saj, por mbështetja ka qenë e kufizuar dhe shpesh e vonuar, duke ndihmuar Rusinë të rikuperojë territoret e humbura. Vendet e NATO-s kanë bërë marrëveshje për të krijuar koalicione për mbështetje afatgjatë, duke përfshirë armë dhe municione, për nevoja të menjëhershme dhe fusha kritike si aviacioni dhe mbrojtja ajrore³.

Mësimi është se, ndërsa NATO-ja ka avancuar teknologjinë, efektiviteti i përpjekjeve shpesh është i ndikuar nga vonesat dhe sfidat logjistike. Konflikti shërben si një provë për aftësinë e NATO-s për t'u përshtatur dhe për t'u përgjigjur nevojave ushtarake që ndryshojnë me shpejtësi. "...Megjithatë, përballë armiqtësive të vazhdueshme, është më e rëndësishme të arrihet epërsia teknologjike "këtu dhe tani", e cila u jep një premium inovacioneve që lidhen drejtpërdrejt me situatën në vijën e parë të frontit, sesa vizioneve të largëta të modernizimit⁴.

Impakti i luftës në Ukrainë në ekonominë globale. Lufta në Ukrainë ka shkaktuar ndikime të mëdha në ekonominë globale, duke përfshirë rritjen e çmimeve të energjisë dhe shqetësime për sigurinë ushqimore. Reduktimi i furnizimeve me gaz dhe naftë nga Rusia ka rritur çmimet dhe bllokada detare në Detin e Zi ka ndikuar në furnizimet globale të ushqimit. Mësimi është se lufta ka shkaktuar shqetësime të menjëhershme dhe një sërë sfidash ekonomike globale që do të vazhdojnë për vite. Rritja e çmimeve, inflacioni dhe pasiguria ushqimore reflektojnë pasojat e gjera të konfliktit dhe kërkojnë përgjigje të koordinuara ndërkombëtare për të zbutur ndikimet në popullatat dhe ekonominë e cënueshme.

2.2. Vlerësime në nivel strategjik.

Sigurimi i fitores në Ukrainë si objektiv strategjik global. Rezultatet e luftës në Ukrainë kanë pasur një ndikim të gjerë në aspektin kombëtar dhe

³ The Defense Contact Group of Ukraine, September 2023.

⁴"How the battlefield is changing in Ukraine", Polityka Insign, May 2024.

ndërkombëtar, duke prekur funksionimin e të drejtës ndërkombëtare dhe ruajtjen e rendit global. Kjo luftë kërkon një vizion strategjik për të arritur tre objektiva kryesorë: (1) rivendosjen e kufijve të Ukrainës në vitin 1991, (2) rindërtimin e vendit për të promovuar integrimin perëndimor dhe (3) mbajtjen e Rusisë përgjegjëse për krimet e luftës.

Strategjia për mbështetje ndaj Ukrainës duhet të përfshijë disa aspekte kyçe, si: (1) integrimin e Ukrainës në rendin e sigurisë evropiane, (2) reduktimin e aftësisë së Rusisë për të anashkaluar sanksionet, (3) luftimin e dezinformimit rus, (4) forcimin e demokracisë dhe (5) mbështetje për ekonominë dhe demokracinë e Ukrainës⁵.

Ndërkohë, në aspektin operacional, Rusia fillimisht kishte epërsi në det dhe ajër. Megjithatë, Ukraina ka sfiduar këtë epërsi me strategji të mohimit të detit dhe përdorimin e armëve me rreze të gjatë veprimi. Dronët dhe raketat kanë kufizuar efektivitetin e forcave ruse në det dhe ajër.

Zhvillimet teknologjike dhe ndikimi i tyre në sigurimin e posteve komanduese dhe nyjeve logjistike. Zhvillimet teknologjike, si sistemet autonome dhe armët hipersonike, kanë ndryshuar karakterin e luftës. Në Ukrainë, nyjet logjistike dhe postet komanduese shpesh bëhen objekt i sulmeve të shpejta, duke u shkatërruar në më pak se 24 orë. Dronët dhe inteligjenca artificiale janë bërë mjetet kryesore për këtë qëllim⁶. Një rrjet mbështetës fleksibël dhe i mbrojtur është thelbësor për të siguruar furnizime dhe mirëmbajtje të pa ndërprera. Fitorja në një konflikt të gjatë varet nga qëndrueshmëria dhe aftësia për të rigjeneruar fuqinë luftarake më shpejt se kundërshtari. Ndërveprueshmëria dhe integrimi i forcave dhe kapaciteteve të ndryshme do të përmirësojnë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë në konfliktet e ardhshme.

Në përfundim, investimet kolektive në infrastrukturë dhe trajnim do të forcojnë mbështetje dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Kjo përfshin ndërtimin e kapaciteteve të partnerëve dhe përmirësimin e integritet për të adresuar sfidat e përbashkëta dhe për të rritur forcën kolektive në fushën e betejës. Disa nga përfundimet kryesore të këtij sulmi janë:

- **Suksesi i kufizuar dhe efekti strategjik:** Sukseset në Kursk mund të kenë ndikim të kufizuar në strategjinë e përgjithshme nëse territori i fituar nuk është i qëndrueshëm.
- **Kontrolli i burimeve:** Rusia mund të kompensojë humbjet falë burimeve dhe kapaciteteve strategjike, duke theksuar rëndësinë e menaxhimit të burimeve në një luftë të gjatë.

⁵ The Center for Strategic and International Studies (CSIS) in Washington, D.C., Benjamin Jensen and Elizabeth Hoffman, Maj 15, 2024

⁶ "Theater Sustainment Transformation: Lessons from the Russia-Ukraine War", By Maj. Gen. Ronald R. Ragin and Maj. Christopher G. Ingram, April 23, 2024

- **Sfidat e mbajtjes së territorit dhe strategjia politike:** Mbajtja dhe ruajtja e territoreve të pushtuara është sfiduese dhe mund të ngarkojë burimet e Ukrainës.
- **Politika dhe negociatat:** Suksesi ushtarak mund të përdoret për të shtuar presion në negociatat me Rusinë, por nëse territori i fituar nuk shfrytëzohet siç pritej, mund të humbet mundësia për përfitime në bisedime.
- **Dilemat strategjike:** Mbajtja e territoreve të reja mund të ndikojë në burimet dhe të krijojë dilema strategjike në menaxhimin e forcave, duke ndikuar në operacionet në zona të tjera si Donbas.

2.3. Vlerësime mbi mësimet e nxjerra në nivel operacional.

Konflikti në Ukrainë ka theksuar rëndësinë e Operacioneve me Shumë Fusha (Multi-Domain Operations/ MDO) për Arritjen e Objektivave Strategjike dhe rolin e hapësirës në operacionet ushtarake moderne. MDO përfshin përdorimin e kombinuar të aftësive në tokë, det, ajër, hapësirë dhe hapësirë kibernetike për të arritur objektiva strategjike. Ukraina ka shfrytëzuar këtë qasje për të sfiduar agresionin rus, duke përmirësuar aftësitë e saj në disa fusha kryesore:

a) Fusha Tokësore: Zhvendosja e prioriteteve.

Në vitin e tretë të konfliktit në Ukrainë, aleatët dhe partnerët e Ukrainës po zhvillojnë strategji për të mbështetur Kievin. Deri më 31 janar 2024, më shumë se 118,000 trupa ukrainase janë trajnuar ndërkombëtarisht, duke përfshirë 16,300 ushtarë në bazat e Ushtrisë Amerikane në Gjermani. Këto trajnime përfshijnë përgatitjen në armë të ndryshme dhe mbështetje për formacione dhe artileri. Koalicioni ndërkombëtar për mbështetje të Ukrainës ka krijuar grupe për fushat si forca ajrore, mbrojtja ajrore dhe teknologjia e informacionit. Polonia ka udhëhequr një koalicion të ri për mjetet e blinduara, me synimin për të siguruar platformat dhe municionin e nevojshëm për Ukrainën.

Ndryshimet e mësuara nga ky konflikt po ndikojnë në modernizimin e forcave të armatosura, duke përfshirë zhvillimin e tankeve dhe mjeteve të blinduara dhe rimbushjen e predhave 155 mm. Sistemi i raketave taktike ATACMS dhe dronët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në konflikt. Ndërkohë, janë bërë përmirësime në fushën e tankeve dhe mjetet e blinduara, dhe programi *Future Attack Reconnaissance Aircraft* (FARA) është anuluar në favor të zhvillimit të aftësive pa pilot.

Lufta në Ukrainë ka nxjerrë mësimet të rëndësishme mbi domosdoshmërinë e përdorimit të teknologjive të avancuara dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për të arritur objektivat strategjike në një konflikt shumëdimensional.

b) Fusha Detare: Dronë, bllokada dhe anije të mbytura.

Gjatë vitit të dytë të luftës në Ukrainë, konflikti në domenin detar ka qenë

më i kufizuar, por në muajt e fundit, aktivitetet janë intensifikuar. Ukraina ka demonstruar aftësinë për të përdorur dronë detarë për të goditur rëndë Marinën Ruse, duke fundosur dhe dëmtuar të paktën 20 anije ruse, përfshirë një cisternë në Detin e Zi. Dronët detarë kanë qenë të efektshëm në Detin e Zi për shkak të hapësirës së kufizuar dhe pikave të lehta për t'u monitoruar. Studimet sugjerojnë se Ukraina ka fituar një avantazh asimetrik në përdorimin e dronëve dhe anijeve të vogla pa pilot. Këto taktika mund të aplikohen në zona të ngjashme si Gjiri Persik, por janë më pak të përshtatshme për oqeanin e hapur. SHBA mund të përdorë taktika të ngjashme nëse do të mbrojtë Tajvanin nga një pushtim kinez.

Sipas Jerry Hendrix, ish Kapiten i marinës dhe aktualisht bashkëpunëtor i lartë në Institutin Sagamore me bazë në Indianapolis, “lufta në Ukrainë ka sinjalizuar një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si ne e perceptojmë luftën detare, sepse Ukraina ka demonstruar se ka një avantazh të madh asimetrik në përdorimin e dronëve dhe anijeve të vogla pa pilot, të tilla si Ski Jet me bomba mbi to”⁷.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është fuqia shkatërruese e një bllokade detare. Rusia ka përpjekur të bllokojë eksportet e drithërave ukrainase, duke shkaktuar probleme ekonomike dhe sociale, veçanërisht në Afrikë. Kjo ka nxjerrë në pah varësinë e botës nga qasja e papenguar në det. Një marrëveshje ndërkombëtare e vitit 1936 jep Turqisë kontroll të madh mbi Detin e Zi. Hendrix sugjeron se Turqia mund të kishte parandaluar përshkallëzimin e konfliktit nëse kishte lejuar hyrjen e forcave detarë të SHBA dhe aleatëve në Detin e Zi.

c) Fusha Ajrore: Pavarësisht kërkesave nga Kievi, asetet ajrore mbeten të munguar.

Situata ajrore ka ndryshuar pak nga fillimi i luftës. Avionët rusë dhe ukrainas shpesh fluturojnë ulët për të shmangur zbulimin. Megjithatë, Ukraina ka zgjeruar shtrirjen e saj përmes raketave me rreze më të gjatë, si Storm Shadow britanike dhe raketat ATACMS të SHBA, të cilat janë përdorur për të goditur objekte të rëndësishme ruse.

Dronët po përdoren gjithashtu për sulme të ulëta. Aleatët e NATO-s kanë ofruar mbështetje për mbikëqyrjen ajrore dhe po eksplorojnë përdorimin e balonave aerostat. Ukraina po përgatitet të marrë F-16 Fighting Falcons nga disa vende europiane dhe ka nisur trajnimin e pilotëve.

Mësimet e nxjerra nga konflikti në Ukrainë nënvizojnë nevojën për një forcë ushtarake të mirë trajnuar dhe adaptuese, të mbështetur nga teknologjia

⁷ BREAKING DEFENSE STAFF, on February 23, 2024 <https://breakingdefense.com/2024/02/ukraine-war-turns-2-lessons-learned-and-what-comes-next/>

moderne dhe një logjistikë të fuqishme. Këto mësimë do të ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të forcave ushtarake në Evropë dhe më gjerë, duke theksuar rëndësinë e përgatitjes dhe integritit të teknologjive të avancuara.

2.4. Vlerësime mbi mësimet e nxjerra në nivel taktik.

Mbi bazën e mënyrës si janë zhvilluar luftimet, është konstatuar mungesë në aftësitë profesionale të personelit kryesisht në njohjen e taktikave të këmbëtorisë për luftën statike dhe në llogoreve, të cilat kanë dominuar konfliktin. Në këtë aspekt kërkohet të ketë një trajnim më gjithëpërfshirës për këmbëtorinë, për të përmirësuar aftësitë taktike dhe për të adresuar dobësitë në fushën e betejës. Ndër mësimet kryesore të nxjerra janë:

- **Taktikat e Lëvizjes të NATO-s:** Në këtë konflikt të llogoreve, taktikat që theksojnë lëvizjen nuk janë aq efektive. Lufta është bërë më statike, më shumë si në Luftën e Parë Botërore, sesa në fushatat moderne të “tronditjes dhe frikës”.
- **Aftësitë Taktike të Dobëta:** Shumica e forcave të këmbëtorisë ukrainase kanë aftësi të dobëta taktike, për shkak të stërvitjes të kufizuar përpara vendosjes në vijat e para. Kjo ka çuar në situata të rrezikshme, si lëvizjet e ngadalta që mund të lehtësojnë zbulimin nga armiku.
- **Mungesa e Stërvitjeve Bazë:** Taktikat bazë si pastrimi i bunkerëve mungojnë, pasi linjat ruse të llogoreve janë sofistikuar shumë, me rrjete të gjata kalimesh dhe bunkerësh.
- **Përdorimi i Aftësive për Sulme të Fortifikimeve:** Edhe pse taktikat e luftës së afërt mund të mos aplikohen drejtpërdrejt në terrenin rural të Ukrainës, ato janë të dobishme për sulmet ndaj llogoreve dhe fortifikimeve të armikut.
- **Përmirësimi i Stërvitjes Taktike:** Çdo stërvitje taktike, qoftë e rëndësishme apo jo, do të ndihmonte në zhvillimin e një mendësie taktike dhe në zvogëlimin e rreziqeve në vijat e para.

Mësimi kryesor është nevoja për një trajnim të thelluar të këmbëtorisë, të fokusuar në realitetet e luftës së llogoreve, për të përmirësuar aftësitë taktike dhe për të zvogëluar dobësitë në fushën e betejës.

2.5. Vlerësime mbi mësimet e nxjerra për vendet e vogla, si Shqipëria.

Ruajtja e aftësive të forta dhe elastike të mbrojtjes kombëtare është thelbësore për vendet e vogla evropiane, si Shqipëria, për të frenuar dhe mbrojtur kundër agresionit nga një kundërshtar më i madh si Rusia. Ndër mësimet kryesore të nxjerra për vendet e vogla janë:

Rëndësia e Luftës Asimetrike: Vendet e vogla nuk mund të fitojnë duke

luftuar një luftë konvencionale në kushte të diktuar nga një kundërshtar më të madh dhe më të fuqishëm. Ato duhet të fokusohem në taktikat dhe aftësitë asimetrike për të krijuar dilema për armikun. Kjo përfshin fortifikimin e zonave urbane, shfrytëzimin e teknologjive të avancuara si dronët dhe shmangien e përballjeve të drejtpërdrejta me forcat konvencionale të kundërshtarit.

Nevoja për Thellësi Strategjike dhe Qëndrueshmëri: Vendet që nuk kanë thellësi të konsiderueshme strategjike dhe barriera gjeografike janë të cenueshme ndaj pushtimit të shpejtë nga një fqinj më i madh. Përgatitja e qyteteve dhe infrastrukturës për të qëndruar dhe për t'i rezistuar pushtimit është kritike. Mbajtja e një baze të fortë industriale të mbrojtjes, zinxhirëve të ndryshëm të furnizimit dhe aftësia për të mbështetur një konflikt të zgjatur janë thelbësore për kombet më të vogla evropiane.

Rëndësia e Asistencës së Sigurisë dhe Ndërveprueshmërisë: Ndihma dhe trajnimi ushtarak i jashtëm, si ai dhënë Ukrainës, mund të rrisë ndjeshëm forcën e vendet e vogla që përballen me agresion. Ndërveprueshmëria me aleatët është çelësi. Programet efektive të ndihmës për sigurinë dhe stërvitjet e përbashkëta ndihmojnë në ndërtimin e aftësive dhe qëndrueshmërisë së vendeve partnere.

Në përmbledhje, konflikti në Ukrainë ka treguar se vendet më të vogla duhet të japin përparësi aftësive mbrojtëse asimetrike, të qëndrueshme, elastike dhe të ndërveprueshme për të penguar dhe mbrojtur kundër agresionit të mundshëm nga kundërshtarë më të mëdhenj si Rusia.

3. Disa përfundime për t'u marrë në konsideratë nga eksperiencia e luftës për përmirësimin e sistemit kombëtar të mbrojtjes

Ukraina arriti të qëndrojë e fortë ndaj agresionit rus për shumë ditë, javë, muaj dhe vite, përkundër humbjeve të mëdha në personel dhe dëmeve kolosale në mjete luftarake dhe infrastrukturë. Përveç fuqisë patriotike të treguar nga Forcat e Armatosura të Ukrainës, një faktor i rëndësishëm në këtë rezistencë ka qenë mbështetja konstante e NATO-s, BE-së dhe vendeve anëtare dhe partnere, përfshirë Shqipërinë.

Shqipëria ka qenë e angazhuar që në fillim në mbështetje të Ukrainës dhe luftës së saj të drejtë për mbrojtjen e popullit ukrainas. Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për të fituar mbështetje diplomatike për Ukrainën dhe ka theksuar nevojën për një veprim efektiv shumëpalësh si metoda më e mirë për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, veçanërisht në fushën e paqes dhe sigurisë.

Siguria dhe mbrojtja kombëtare dhe kolektive lidhen me disa faktorë të rëndësishëm:

1. **Rritja e shpenzimeve të mbrojtjes:** Vendet e NATO-s dhe BE-së pritet të rrisin shpenzimet e mbrojtjes në vitet e ardhshme. Edhe pse ka dallime në shpenzimet e mbrojtjes midis shteteve që janë afër konfliktit dhe atyre që nuk janë, investimet në mbrojtje janë në rritje.
2. **Investimet në sisteme dhe platforma të avancuara të armëve:** Shumë vende të NATO-s dhe BE-së po investojnë në sisteme dhe platformat e avancuara të armëve, duke u përpjekur të adresojnë emergjencën e mbrojtjes kombëtare përmes blerjes së teknologjive dhe pajisjeve të avancuara.
3. **Fragmentarizmi i mbrojtjes evropiane:** Mbrojtja evropiane vlerësohet si e fragmentuar, e cila përbën një problem dhe kërkon shpenzime të përbashkëta për t'u eliminuar. NATO dhe BE duhet të punojnë më shumë në forcimin e politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, në hartimin e politikave të reja dhe në rritjen e unitetit ndërmjet vendeve anëtare për të pasur një ndikim më të madh në mbrojtjen e sigurisë dhe paqes.

Përvoja e luftës në Ukrainë ka nxjerrë në pah domosdoshmërinë e zhvillimit të kapaciteteve operacionale për siguri dhe mbrojtje, që mbetet një objektiv kryesor për Aleancën dhe vendet anëtare të saj. Kapacitetet operacionale janë të ndërlydhura me shumë faktorë politikë, ekonomikë dhe teknologjikë, dhe tashmë ekziston një panoramë më e qartë mbi nevojat dhe mundësitë për t'i garantuar ato.

Ndër kapacitetet kryesore që duhet të zhvillohen dhe përmirësohen janë: (1) Kapacitetet e mbrojtjes hibride; (2) Lufta e informacionit; (3) Mbrojtja nga avionët pa pilot; (4) Lufta urbane; (5) Grumbullimi dhe menaxhimi i informacionit; (6) Lëvizshmëria strategjike; (7) Forcat e reagimit të shpejtë; (8) Mbrojtja civile.

Këto kapacitete janë thelbësore për arritjen e suksesit në konflikte të mundshme dhe për përmirësimin e mbrojtjes kombëtare dhe kolektive.

3.1. Ndikimi i luftës në Ukrainë në sigurinë globale.

Lufta e paprovokuar e Rusisë ndaj Ukrainës ka pasur një ndikim të thellë në sigurinë globale, duke dobësuar ndjeshëm stabilitetin ndërkombëtar dhe duke krijuar sfida të reja dhe komplekse për komunitetin ndërkombëtar. Ndikimi i saj ka përfshirë një gamë të gjerë aspektesh të sigurisë globale, ndër të cilat veçohen:

Rritja e tensioneve midis Rusisë dhe Perëndimit: Konflikti ka çuar në një përshkallëzim të tensioneve midis Rusisë dhe vendeve perëndimore (NATO, BE dhe vendet anëtare). Kjo ka përfshirë sanksione ekonomike, manovra ushtarake dhe retorikë të ashpër në nivelet më të larta të drejtimit të palëve respektive.

Kërcënimi bërthamor: Tensionet ekstreme kanë sjellë frikën e një përshkallëzimi bërthamor. Rusia ka përdorur herë pas here retorikën bërthamore dhe ka bërë manovra ushtarake që përfshijnë armë bërthamore, duke rritur shqetësimet për një konflikt të mundshëm.

Ndryshime në marrëdhëniet ndërkombëtare: Lufta ka ndikuar në aleanca dhe partneritete globale, duke shtyrë disa vende të rishikojnë marrëdhëniet e tyre me Rusinë dhe të kërkojnë lidhje të reja strategjike.

Ndryshime në balancën e fuqisë globale dhe roli i aktorëve të tretë: Lufta ka ndikuar në balancën e fuqisë globale, duke sfiduar hegjemoninë perëndimore dhe duke rritur rolin e fuqive të reja si Kina dhe India në arenën ndërkombëtare. Kina, për shembull, ka mbajtur një qëndrim të kujdesshëm, duke ruajtur një balancë midis mbështetjes për Rusinë dhe ruajtjes së marrëdhënieve me Perëndimin.

Sfidat për institucionet ndërkombëtare: Konflikti ka vënë në provë efektivitetin e institucioneve ndërkombëtare si OKB-ja, OSBE-ja dhe Këshilli i Evropës në zgjidhjen e konflikteve dhe ruajtjen e paqes. Këto institucione kanë hasur vështirësi në arritjen e një konsensusi dhe marrjen e masave efektive.

Rritja e bashkëpunimit ushtarak të Perëndimit: Konflikti ka çuar në një rritje të bashkëpunimit ushtarak midis vendeve perëndimore dhe aleatëve të tyre, përfshirë stërvitje të përbashkëta ushtarake dhe ndarjen e inteligjencës.

Ndryshime në politikat e mbrojtjes kolektive dhe sigurisë së vendeve evropiane: Shumë vende evropiane kanë rritur buxhetet e tyre të mbrojtjes dhe kanë rishikuar strategjitë e tyre të sigurisë. NATO gjithashtu ka forcuar praninë e saj në vendet anëtare pranë kufirit me Rusinë.

Rritja e kërcënimeve kibernetike: Lufta ka sjellë një rritje të sulmeve kibernetike, me grupe të lidhura me shtetet që sulmojnë infrastrukturën kritike dhe institucionet qeveritare. Kjo ka theksuar rëndësinë e sigurisë kibernetike në mbrojtjen kombëtare.

Përhapja e armëve dhe materialeve ushtarake: Konflikti ka rritur qarkullimin e armëve dhe materialeve ushtarake në rajon, duke krijuar rrezikun e përhapjes së këtyre armëve në tregjet e zeza dhe te aktorët jo-shtetërorë.

Rritja e nacionalizmit dhe militarizimit: Konflikti ka çuar në rritjen e ndjenjave nacionaliste dhe militarizimit në shumë vende, ndërsa kombet kërkojnë të forcojnë mbrojtjen e tyre kundër kërcënimeve të mundshme.

Kriza e refugjatëve: Lufta ka shkaktuar një valë të madhe refugjatësh, me miliona ukrainas që kanë lënë vendin e tyre për të kërkuar siguri në vendet e tjera evropiane dhe më gjerë. Kjo ka krijuar sfida humanitare dhe logjistike për vendet pritëse.

Ndikimi në tregjet financiare globale: Lufta ka shkaktuar luhatje të mëdha në tregjet financiare globale, duke ndikuar në investime dhe stabilitetin ekonomik. Kjo ka pasur pasoja për ekonominë në zhvillim dhe për tregjet e ndjeshme ndaj çmimeve të lëndëve të para.

Impakti mjedisor: Konflikti ka pasur pasoja mjedisore, përfshirë ndotjen nga luftimet dhe dëmtimet në infrastrukturën kritike, si centralet bërthamore, që mund të kenë efekte afatgjata mbi mjedisin dhe shëndetin publik.

3.2. Ndikimi i luftës në Ukrainë në sigurinë tonë kombëtare.

Ndikimet e luftës së Rusisë në Ukrainë kanë pasur efekte të thella dhe të shumanshme edhe për Shqipërinë, duke prekur sektorë të ndryshëm dhe duke sjellë sfida dhe mundësi të reja për vendin. Ndikimet kryesore janë:

Shqetësimet e sigurisë: Lufta ka dobësuar sigurinë ndërkombëtare, duke sfiduar rendin e sigurisë globale, përfshirë sigurinë tonë kombëtare si aleat i drejtpërdrejtë i NATO-s. Ekzistojnë shqetësime për mundësinë e përgjigjeve më të sigurta nga Rusia në rajone si Atlantiku Jugor, që mund të kërcënojnë stabilitetin e Shqipërisë.

Marrëdhëniet diplomatike: Shqipëria ka dënuar ashpër agresionin e Rusisë kundër Ukrainës dhe është rreshtuar me Perëndimin për të kundërshtuar pushtimin. Shqipëria ka mbajtur një qëndrim të fortë mbështetës ndaj Ukrainës, duke iu bashkuar sanksioneve të vendosura nga Bashkimi Evropian dhe SHBA kundër Rusisë. Kjo ka forcuar marrëdhëniet e Shqipërisë me aleatët perëndimorë, por gjithashtu ka ndikuar në marrëdhëniet me Rusinë.

Bashkëpunimi ushtarak dhe anëtarësimi në NATO: Lufta ka përforcuar angazhimin e Shqipërisë ndaj NATO-s dhe bashkëpunimin me aleatët e saj. Shqipëria ka marrë pjesë në stërvitje të përbashkëta ushtarake dhe ka rritur buxhetin e mbrojtjes për të përmbushur angazhimet e saj ndaj aleancës.

Roli në organizatat ndërkombëtare: Shqipëria, si anëtare e organizatave ndërkombëtare si OKB-ja dhe OSBE-ja, ka pasur mundësinë të kontribuojë në diskutimet dhe vendimmarrjet për zgjidhjen e konfliktit dhe ndihmën për Ukrainën. Kjo ka përforcuar profilin e Shqipërisë si një aktor aktiv dhe përgjegjës në skenën ndërkombëtare.

Siguria kibernetike: Rritja e kërcënimeve kibernetike lidhur me luftën në Ukrainë ka nxitur Shqipërinë të forcojë masat e sigurisë kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën kritike dhe institucionet qeveritare nga sulmet e mundshme.

Ndihma humanitare, migrantët dhe mbështetja ndërkombëtare: Shqipëria ka rritur përfshirjen e saj në ndihmën humanitare për Ukrainën, duke treguar solidaritet përmes ndihmave financiare dhe pranimit të refugjatëve. Vendi ynë gjithashtu ka dërguar pajisje ushtarake në Ukrainë për të mbështetur

mbrojtjen e saj kundër pushtimit rus. Kjo ka rritur imazhin dhe ka përmirësuar reputacionin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, duke forcuar lidhjet me vendet e tjera që mbështesin Ukrainën.

Rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen civile: Lufta ka rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mbrojtjes civile dhe gatishmërinë për emergjencë. Institucionet shqiptare kanë forcuar programet dhe politikat për të përmirësuar reagimin ndaj emergjencave dhe krizave.

Politika e brendshme: Kriza ka nxitur diskutime të reja për politikën e brendshme, përfshirë nevojën për reforma ekonomike dhe diversifikimin e burimeve të energjisë. Qeveria është përballur me sfida të reja në menaxhimin e situatës dhe në sigurimin e stabilitetit ekonomik dhe social.

Ekonomia: Shqipëria ka ndjerë ndikimin ekonomik të luftës, kryesisht përmes rritjes së çmimeve të energjisë, karburanteve dhe ushqimeve. Këto ndryshime kanë sjellë inflacion të lartë dhe kanë prekur fuqinë blerëse të qytetarëve. Shqipëria është shumë e varur nga importet e materialeve jetike, si drithërat dhe vaji, nga vendet e përfshira në konflikt.

Turizmi: Konflikti ka ndikuar në flukset e turizmit, me disa turistë që shmangin Evropën Lindore dhe preferojnë destinacione më të sigurta, si Shqipëria. Kjo ka sjellë disa përfitime ekonomike për sektorin turistik të vendit.

Transporti dhe tregtia: Lufta ka ndërprerë disa rrugë tregtare dhe ka ndikuar në koston e transportit ndërkombëtar. Kjo ka pasur një efekt domino mbi çmimet e mallrave të importuara dhe eksporteve, duke ndikuar negativisht në bilancin tregtar të Shqipërisë.

Investimet e huaja: Pasiguria globale dhe tensionet gjeopolitike kanë ndikuar në vendimet për investimet e huaja direkte në Shqipëri. Disa investitorë mund të jenë më të kujdesshëm në këtë periudhë, duke shtyrë planet e tyre të investimeve për shkak të pasigurisë dhe tensioneve.

Rekomandime

Forcimi i bashkëpunimit me vendet aleate: Forcimi i bashkëpunimit me vendet aleate është kyç për rritjen e kapaciteteve operacionale. Pjesëmarrja aktive në stërvitjet e përbashkëta dhe sigurimi i kapaciteteve operacionale të deklaruara në NATO janë të nevojshme për të mundur ndërveprimin e forcave në të gjitha llojet e situatave.

Konsolidimi i FARSH: Vijimi i konsolidimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) si elementi kryesor i sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare është i rëndësishëm. Ky konsolidim duhet të përfshijë:

✓ *Riformulimin dhe përshtatjen e publikimeve doktrinare: Përditësimi*

i dokumenteve dhe strategjive për të qenë në përputhje me politikat, strategjitë dhe standardet kombëtare dhe ato të NATO-s.

- ✓ **Plotësimin e strukturave me personel dhe programe trajnimi:** Sigurimi i përputhshmërisë me organikën dhe zhvillimi i programeve bashkëkohore për edukim, trajnim dhe stërvitje.
- ✓ **Zhvillimin e programeve të modernizimit:** Investimi në armatime, sisteme, pajisje dhe mjete bashkëkohore dhe të ndërveprueshme për FARSH.
- ✓ **Sigurimin e aftësive të plota operacionale:** Në lidhje me njësitë e reja organizative si regjimentet e këmbësorisë, njësitë kibernetike, forcat rezerviste dhe struktura të tjera të nevojshme.
- ✓ **Vlerësimin e futjes së shërbimit të detyrueshëm:** Përgatitja e koncepteve, politikave, doktrinave, procedurave të veprimit dhe programeve të trajnimit për të siguruar aftësitë e plota vepruese.

Riorganizimi/Rivitalizimi i industrisë ushtarake: Përshtatja e industrisë ushtarake me standardet kombëtare dhe të NATO-s si dhe me zhvillimet teknologjike bashkëkohore të vendeve aleate për të garantuar mbështetje efektive për kapacitetet operacionale.

Evidentimi i infrastrukturës kritike: Identifikimi i të gjithë infrastrukturës kritike dhe zbatimi i një strategjie të qartë për të siguruar ruajtjen dhe mbrojtjen e saj në të gjitha llojet e situatave.

Zhvillimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetike: Investimi në përmirësimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike për të mbrojtur infrastrukturën kritike dhe informacionin ndjeshëm nga sulmet kibernetike.

Krijimi i politikave të sigurisë energjetike: Zhvillimi i politikave për diversifikimin e burimeve të energjisë dhe përmirësimin e kapacitetit të menaxhimit të krizave energjetike për të minimizuar varësinë nga burime të jashtme.

Inkurajimi i bashkëpunimit me institucione akademike dhe kërkimore: Nxitja e bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet kërkimore për të zhvilluar dhe implementuar teknologji dhe inovacione që mund të kontribuojnë në forcimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimit të sigurisë: Forcimi i mekanizmave të komunikimit dhe koordinimit midis institucioneve të ndryshme për të siguruar një përgjigje të shpejtë dhe të koordinuar ndaj kërcënimeve dhe krizave të mundshme.

Bibliografia

1. Two Years in, Russia's War on Ukraine Continues to Pose Threat to Global Security Ted Crous 2023
2. Under-Secretary-General Rosemary A. Dicarlo's Remarks to the security council on maintenance of peace and security of Ukraine. New York, 23 June 2023
3. Ukraine war: What are the impacts on the world today? August 23, 2022
4. What are the global security implications of Russia's invasion of Ukraine? JUN 15, 2022 AMBY PHIL CICIORA |
5. The Russia-Ukraine War's Implications for Global Security: A First Multi-issue Analysis. Thomas Greminger and Tobias Vestner, August 2022
6. Ukraine War: Toward a New Global Security Order, WRITTEN BY Matteo Frigoli and Maurizio Martellini Submitted: 11 October 2022 Reviewed: 08 November 2022 Published: 15 December 2022.
7. Seven ways Russia's war on Ukraine has changed the world, Stuart Coles- 2023
8. The geopolitical impact of the conflict in Ukraine Five trends to help businesses manage the potential risks to global security and prosperity. Stefano Moritsch Global Geopolitics Lead KPMG International
9. How the Ukraine war deepens divisions across the Balkans, By Gaetano Massara On Apr 28, 2022.
10. Antezza et. al., 2022 Grossi & Vakulenko, 2022
11. Transparency International, 2009, page 37
12. Javier Cifuentes-Faura works in the Department of Financial Economics and Accounting at the University of Murcia, Spain, 06 January 2024: <https://doi.org/10.1002/pa.2905>
13. The Defense Contact Group of Ukraine, September 2023.
14. "How the battlefield is changing in Ukraine", Polityka Insight, May 2024.
15. The Center for Strategic and International Studies (CSIS) in Washington, D.C., Benjamin Jensen and Elizabeth Hoffman, Maj 15, 2024.
16. "Theater Sustainment Transformation: Lessons from the Russia-Ukraine War", By Maj. Gen. Ronald R. Ragin and Maj. Christopher G. Ingram, April 23, 2024.
17. International Armoured Vehicles Conference 2024, on June 25-26, 2024 in Austin, TX, United States.
18. BREAKING DEFENSE STAFF, on February 23, 2024. Shih: <https://breakingdefense.com/2024/02/ukraine-war-turns-2-lessons-learned-and-what-comes-next/>
19. Pasojat ekonomike të luftës në Ukrainë dhe ndikimi në agjendën e integritit të Shqipërisë në BE. Herlina Muça, qershor 2022.

Shërbimet e Inteligjencës të PMC¹ dhe PSC², kërcënimi kryesor hibrid rus për Ballkanin Perëndimor

Dr. Drizan SHALA

Lektor në Universitetin e Sarajevës

Trajtesë e shkurtuar. Në këtë punim dua të sjell ekspertizën time të grumbulluar gjatë studimeve të mia, si dhe nga hulumtimet e burimeve zyrtare, në lidhje me transformimet që po ndodhin në shërbimet inteligjente të epokës së inteligjencës artificiale. Për arsye të digjitalizimit të hapësirës botërore dhe nevojës për informacione parandaluese të sigurisë, shërbimet inteligjente kanë evoluar në burime njerëzore profesioniste, ligjshmëri dhe në përsosje teknologjike të lartë.

Zhvillimet gjeopolitike nga njëra anë dhe revolucioni teknologjik i ditëve të sotme nga ana tjetër kanë transformuar shërbimet inteligjente, nga instrumente ligjore të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, drejt strukturave të sigurisë private dhe një biznesi fitimprurës, të pakontrollueshëm, në duar të liderëve totalitarë dhe qëllimeve të tyre.

Kompanitë ushtarake private (Private Military Companies - PMC), në ditët e sotme, përveç aksioneve të fshehta dhe sabotimit ushtarak, po furnizojnë gjithnjë e më shumë, me produkte informative, qeveritë, oligarkët dhe korporatat në fushën e spiunazhit industrial.

¹ PMC - Private military companies

² PSC - Private security companies

Këto shërbime inteligjente private (PSC) rrezikojnë ta futin inteligjencën institucionale në një pikë gjysmë të errët, larg nga kontrolli, llogaridhënia dhe mbikëqyrja e nevojshme demokratike. Risi e viteve të fundit është gërshetimi dhe ngritja e inteligjencës në kompanitë private ushtarake, si industri e cila përfshin si aktet individuale të mercenarizmit, ashtu edhe spiunazhin korporativ, i cili është shumë i avancuar, i mirëpaguar dhe i legjitimuar në shumicën e shteteve.

Në punimin tim dua të asistoj lexuesin ushtarak jo vetëm me informacion njohës dhe profesional, lidhur me këtë fenomen të ri dhe sfidues, por gjithashtu edhe të paralajmëroj për rreziqet dhe kërcënimet në fushën e sigurisë e të mbrojtjes. Përdorimi i “ushtrive pa flamur” bëhet me qëllim që të shmanget përgjegjësia shtetërore e shtetit sponsor të tyre, përballë të drejtës ndërkombëtare për krime lufte.

Fjalët kyçe: Kontraktor Privat Ushtarak (PMC), shërbime inteligjente, mercenar, ushtri private, inteligjencë e korporatës, Kontraktor Privat i Sigurisë (PSC) etj.

1. Shërbimet e inteligjencës dhe përfshirja e tyre brenda kompanive private ushtarake

Shërbimet inteligjente, gjatë luftërave të zhvilluara në shekullin e 19-të, nuk kanë përdorur shumë kompani apo industrinë private të sigurimit, sikur në fillim shekullin e 20-të, ku ushtritë private apo kompanitë private të sigurimit kanë vendin e tyre në avancimin e interesave të atyre shteteve mbraza të cilave veprojnë shërbimet inteligjente me këto ushtri private/kompani private apo qysh quhen PMC/PSC.

Qeveritë kanë rekrutuar qytetarët e tyre për të siguruar qytetarinë dhe sovranitetin e tyre nga të brendshëm dhe të jashtëm kërcënimet. Qytetarët bënë luftëra në emër të shtetit, për besnikëri, kombësi dhe ideologji. Ky kapacitet për ofrimin e sigurisë brenda dhe jashtë vendit ka çuar në aftësinë e shteteve për të kontribuar në sigurinë kolektive në shkallë rajonale dhe globale.

Grupet terroriste, forcat e kartelit të drogës, etnikisht dhe grupet e armatosura të motivuara nga prirjet fetare, ose ndërmarrjet kriminale të organizuara ndërkombëtarisht janë shembuj të tjerë të privatizimit të konfliktit, ndërsa përdorimi i shtuar i kontraktorëve ushtarakë privatë/kompanive të sigurimit private është një manifestim i privatizimit dhe komercializimit të luftës.

Luftërat e fundit në Bosnje, Sierra Leone, Kosovë, Afganistan dhe Irak u zhvilluan të gjitha me ndihmën e kontraktorëve ushtarakë privatë. Prandaj, mercenarët, siç njiheshin dikur, po lulëzojnë – vetëm tani ata quhen Kontraktorë Ushtarakë Privatë (PMC) dhe Kompanitë Private të Sigurisë (PSC) dhe që janë shpërfaqur si çelës kryesor strategjik të invazionit ushtarak në Ukrainë. Pra, PMC/PSC-të janë kompani private që specializohen në aftësitë ushtarake,

duke përfshirë operacionet luftarake, planifikimin strategjik, mbledhjen e inteligjencës, mbështetjen operacionale, logjistikën, trajnimin, prokurimin dhe mirëmbajtjen e armëve dhe pajisjeve. Rritja e industrisë PMC/PSC pasqyron fytyrën e re të biznesit të luftës, duke përfaqësuar shtesën më të re në hapësirën moderne të betejës. Roli i PMC/PSC-ve në luftën bashkëkohore po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, duke ndryshuar forcat e armatosura në mbarë botën dhe mënyrat si bëhen luftëra.

2. Sfidat e sigurisë në Ballkanin Perëndimor nën kërcënimin e PMC/PSC

Ballkani Perëndimor përballet me një kërcënim shumëplanësh nga Rusia, qoftë nëpërmjet aleatëve të saj në rajon, qoftë nëpërmjet kërcënimeve hibride që vijnë nga vetë Rusia.³ Gjetjet e deritanishme tregojnë se ambiciet e Ruisë, pas ndërhyrjes në vendet e Ballkanit Perëndimor, janë të drejtuara në mënyrë specifike drejt krijimit të problemeve për BE-në dhe NATO-n.⁴ Ato mund të kategorizohen si: gjeostrategjike, perandorake/ideologjike dhe gjeopolitike.

Së pari, ambicia gjeostrategjike demonstron nga përpjekja e Ruisë për të parandaluar ose dëmtuar praninë e NATO-s dhe BE-së në rajon, siç ishte rasti në Malin e Zi me përpjekjen për të hyrë në Portin e Tivarit. Rusia do të donte ta përdorte Malin e Zi si shpatë brenda barkut të NATO-s. Së dyti, oreksi perandorak i Ruisë ishte diçka që shumë të intervistuar e theksuan. Siç po tregon lufta në Ukrainë, Rusia nuk hoqi dorë kurrë nga ambiciet e saj perandorake. Ajo e sheh veten si një aktor të fuqishëm gjeopolitik – si në shekujt e mëparshëm – jo vetëm në Ballkan, por edhe në nivel global.⁵ Së treti, ambicia gjeopolitike.

Për këtë, bashkëpunimi ndërmjet formacioneve paraushtarake ruse dhe ballkanike ka një histori të gjatë. Qindra vullnetarë rusë luftuan përkrah serbëve gjatë luftërave jugosllave në vitet 1990. Në vitet 2010, vullnetarët serbë iu kundërpërgjigjën, duke iu bashkuar radhëve ruse në Donbas dhe Siri. Gjatë viteve të fundit, nuk ka pasur mungesë të raporteve se Moska po kultivon grupe paraushtarake ballkanike për të sabotuar integrimin e rajonit me institucionet perëndimore. Në vitin 2016, oficerët e inteligjencës ruse në bashkëpunim me radikalët serbë (kontraktorët privatë ushtarakë - Wagner) kryen një grusht shteti të dështuar në Mal të Zi në një përpjekje për të parandaluar anëtarësimin e vendit në NATO.

³ <https://balkaninsight.com/2024/05/09/win-win-game-western-balkans-should-up-arms-flows-to-ukraine/>

⁴ <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/20922-20240122.pdf>

⁵ Po aty.

Në vitin 2018, Rusia u akuzua për trajnimin e formacioneve paraushtarake për liderin nationalist të serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik dhe raportet u konfirmuan nga ministri i sigurisë i Bosnje-Hercegovinës. Në Serbi, radikalët me lidhje të njohura me Rusinë organizojnë protesta nacionaliste sa herë që udhëheqja serbe intensifikon dialogun me Kosovën: përleshjet më të fundit me policinë ndodhën këtë shkurt. Në fund të vitit 2022, lidhjet e Wagner-it me Ballkanin u bënë tituj ndërkombëtarë kur dy radikalë serbë vizituan selinë e kompanisë në Shën Petersburg, duke nxitur frikën se Wagner synonte të hapte një zyrë rekrutimi në Serbi. Këto frika u nxitën më tej nga një artikull reklamues i punës me Wagner-in, botuar nga RT Balkan, një degë serbe e themeluar së fundmi e Holdingut të propagandës ruse RT.⁶ Aktualisht, një sistem i gjerë prej 37 PMC operon në 34 vende, 67% (25) e të gjitha kompanive operojnë në Ukrainë, nga të cilat pothuajse gjysma (12) janë krijuar dhe përdorur ekskluzivisht për të marrë pjesë në armiqësitë në Ukrainë, shihni “vendet në të cilat operojnë PMC-të ruse” në të vërtetë⁷.

Por bazuar në informacionet përkatëse nga burime brenda aktorëve të sigurisë në nivel të Brukselit, mund të thuhet se Serbia është aktualisht baza kryesore për të ndikuar në një modus operandi të PMC/PSC që bazohet kryesisht në: *mbledhjen e informacionit të inteligjencës dhe analizimin e tyre, ofrimin e trajnimeve në fushën ushtarake, si dhe krijimin e lidhjeve të forta me grupe të ndryshme interesi që janë kryesisht veteranë të luftërave të fundit ballkanike të viteve '90*. Pra, në Serbi ka operuar zyrtarisht një nga kompanitë ushtarake private ruse, e cila është E.N.O.T., por në bazë të hulumtimit mund të themi se tani vetëm emri entitet ka ndryshuar në EBSSA, e cila ka trashëguar të gjithë infrastrukturën e kompanisë së mëparshme të E.N.O.T.⁸ Por ka një rritje të formës së heshtur përmes përdorimit të elementeve kulturore si kampi veror “Zlatibor” në Serbi dhe atij politik përmes elementeve të inteligjencës ruse brenda kontureve malinje të strukturave inteligjente serbe duke bërë të pamundur kontrollin institucional të tyre.

3. Kuptimi dhe përkufizimi i Kompanive Private Ushtarake (PMC) dhe atyre Private të Sigurisë (PSC)

Përkufizimi në terma juridikë dhe ushtarakë të Kompanive Private Ushtarake (PMC) është thelbësor në kontekstin e strategjive moderne ushtarake. PMC/PSC e parë moderne u themelua nga një grup ish-veteranësh të SAS, nën

⁶ <https://carnegieendowment.org/russia- Eurasia/politika/2023/04/whats-behind-the-posturing-of-russian-mercenaries-in-the-balkans?lang=en>

⁷ <https://molnar.com/en/blog/catalog-of-russian-pmcs>

⁸ <https://jamestown.org/program/russian-pmcs-war-veterans-running-patriotic-youth-camps-in-the-balkans-part-one/>

udhëheqjen e Sir David Stirling dhe John Woodhouse, Watch Guard International, në vitin 1965 që mund të kontraktohej për qëllime sigurie dhe ushtarake.⁹

Detyra e parë e kompanisë ishte të shkonte në Jemen për të raportuar mbi gjendjen e forcave mbretërore kur u shpall një armëpushim. Kompania operoi përfundimisht në Zambia dhe Sierra Leone, duke ofruar ekipe trajnimit dhe këshilla për çështjet e sigurisë. Kompania gjithashtu shiste armë dhe personel ushtarak në vende të tjera për operacione të ndryshme të privatizuara. Sir David Stirling gjithashtu themeloi KAS International dhe bashkëpunoi me Fondin Botëror të Natyrës për të reduktuar me forcë gjuetinë e paligjshme dhe kontrabandën e paligjshme të dhëmbëve të elefantit në vende të ndryshme të Afrikës Jugore. Në kohët mesjetare, mercenarët përdoreshin nga mbretërit për të luftuar, por rritja aktuale e mercenarëve ndodhi pas Luftës së Dytë Botërore.

Rritja dramatike në numrin dhe madhësinë e PMC/PSC-ve ndodhi në fund të Luftës së Ftohtë. Lufta e Ftohtë u pasua nga shpërthimi i shumë luftërave të vogla, veçanërisht në Afrikë, ku një numër PMC/PSC, duke përfshirë Sand Line International (MB) dhe Executive Outcomes (Afrika e Jugut), bënë emër.¹⁰ PMC/PSC-të janë entitete joshtetërore që ofrojnë shërbime ushtarake për përfitime financiare, shpesh duke operuar në zona konflikti në mbarë botën. Këto kompani ofrojnë një sërë shërbimesh, duke përfshirë operacione luftarake, mbështetje logjistike dhe trajnime, të cilat mund të plotësojnë apo edhe zëvendësojnë forcat tradicionale ushtarake.

Vitet e fundit, përdorimi i PMC/PSC-ve nga fuqitë e mëdha si SHBA dhe Rusia ka ngritur shqetësime për përgjegjshmërinë, transparencën dhe mjegullimin e linjave midis interesave shtetërore dhe private. Ndërsa shtetet vazhdojnë të mbështeten te PMC/PSC-të për detyra të ndryshme ushtarake, është thelbësore të shqyrtohet ndikimi i këtyre subjekteve në sigurinë ndërkombëtare dhe implikimet për strukturën globale të fuqisë në zhvillim. Në rrethana të tilla, përdorimi i kompanive private të sigurisë ushtarake dhe atyre të sigurisë private mund të shfaqet në terma të shkurtra, pozitive, veçanërisht në drejtim të përmirësimit të aftësive profesionale të vendit, madje ndonjëherë edhe në drejtim të rritjes së vetëbesimit.¹¹

Megjithatë, ndikimi negativ në procesin e demokratizimit mund të jetë i lartë dhe i shumanshëm, veçanërisht nëse shteti nuk ka ndërtuar një mekanizëm për monitorimin e kompanive private të sigurisë dhe ushtarake.¹²

⁹ Javid, A. (2021, Jul 6). *jagranjosh*. Retrieved from jagranjosh: <https://www.jagranjosh.com/general-knowledge/private-military-company-pmc-and-its-working-1625585527-1>

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

¹² Armin, K. (2007, August 10). *researchgate*. Retrieved from researchgate:https://www.researchgate.net/publication/349325583_PRIVATNA_SIGURNOST

4. Klasifikimet, veçoritë dhe karakteristikat e PMC/PSC

- Mbështetja ushtarake synon të ofrojë mbështetje teknike për klientët e tyre. Ata nuk do të marrin pjesë drejtpërdrejt në planifikimin, ekzekutimin etj., të operacioneve ushtarake por vetëm me logjistikë dhe stërvitje.

- Konsulencat ushtarake janë llojet më të zakonshme të PMC-ve dhe ofrojnë trajnime, planifikim operacional, organizim të forcave të armatosura, etj., për klientët e tyre.

- Ofrues ushtarakë punësohen për të luftuar beteja aktive në emër të klientëve të tyre. Ata luajnë një rol humanitar gjatë konfliktit, nëse kërkohet nga klientët.

Dallimi midis këtyre tre kategorive dhe kontraktorëve të rregullt ushtarakë është se ata janë ofrues shërbimesh, jo prodhues. Në ndryshim nga ndërtimi i tankeve, avionëve, anijeve ose raketave, ata ofrojnë roje të armatosur, këshilltarë ushtarakë, kuzhinierë, shoferë kamionësh dhe përkthyes, mekanikë dhe teknikët e armëve.¹³ Shërbimet PMC/PSC ndahen në gjashtë fushat e mëposhtme:

a. Lufta - Mund të përfshijë një spektër aktivitetesh, nga angazhimi i drejtpërdrejtë deri tek ofrimi i ndihmës për trupat e rregullta.

b. Stërvitje - Përfshirë jo vetëm armët dhe stërvitjen luftarake, por trajnimin në fusha të tilla si taktikat, ngasja jashtë rrugës dhe mjekësia në terren.

c. Mbështetje- Duke mbuluar fusha të tilla si logjistika, ndërtimi, mirëmbajtja dhe shërbimet e IT.

d. Siguria - Më e dukshme, mbrojtja e individëve, ndërtesave dhe infrastrukturës tjetër, si dhe transportuesit.

e. Inteligjenca - Mbledhja dhe analiza e informacionit, përmes metodave të tilla si kërkimi dhe mbikëqyrja.


f. Rindërtimi - në situata pas konfliktit, aktivitete të tilla si pastrimi i minave, rindërtimi i infrastrukturës dhe restaurimi i shërbimeve kritike.¹⁴

Në varësi të vendeve ku veprojnë, PMC/PSC-të kryejnë një gamë të gjerë detyrash luftarake ose ushtarake. Këto kompani madje operojnë nën shumë modele të ndryshme të PMC/PSC. Disa janë të integruar plotësisht në aparatit ushtarak shtetëror, ndërsa të tjerët veprojnë në një mënyrë më të ngjashme me rolin tradicional të mercenarëve¹⁵.

¹³ Isenberg, D. (2009). *Private Military Contractors and U.S. Grand Strategy*. Greenwood: International Peace Research Institute.

¹⁴ Peter Hough, Andrew Moran, Bruce Pilbeam and Wendy Stokes. (2020). *International Security Studies, Theory and Practice*. London: Routledge.

¹⁵ Union, C.o. (August). *The Business of War – Growing risks from Private Military Companies. Art - Research Paper*, 3.



Problemi kryesor mund të jetë ndryshimi midis Kontraktorëve Ushtarakë Privatë/ Kontraktorëve Privatë Sigurisë modernë dhe atyre kontraktorëve tradicionalë të mbrojtjes, sepse nuk mund të thuhet se dallimi i një PMC/PSC nga një tjetër bazohet në funksionin e tyre kryesor, pasi është pothuajse e pamundur të ndahet. Një kontraktor nëse është modern ose tradicional, mund të sigurojë dhe të kryejë më shumë se një aftësi në çdo kohë të caktuar, në varësi të kërkesës operacionale.

Këtu vlen të përmendet dokumenti “Montreux”, i përbërë nga dy pjesë, sipas të cilit PMC-të janë subjekte biznesi private që ofrojnë shërbime ushtarake dhe/ ose sigurie, pavarësisht se si e përshkruajnë veten. Shërbimet ushtarake dhe të sigurisë përfshijnë, në veçanti, mbrojtjen e armatosur dhe mbrojtjen e personave dhe objekteve, si autokolona, ndërtesa dhe vende të tjera; mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemeve të armëve; paraburgimi i të burgosurve dhe këshilla ose trajnime të forcave lokale dhe personelit të sigurisë¹⁶.

Paralelisht me zhvillimin e tyre, kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë edhe në të ardhmen do të paraqesin sfida të vërtetë për rregullimin efektiv të drejtë të shërbimeve të tyre, sidomos në fushën e përgjegjësisë së tyre për shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë përdorimit operativ. Por, sido që të jetë, ato do të vazhdojnë të ofrojnë shërbime malinje për agjencitë inteligjente, sigurisht duke i ikur radarit të atij shteti ku operon kjo kompani, qoftë ushtarake apo private e sigurisë.

¹⁶ International Committee of the Red Cross, Government of Switzerland. (2020, June 11). *International committee of the red cross*. Retrieved from icrc: <https://www.icrc.org/en/publication/0996-montreux-document-private-military-and-security-companies>

Përfundime

Pohimet se PMC/PSC janë më ekonomikisht të arsyeshme se sa të mbahen ushtri të përhershme zakonisht bazohen në bazë të argumenteve të mëposhtme:

- PMC/PSC mund të punësojë personel që shpesh herë është i paguar në mënyrë të konsiderueshme më pak.
- Qeveritë ose organizatat që i huazojnë, nuk është patjetër t'iu sigurojnë PMC/PSC-ve përfitime të "fshehura" të tilla si: pensionet, mbrojtjen shëndetësore, vendbanim etj., sepse kjo është zakonisht e përfshirë në marrëveshje.
- PMC/PSC kanë aftësi menjëherë të rrisin numrin e forcave, pa harxhime për shkak të mirëmbajtjes afatgjatë të kapaciteteve ushtarake/sigurisë.
- Me atë që do t'i kryejnë operacionet kryesore jo luftuese apo luftuese, PMC/PSC u mundësojnë forcave të armatosura të përqendrohen në misionet thelbësore.
- Duke pasur parasysh se paguhen në bazë të marrëveshjes, në vend si funksion të numrit të ushtarëve në teren, është e vështirë të krahasohet arsyeja ekonomike e PMC/PSC kundrejt të ushtrisë së rregullt.
- Personeli i PMC/PSC shpesh merr trajnim që e siguron shtetin në cilësinë e anëtarëve të ushtrive kombëtare, ky trajnim në mënyrë efektive paraqet ndihmë financiare për vetë kompanitë në dhe operacioneve të tyre, kur personeli do të shkojë në vende pune të paguara më mirë në sektorin privat.
- Shërbimet inteligjente do të vazhdojnë të shfrytëzojnë këto struktura për të ikur mbikëqyrjes nga sistemi legjislativ dhe atij penal në vendet e tyre por edhe nga vendet ku do të përdoren këto struktura.

Rekomandime

1. Të krijohet autoriteti rajonal, ballkanik dhe ndërkombëtar që përcakton rregullat dhe normat e përgjithshme për KPM si dhe kontrollin e kontraktorëve ushtarakë privatë të regjistruar në këtë mekanizëm kontrolli.

2. Për vendet e Ballkanit duhet të ketë një specifikim brenda ligjeve të tyre kombëtare që hapja e kompanive që ofrojnë module leksionesh me elementë ushtarakë dhe policorë, duhet të vendosë kritere dhe specifika ku kontrolli i tyre duhet të bëhet nga ekspertët ushtarakë të vendit që zhvillon aktivitetin.

3. Personat që hapin kompani private ushtarake/sigurisë në vendet e rajonit të Ballkanit nuk duhet të lejohen të jenë persona që nuk janë shtetas të atij vendi, kështu që do të jete e pamundur që boshllëqet ligjore të përdoren nga persona

të lidhur me FSB-në ose Rusinë. GRU dhe vende të tilla si Serbia, Bosnja, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Shqipëri dhe Kosova nuk duhet të jenë ofrues dhe prodhues të mercenarëve modernë (PMC/PSC) në mënyrë që njerëzit me tendenca terroriste të fshihen pas tyre.

- Dhe së fundi, bota perëndimore duhet të kuptojë se PMC-të do të përcaktojnë “luftërat e ardhshme” dhe fushat e betejës së shekullit të 21-të.

Bibliografia

1. <https://balkaninsight.com/2024/05/09/win-win-game-western-balkans-should-up-arms-flows-to-ukraine/>
2. <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/20922-20240122.pdf>
3. <https://carnegieendowment.org/russia-eurasia/politika/2023/04/whats-behind-the-posturing-of-russian-mercenaries-in-the-balkans?lang=en>
4. <https://molfar.com/en/blog/catalog-of-russian-pmcs>
5. <https://jamestown.org/program/russian-pmcs-war-veterans-running-patriotic-youth-camps-in-the-balkans-part-one/>
6. Javaid, A. (2021, Jul 6). *jagranjosh*. Retrieved from jagranjosh: <https://www.jagranjosh.com/general-knowledge/private-military-company-pmc-and-its-working-1625585527-1>
7. Armin, K. (2007, August 10). *researchgate*. Retrieved from researchgate:https://www.researchgate.net/publication/349325583_PRIVATNA_SIGURNOST
8. Isenberg, D. (2009). *Private Military Contractors and U.S. Grand Strategy*. Greenwood: International Peace Research Institute
9. Peter Hough, Andrew Moran, Bruce Pilbeam and Wendy Stokes. (2020). *International Security Studies, Theory and Practice*. London: Routledge.
10. Union, C. o. (August). The Business of War – Growing risks from Private Military Companies. *ART - RESEARCH PAPER*, 3.
11. International Committee of the Red Cross, Government of Switzerland. (2020, June 11). *INTERNATIONAL COMMITTEE OF THE RED CROSS*. Retrieved from icrc: <https://www.icrc.org/en/publication/0996-montreux-document-private-military-and-security-companies>

NATO në Ballkanin Perëndimor: Shqipëria nga “armiq”, te motoja “miq besnik”

Prof. Asoc. Dr. Etleva SMAÇI

Zëvendësrektor i Akademisë së Forcave
të Armatosura

Trajtesë e shkurtuar.

Ky punim synon të analizojë metamorfozën e qëndrimit dhe të rolit të NATO-s në Ballkanin Perëndimor¹ në tre dekadat e fundit në raport me qëndrimin dhe rolin gjatë Luftës së Ftohtë.

Për të realizuar këtë analizë krahasuese punimi do t'i referohet kontekstit historik ushtarak gjatë Luftës së Ftohtë, në mënyrë të veçantë faktit se shumica e shteteve të Ballkanit Perëndimor që sot aderojnë në NATO, ishin pjesë e Jugosllavisë, një vend që ndoqi politikën “jashtë aleancave dhe blloqeve ushtarake”. Argumenti bazik që punimi do të sjellë është se shpërbërja e ish-Jugosllavisë në vitet 90-të si dhe ndryshimi i formës së regjimit në shtetet të caktuara, nxiti aleancën të ndryshonte qëndrim dhe të përfshihej në një zonë që e kishte konsideruar për 40 vjet “out of area”, në mënyrë specifike për faktin se të drejtat e njeriut ishin të dhunuar në mënyrë masive.

Teza tjetër e punimit do të hedhë dritë mbi implikimet në rajon si pasojë e përplasjes së interesave NATO-Rusi, pas ndryshimit të balancave gjeostrategjike në favor të aleancës. Kjo tezë natyrshëm ngre dilemën nëse përfshirja e NATO-s në rajon do t'i shërbejë stabilitetit, apo do të jetë terren i

¹ Në këtë punim termi “Ballkan Perëndimor” do t'i referohet 6 shteteve: Shqipëri, Serbi, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Bosnje–Hercegovinë dhe Kosovë.

përshatshëm përplasjesh pikërisht për shkak të së shkuarës historike, ku vetë aleanca ka pas ndjekur teorinë e “hot patateo”.

Së fundmi, po jo më pak e rëndësishme, teza e tretë e punimit do të lidhet me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO si një ish-vend i Traktatit të Varshavës dhe më një trashëgimi komuniste. Analiza historike e rastit të Shqipërisë do të bëhet e lidhur ngushtë me vendet e tjera anëtare të rajonit, për të shpjeguar nëse kemi një mbyllje të ciklit të Luftës së Ftohtë në Ballkanin Perëndimor, apo një variant modern të saj.

Fjalë kyçe: Ballkan Perëndimor, NATO, rreziqe, siguri, Luftë e Ftohtë.

Hyrje

Organizata e Atlantikut Verior u themelua më 1949 me qëllimin e qartë të mbrojtjes së Europës Perëndimore nga agresionet e mundshme të Bashkimit Sovjetik dhe aleatët e saj. Edhe pse për gjatë viteve të Luftës së Ftohtë u krijua ideja se NATO ishte jashtë Ballkanit (duke ruajtur zonat e influencës të vendosura në Jaltë), në fakt përfshirja e Greqisë dhe Turqisë në NATO dhe krijimi i Paktit Ballkanik me prezencën e Jugosllavisë më 1953, japin më tepër idenë e një pranie të kujdesshme në rajonin tonë. Me rënien e regjimit komunist në vendet e bllokut socialist në vitet 1990-1991 “hija kërcënuese” e agresionit sovjetik erdhi e u zhbë shumë shpejt. Për këtë ndihmoi në mënyrë të veçantë shpërbërja e kundërpartit të NATO-s, Traktatit të Varshavës. Në vazhdim të idesë së mësipërme, prania e “NATO”-s jo në pak qarqe u konsiderua e “tepërt”, pasi ajo e kishte përmbushur misionin e saj historik, ruajtjen e perëndimit nga ideologjia komuniste. Aq më pak, ajo që nuk u parashikua në momentin e parë të rënies së komunizmit, ishte ambicia e NATO-s për të plotësuar vakumin e lënë në të gjithë Evropën Qendrore dhe Lindore.

Por pikërisht ndryshimet e regjimit do t’i ballafaqonin vendet komuniste me sfida të reja sigurie të cilat nuk mund të menaxhoheshin më me modelin e shtetit të “diktaturës së proletarietit”. Ndërsa është fare i justifikueshëm vetë ofrimi i pjesës dërrmuese të vendeve të Evropës Lindore dhe Qendrore për t’u bërë pjesë e një organizate sigurie kolektive si NATO², të panjohurat që kanë kërkuar gjithmonë një përgjigje lidhen me “rinovimin” e NATO-s në një zonë

² Strobe Talbott: *The Russia Hand*, The Random House Trade Paperback Edition, 2003, p:94, Shtyssa fillestare për zgjerim erdhi nga presidentët e tre ish-vendeve të Paktit të Varshavës. Në prill 1993, Lech Walesa i Polonisë, Vaclav Havel i Republikës Çeke dhe Arpad Goncez i Hungarisë iu lutën Bill Klintonit për pranimin e vendeve të tyre si anëtarë të NATO-s. Estonia bëri një kërkesë të ngjashme në maj, duke argumentuar se kjo ishte thelbësore për të parandaluar një ri-okupim të ardhshëm rus.

të cilët e kishte konsideruar “out of area”. E mbi të gjitha “afrimi” pikërisht kur “kërcënimi” i komunizmit nuk ishte më prezent dhe alibia e Luftës së Ftohtë kishte rënë.

Nga pikëpamja historike, duke iu referuar dokumenteve të adoptuara nga kryetarët e shteteve anëtare të NATO-s më 1991, në atë çka u konsiderua koncepti i ri strategjik i Aleancës, mund të pohojmë se “zgjerimi i gardhit” u pa si e vetmja rrugë për të ruajtur “balancën strategjike në Evropë”.³ Nga ana tjetër, nëse i referohemi preambulës së Traktatit të Uashingtonit, shtetet e anëtarësuar në NATO nuk e bazojnë unitetin e tyre thjesht në kundërshtimin e komunizmit, por më së pari në vlerat e përbashkëta siç janë: mbrojtja e lirisë, parimet demokratike, shteti ligjor etj. Për rrjedhojë ky argument i fundit ishte elementi kyç që frymëzoi strategjinë e zgjerimit në vendet e dala nga komunizmi.⁴ Si rezultat që prej Samitit të Rigës më 2006, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kishin institucionalizuar marrëdhëniet me NATO-n nëpërmjet PFP ose nëpërmjet Këshillit të Bashkëpunimit Euroatlantik.

Por 75-vjetori i NATO-s dhe deklasifikimi i një sërë dokumentesh të panjohura për publikun gjatë këtij viti riktheu edhe një herë vëmendjen e studiuesve te pyetja: nëse ky zgjerim ku përfshiheshin një pjesë e mirë e ish-vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës si dhe ish-republikave sovjetike ishte i drejtë apo shërbeu dy dekada më vonë si frymëzim për liderin nacionalist të Moskës, Vladimir Putin për një revansh ushtarak si ai ndaj Ukrainës?

Nëse marrim në shqyrtim tezën se zgjerimi në fund të viteve 90-të dhe në fillim të shekullit të 21-të i ka shërbyer “inkurajimit” të armiqësisë me Rusinë, duhet të shohim në retrospektivë disa nga parashikimet e bëra nga figura shumë të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare. Le ta nisim me Henry Kissinger, i cili në janar të 1997 paralajmëronte se “herët në shekullin e ri, pas shumë ngritjeve dhe uljeve Rusia ka të ngjarë të ketë rivendosur autoritetin e saj qendror. Kjo mund të jetë shumë më pranë strukturave të favorizuara nga Pinoçeti ose Salazari se sistemet pluraliste perëndimore megjithëse ai do të jetë më i lirë se komunizmi”.⁵

E ardhmja e paparashikueshme e Ruisë që u vërtetua se nuk ishte një konstatim i gabuar nga ana e Kissinger, bëri që po në të njëjtën periudhë Zbignie Brzezinski dhe Anthony Lake e shihnin zgjerimin si të vetmen mënyrë

³ North Atlantic Treaty Organization, “The Alliance’s Strategic Concept,” Agreed by the Heads of State and Government Participating in the meeting of the North Atlantic Council in Rome on 7-8 November 1991, paragrafi. 21.

⁴ “The North Atlantic Treaty Preamble,” North Atlantic Treaty Organization, March 5, 2018, http://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_17120.htm.

⁵ Henry Kissinger, A World We Have Not Known, *Newsweek*, 27 January 1997

për të mbajtur lidhjen e Atlantikut të fortë. Zgjerimi i aleancës parashikonin Brzezinski dhe Lake siguronte një mbrojtje kundër mundësisë së pamundur por shumë reale që Rusia t'i rikthehet sjelljes së kaluar.”⁶ Ky do të ishte një moment shumë i rëndësishëm për vendet e Europës Lindore dhe Ballkanit Perëndimor për t'u kthyer në rajone të rëndësishme për Aleancën e Atlantikut, kurse për këtë të fundit do të shënohej një kthesë e jashtëzakonshme pasi do të ofronte mbrojtje kolektive dhe siguri për ato vende të cilat deri në pak kohë më parë ishin konsideruar “armiç”.

1. NATO dhe ish-Jugosllavia

Rajoni i Ballkanit i viteve 90-të jo në pak raste konsiderohej për NATO-n “një dhimbje koke”.⁷ Bazuar në studimet rreth marrëdhënies së NATO-s me vendet ish-komuniste të rajonit, rasti i Jugosllavisë ka qenë një test shumë i rëndësishëm në sfidën e zgjerimit. Këtu do të shmangim analizën e ndërhyrjeve humanitare të kryera nga NATO që prej përfshirjes së saj me një personel prej gati 100 vetash në Bosnje-Hercegovinë më 1992 e deri tek rasti i Kosovës. Fokusi i këtij sythi është analiza e faktorëve politikë dhe ushtarakë që kushtëzuan përfshirjen në NATO të ish-republikave të dala nga shpërbërja e Jugosllavisë. Pyetja direkte është se përse shtetet e pavarura të krijuar pas shpërbërjes së Jugosllavisë si Mali i Zi dhe Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ruajtën trashëgiminë titiste të qëndrimit “jashtë blloqeve”? Trashëgimi që vazhdon të “trumbetohet” nga Serbia, pasardhësja legjitime e ish-Jugosllavisë e cila zyrtarisht ka statusin e një shteti neutral dhe që respektohet plotësisht nga aleanca⁸.

Epoka e re e real-politike dhe lufta gjeopolitike që ndoqi përfundimin e Luftës së Ftohtë nuk vë dyshime mbi tezën se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin dhe kanë një plan tepër ambicioz për Ballkanin Perëndimor dhe demokracitë e reja në këtë rajon. Hapi i parë i ambicies nuk mund të ishte veçse përfshirja e tyre në një sistem kolektiv sigurie (NATO), të cilën ato e kishin krijuar së bashku me aleatët e tyre menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Qëllimin e kësaj përfshirje e sqaron mjaft qartë zoti Richard Holbrooke duke e lidhur me rolin udhëheqës në Evropë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

⁶ Zbigniew Brzezinski and Anthony Lake, “The Moral and Strategic Imperatives of NATO Enlargement”. *International Herald Tribune*, 1 July 1997.

⁷ Elena Zamfiresku, NATO and Balkans, *Perceptions Journal of International Affairs*, March-May 1999, Volume IV, Number 1.

⁸ Pas politikave neutrale të Serbisë, e cila tashmë është e rrethuar nga shtete anëtare të NATO-s, padyshim ka arsye të mjaftueshme dhe të dukshme. Së pari, një nga arsyet e qëndrimit të Serbisë larg NATO-s lidhet me lidhjet e ngushta me Rusinë, lidhje tradicionale dhe së dyti, opinion publik është një ndër kundërshtarët më të fortë, nisur nga bombardimet e vitit 1999, gjatë luftës së Kosovës.

me “krijimin e një sistemi sigurie që do të stabilizonte gjithë Evropën Perëndimore si dhe satelitët e Bashkimit Sovjetik në Evropën Qendrore.”⁹ Për zotin Hoolbroke zgjerimi i NATO-s nuk ishte gjë tjetër veçse një pasojë e ngritjes së Perdes së Hekurt për 45 vjet.¹⁰

Po cila ishte dhe mbetet pika më e dobët e vendeve të Ballkanit? Shteti socialist ia la vendin një shteti kapitalist, bazuar në ekonominë e tregut dhe demokracinë parlamentare. Kjo mund të konsiderohej si një “rend i ri” për Ballkanin. Ose e thënë ndryshe një përpjekje për të rritur demokracinë në një terren tepër vulnerabilë. Pra, “detyrat” e NATO-s nuk u kufizuan thjesht në atë çka në periudhën e Luftës së Ftohtë ishte konsideruar një ombrellë mbrojtëse ushtarake kundër një agresioni. Përkundrazi, paqëndrueshmëria dhe pasiguria politike e prodhuar nga demokracitë “new born” në Ballkan që vazhdojnë të klasifikohen regjime hibride kanë ndikim në zonën e sigurisë së NATO-s. Për rrjedhojë, zgjerimi ishte i detyrueshëm duke i shërbyer interesave të stabilitetit të anëtarëve më të hershëm të organizatës.

Marrëdhënia e pas vitit 1990 ndërmjet NATO-s dhe Ballkanit është një nga ilustrimet më bindëse të kapacitetit të qenësishëm të NATO-s për t’u përshtatur me sfidat e reja. Edhe pse e padëshiruar nga askush, historia tragjike e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe pasojat e saj pasuese kanë luajtur, në një farë mënyre, rolin e një katalizatori për përshtatjen e Aleancave ndaj sfidave dhe rreziqeve të reja të periudhës së pas Luftës së Ftohtë. Nga ana tjetër, përshtatja e NATO-s ka favorizuar si vullnetin ashtu edhe aftësinë e saj për t’u bërë një instrument thelbësor për rilidhjen graduale të të gjithë zonës me rrjedhën kryesore të Evropës. Ky zgjerim jo vetëm u konsiderua i “shëndetshëm”, por pati edhe perifrime se nëse NATO nuk do të dilte jashtë zonës së Luftës së Ftohtë, do të dilte jashtë biznesit”.¹¹ Në fakt, megjithatë, nuk ishte shqetësimi për të dalë jashtë biznesit për të nxitur operacionet e para të zbatimit të paqes në Ballkanin Perëndimor. Përkundrazi, vendet që iu bashkuan aleancës nxorën mësim nga e shkuara e tyre historike se një NATO në rritje ishte e vetmja organizatë ndërkombëtare që, me strukturën e saj të integruar të komandës ushtarake dhe përvojën e stërviçjeve të përbashkëta aleate, ishte organizata e duhur që të kryente operacionet e menaxhimit të krizave dhe paqeruajtëse përtej kufijve të saj, çka nënkuptonte një terren krizash si Ballkani Perëndimor, për t’u përdorur nga aktorë të tjerë. Vlen të mos anashkalohet fakti që si Mali i Zi, ashtu edhe Maqedonia e Veriut e kanë

⁹ Richard Holbrooke, “America, A European Power”, Foreign Affairs, March/April 1995, page 39.

¹⁰ Po aty... faqe 43.

¹¹ Senator Richard Lugar. NATO: *Out of Area or Out of Business. A Call for U.S. Leadership to Revive and Redefine the Alliance* (Washington, DC: Overseas Writers Club, 24 June 1993).

parë anëtarësimin në NATO si një kriter përmbushës për integrimin e tyre në Bashkimin Evropian, edhe pse deri më tash nuk ka dhënë rezultatet e pritshme.

2. Shqipëria nga Varshava në NATO

Në historikun e zgjerimit të NATO-s në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria vlen të trajtohet si një rast studimor jo vetëm se në fund të viteve 60-të do të guxonte të dilte nga rivali i NATO-s, Traktati i Varshavës, por edhe për faktin tjetër se ishte ndër të parat vende ish komuniste që me rënien e regjimit, tregoi një angazhim të lartë për t'u bërë pjesë e NATO-s. Përgjatë Luftës së Ftohtë mjedisi gjeostrategjik në rajon përbënte një pazëll shumë interesant. Dy nga fqinjët tanë me të cilët ndanim kufirin detar Italia dhe Greqia ishin anëtarë të NATO-s. Bregdeti italian shërbente si terren dislokimi për Flotën VI amerikane. Përsa i përket Greqisë edhe aty kishte disa baza të NATO-s me qëllim parësor ruajtjen e Mesdheut nga kërcënimi i Bashkimit Sovjetik.

Pikërisht zgjidhja “ex deux machine” e këtij rebusi do të bëhej Shqipëria komuniste që do t'i jepte një mundësi të artë Moskës për balancimin e forcës në Mesdhe me pozitën e saj gjeografike. Anëtarësimi i Shqipërisë në Traktatin e Varshavës në historinë politike dhe ushtarake të Luftës së Ftohtë është tashmë i dëshmuar si një lëvizje pragmatiste e qeverisë komuniste për të siguruar integritetin territorial të vendit nën “ombrellën” e një organizmi politik dhe ushtarak të sigurisë kolektive të bllokut komunist që drejtohej nga Bashkimi Sovjetik.¹² Me praninë e trupave ushtarake të Bashkimit Sovjetik në bazën detare të Pashalimanit dhe ajo e Sazanit do të zinte fill e do të rritej ndjeshëm rivaliteti me NATO-n.

NATO trajtohej si “armik” dhe rrezik për shtetin shqiptar jo vetëm në literaturën politike, por edhe në manualët dhe doktrinat ushtarake. Por njohja e ushtrive të saj ishte një pjesë shumë e rëndësishme e edukimit ushtarak të asaj periudhe. Vlen të theksohet se qëndrimi i NATO-s ndaj Shqipërisë komuniste ishte mjaft i ndjeshëm në vitet 1955-1961, kur Bashkimi Sovjetik vendosi një bazë nëndetëse në gjirin e Vlorës. Përsa i përket qëndrimit që NATO mbajti pas përjashtimit *de facto* të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, ishte adoptimi i politikës “hands off” (mosndërrhyrjes) propozuar nga George Kennan në raportin e tij të shkurtit të vitit 1962.¹³ Largimi i trupave sovjetike lehtësoi

¹² Etleva Smaçi, *Shqipëria në Traktatin e Varshavës*, UETPRESS, Tiranë:2023.

Shqipëria hyri në Traktatin e Varshavës në vitin 1955, duke surprizuar më së shumti Lindjen sesa Perëndimin. Reagimi lidhej me shumë faktorë, duke nisur nga varfëria e tejskajshme e vendit komunist si dhe nga ndryshimi i politikës së Kremlinit. Politika e ndjekur nga Hrushovi pas vdekjes së Stalinit çoi në zgjerimin e hartës së vendeve komuniste të përfshira në një aleancë ushtarake në një rajon tepër të brishtë, siç ishte Ballkani.

¹³ National Archives Record Administration (NARA), Records of the U.S Department of State Relating to International Affairs of Albania, 1960-1963, Box 1926, November 17, 1961.

pozitat e NATO-s në Mesdhe, por afrimi me Shqipërinë, një vend komunist u kalkulua nga NATO si një mundësi konflikti me Traktatin e Varshavës. Kjo politikë mori fund me shpërbërjen e Traktatit të Varshavës dhe rënien e komunizmit. E dalë nga një izolim diktatorial, Shqipëria shprehu interes për dialog me NATO-n duke u bërë anëtare e Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC) në qershor 1992. Rrugëtimi drejt NATO-s zgjati gati dy dekada.¹⁴ Vlen të theksohet se procesi i anëtarësimit pati karakteristika të ngjashme me atë të Traktatit të Varshavës në dy element: propagandimi politik me natyrë partiake si dhe entuziazmi popullor rreth anëtarësimit. Ky i fundit shpesh u keqinterpretua dhe u trajtua si një afrim me SHBA sesa me një organizatë të sigurisë kolektive.¹⁵ Kjo shpjegon edhe të dhënat statistikore që dëshmojnë se rreth 90% e popullatës ishte pro anëtarësimit në NATO (shumë të ndryshme me vendet e tjera ballkanike).

Partneriteti për Paqe ishte një mekanizëm shumë i rëndësishëm për përgatitjen e ish-vendit komunist dhe anëtar i Traktatit të Varshavës për anëtarësimin përfundimtar në NATO¹⁶. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO erdhi si rrjedhojë e vendimit të rëndësishëm për zgjerimin e Aleancës, të marrë më 3 prill 2008 nga të 26 kërret e shteteve dhe qeverive të Aleancës gjatë një seance të posaçme të Samitit të NATO-s Bukuresht, nëpërmjet të cilit Shqipëria dhe Kroacia u ftuan të fillonin bisedimet për anëtarësimin. Paraqitja e parë e Shqipërisë si anëtare me të drejta të plota e NATO-s u bë në Samitin e Aleancës që u mbajt në Strasburg/Kehl më 4 prill 2009, ndërkohë që më 7 prill 2009, në selinë e Aleancës në Bruksel, u zhvillua ceremonia zyrtare e ngritjes së flamujve të Shqipërisë në NATO.

Që prej fillësive të këtij rrugëtimi anëtarësimi i Shqipërisë në NATO është parë i lidhur ngushtë jo vetëm me reformat në sektorin ushtarak, por në radhë të parë me demokratizimin e jetës në vend, me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në dallim të plotë nga qasja tradicionale ideologjike e regjimit komunist, ajo që duhet ta bënte të denjë Shqipërinë për NATO-n ishte jo vetëm pranimi por edhe përshtatja e me vlera e përbashkëta që simbolizonin aleancë: sistemi pluralist, demokracia, liria dhe toleranca.¹⁷ Shqipëria në dallim nga vendet e tjera të rajonit nuk ka pasur problem faktorin rus në lidhje

¹⁴ Përfshirja e Shqipërisë në aleancë u mbështet në disa instrumente siç ishin Pfp dhe MAP për të mbërritur tek anëtarësimi më 2009.

¹⁵ Institute for Democracy and Mediation. Albanian perceptions on NATO integration. Tirana June 2007 <http://idmalbania.org/publications/en/AlbPerceptionOnNATOintegrations.pdf>.

¹⁶ Shqipëria iu përgjigj pozitivisht ftesës për Pfp më 1994. Më vonë si rezultat i hapave pozitivë vendi ynë u përfshi në Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) në 1999.

¹⁷ NATO (2006b): Jaap de Hoop Scheffer, Secretary General, NATO, Speech at the Albanian parliament, 6 July, on-line text.

me anëtarësim e saj në NATO, por kjo nuk do të thotë që anëtarësimi është parë me sy pozitiv nga Moska. Veçanërisht angazhimet e fundit të qeverisë shqiptare për rijetësimin e disa bazave ushtarake (si rasti i Kuçovës) me një të shkuar historike të afërt me Traktatin e Varshavës, bënë që shtypi t'i rikthehej trashëgimisë së kampit sovjetik.¹⁸ Edhe përpara hapjes së bazës së Kuçovës, Sputnik Serbia dhe platformat e tjera ruse që veprojnë më Ballkan nuk kanë nguruar të furnizojnë me lajme të rreme, duke portretizuar Shqipërinë se do të përdoret si një “korridor lufte” nga NATO.¹⁹ Shqipëria konsiderohet “një shtet kukull” që po përdoret nga Aleanca për të rimilitazuar territore të cilat sipas Sputnik tashmë konsiderohen “të zotëruara” prej NATO-s. Edhe rijetësimi i bazës së Kuçovës jo vetëm për shtypin, por edhe për një kategori studiuesish pro rus është trajtuar si një argument se “Perëndimi ka gënjyer që prej ditës së pare për sa i përket zgjerimit të tij në lindje në përfundim të Luftës së Ftohtë”.²⁰

Ofrimi i territorit shqiptar për baza të NATO-s duket se nuk do të ndalet me rastin e bazës së Kuçovës, pasi në deklaratimet e kryeministrit Edi Rama, në qershor të këtij viti, u përmend fakti se Shqipëria është në bisedime me NATO-n për të ndërtuar një bazë detare në Porto Romano²¹, një port në ndërtim e sipër në bregdetin e saj Adriatik. Kjo deklaratë vinte pas asaj të muajit maj në lidhje me ofrimin NATO-s bazën e saj detare Pashaliman rreth 200 km (124 milje) në jug të Tiranës, e cila është tjetër trashëgimi sovjetike për të cilën Shqipëria ka akoma të hapur debatin me Moskën për 4 nëndetëset e ngelura në bazë në vitin 1961. Në përmbyllje të kësaj analize mbi paradigmen e Shqipërisë “nga armiq në miq besnikë” në raport me NATO-n, duket se pas 15 vitesh anëtarësim, Shqipëria, përsa parashtruam më lart, nuk është më thjesht një ‘konsumatore’ e sigurisë, por edhe një ofruese e saj veçanërisht për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

3. Zgjerimi, stabilitet apo destabilitet?

Zgjerimi i NATO-s në Ballkanin Perëndimor në fazat e hershme të tij kaloi përmes një hezitimi të dukshëm. Ngurrimi u bë shumë i qartë në fillimet e luftës në ish-Jugosllavi. Vetë perceptimet e Aleancës nuk ishin pozitive për

¹⁸ Jo në pak raste platforma të ndryshme iu referuan bazës së Kuçovës si “një bazë e periudhës sovjetike” Albania, wary of Russia, reopens Soviet-era air base to NATO | Reuters

¹⁹ <https://euronews.al/en/wars-of-the-west-propaganda-nato-will-attack-russia-through-albania-and-kosovo/>

<https://sputnikglobe.com/20240305/perennial-puppet-state-albania-logic>. Kukulla e përhershme Shteti Shqiptarë zgjedhje ‘logjike’ për NATO-n e riorganizuar

²⁰ Po aty.

²¹ <https://shqiptarja.com/lajm/rama-gati-te-bashkefinancojme-bazen-e-re-detare-te-natos-ne-porto-romano-nato-te-garantoje-kufirin-mes-kosoves-e-serbise>.

disa prej vendeve.²² Pyetja që gjendet më shpesh në punimet shkencore është pikërisht: A ndikoi zgjerimi i të NATO-s në stabilizimin demokratik të shteteve postkomuniste në rajon? Pyetja lidhet edhe me debatin e krijuar në raport me ithtarët e zgjerimit të NATO-s Warren Christopher, Anthony Lake, William Perry, Strobe Talbot, etj., të cilët e kanë përdorur shpesh argumentin e ndikimit pozitiv të zgjerimit në konsolidimin e regjimeve demokratike në periudhën postkomuniste. Parashihej se zgjerimi i NATO-s në Ballkan do të mund të lejonte aleancën që të mos binte më në rolin e “importueses” së sigurisë, por të mund ta “eksportonte” atë në rajon, duke siguruar stabilitet përmes demokracisë dhe prosperitetit. Padyshim për vendet Ballkanike që janë anëtarësuar në NATO kjo është përkthyer në hapa të vështirë politikë, por jo të pamundur. Për të ndryshuar institucionet e tyre të vjetra të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor që aspironin të bëheshin pjesë e NATO-s u bënë pjesë e programeve të reja, ku më i rëndësishmi ngelet Pfp (1994), që synim kryesor kishte forcimin e bashkëpunimit dhe ndërtimin e marrëdhënieve reciproke mes vendeve partnere.

Duke iu rikthyer përsëri momentit të parë kur Aleanca vendosi të zgjerohej dhe t’i hidhte sytë në territore të konsideruar “mollë e ndaluar”, në vitin 1990 aleatët e kishin shumë të qartë se “në Evropën e re të krijuar siguria e çdo shteti ishte e lidhur pazgjidhshmërisht me sigurinë e fqinjëve të saj”.²³ Të njëjtin argument e gjejmë edhe në pohimin e Strobe Talbot se “e gjithë Evropa do të jetë më e sigurt dhe më e begatë nëse vendet ish-komuniste do të mund të ecnin e të zhvilloheshin përmes shoqërisë civile, ekonomisë së tregut dhe marrëdhënieve harmonike me fqinjët.”²⁴

Argumenti i Talbotit lidhet ngushtë me idenë e shkrimit të tij se prania e NATO-s në vendet ish-komuniste dhe në disa raste partnere apo satelite të Bashkimit Sovjetik, nuk ishte thjesht një mekanizëm frenimi i Rusisë, apo shtrëngues, por një instrument sigurie kolektive, ku përfshihej edhe vetë Rusia. Kjo shpjegon edhe arsyen përse theksi i aleancë me mbarimin e Luftës së Ftohtë u zhvendos nga mbrojtja e territorit të vendeve anëtare në mbrojtjen e interesave të përbashkëta duke u bërë një domosdoshmëri strategjike.²⁵ Por idetë e mësipërme i përkasin dekadës së fundit të shekullit të kaluar, kur Rusia

²² Watkins dhe Srdjan Gligorijević, NATO dhe Ballkani: Shembulli për një integrim më të gjerë, *Çështje të Sigurisë*, Instituti për Ndërmjetësim dhe Demokraci, nr.5, Tiranë:2007.

²³ “*London Declaration on a Transformed NATO in the 21st century 26 Final March 19, 2001 North Atlantic Alliance*,” Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council. London July 5-6, 1990, paragraph 4.

²⁴ Strobe Talbot, “Russia Has Nothing to Fear,” *New York Times*, February 18, 1997.

²⁵ Dr. William J. Perry and Warren Christopher. “NATO’s True Mission.” *The New York Times*, October 21, 1997

ishite ende nën shokun e shpërbërjes dhe konsiderohej e “dobët”. Pas vitit 2014 optika ruse në lidhje me zgjerimet e NATO-s ka qenë trajtimi i anëtarësimeve të reja si përpjekje të NATO-s për ta organizuar rendin botëror sipas kufijve të rinj.

Pyetja e parë që të vjen në mend është: A i vuri në rrezik marrëdhëniet NATO - Rusi zgjerimi i organizatës së Atlantikut Verior në rajonin e Ballkanit, i njohur si rajon ku influenza ruse ka qenë konstante në marrëdhëniet ndërkombëtare të shekullit XX dhe XXI?²⁶ A ja ka arritur NATO të krijojë stabilitet në rajon, argument që përdori për zgjerim apo zgjerimi ishte thjesht një pretekst si pretendon Moska?

Le të hedhim një vështrim mbi vendet e anëtarësuar së paku në 10 vjetët e fundit ku bëjnë pjesë Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Kjo e fundit është anëtarja më e re aleancës nga Ballkani Perëndimor. Në rastin e Maqedonisë së Veriut, përpara se t'i bashkohej aleancës, NATO, kreu tre operacione ushtarake për mbështetjen e paqes, të cilat përveçse kontribuuan në zgjidhjen e konfliktit të brendshëm, ndihmuan edhe në krijimin e kushteve të nevojshme për konsolidimin e demokracisë në këtë vend. Në eksperiencën ballkanike, rasti i Maqedonisë së Veriut shihet edhe si një shembull suksesi lidhur me çështjet e sigurisë në bashkëpunimin NATO-BE.²⁷

Ajo që bie në sy në rastin e Maqedonisë së Veriut se anëtarësimi nuk pati një mbështetje të gjerë popullore. Qarqet nacionaliste me ndikim rus ushtruan ndikim te pjesë të caktuara të saj që nuk pajtohen me rolin e NATO-s. Rusia u përpoq të përfitonte nga vështirësitë e tilla për të penguar integrimin e Maqedonisë në NATO. Kremlini dënoi ndryshimin e emrit si imponim nga Perëndimi dhe këmbënguli që ai të rinegociohej në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, një forum në të cilin ajo ka të drejtën e vetos. Gjithsesi, Ruisë i mungon afiniteti historik me Maqedoninë e Veriut në të njëjtën mënyrë që e lidh atë me Serbinë. Kështu që me anëtarësimin Rusia tani ka ulur interesin për Maqedoninë e Veriut. Kjo është vënë në dukje me zbutjen deklarave publike të Kremllinit për çështjet maqedonase dhe zhvendosjen e agresivitetit të NATO për tërheqjen e vendeve të Ballkanit në aleancë.

I njëjti fenomen u vu re edhe pas anëtarësimit të Malit të Zi, në 2017 ku u kalua nga këndvështrimi kombëtar i çështjes në atë ndërkombëtar. Sjellja ndaj rastit të Malit të Zi dhe Maqedonisë është interpretuar si një rikthim i Ruisë në Ballkan, ku ajo kërkon të marrë rolin që ka pasur Perandoria Ruse deri në shpërbërjen e saj. Në këtë këndvështrim mund të konsiderohet një faktor i

²⁶ Dimitar Bechev, *Rival Power, Russia in Southeast Europe*. Yale University Press. Autori analizon tezën e panortodoksisë dhe pansllavizmit.

²⁷ Nënshkrimi i marrëveshjes së Ohrit, për të parandaluar luftën në ish-republikën jugosllave të Maqedonisë.

rëndësishëm për Putinin loja ballkanike nisur nga sentimentet nacionaliste të cilat i përdorë përpara elektoratit të tij dhe që për rrjedhojë e bëjnë politiken e jashtme të Ruisë më të paparashikueshme sesa atë të periudhës së Bashkimit Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë.

Së fundmi, siç e përmendëm edhe më lart mospërfshirja në NATO e një aktori me shumë peshë në Ballkan si Serbia e bën të vështirë krijimin e stabilitetit dhe të pashmangshëm ndikimin rus. Serbia qëndron si një “gjemb” midis një NATO-je në zgjerim dhe Ruisë, partnere tradicionale e Serbisë. A mund të reagojë kjo e fundit në mënyrë të dëmshme për rajonin? Rusia e drejtuar nga zoti Putin, një ish-sovjetik që kalon nga karrigia e kryeministrit në atë të presidentit nuk e ka “kapërdirë” dot politikën e “open door policy” të NATO-s.

Por për njohësit e mirë të politikës së jashtme të Putinit më shumë se një ringjallje e Ruisë së Madhe, kjo është një mënyrë për ta detyruar perëndimin ta shohë Moskën si lojtar të barabartë në tavolinë.²⁸ E thënë ndryshe, Putini po tenton në Ballkan bipolaritetin e Luftës së Ftohtë, pas një supermacie gati prej një dekade (1990–2000) të unipolaritetit të vendosur nga NATO. Zgjerimi në tërësi (jo vetëm në Ballkan) është konsideruar nga Moska (rrethet nacionaliste) si një Jaltë e dytë, por pa Rusinë. Stabiliteti për shumë studiues është zëvendësuar me termin “stabilokraci”, pasi vendet e anëtarësuara në NATO kanë ngelur larg integritet në BE. Por qoftë Aleanca, qoftë vendet e rajonit, pranojnë se Ballkani Perëndimor ka nevojë që NATO të vazhdojë të mbetet politikisht e përkushtuar ndaj rajonit.²⁹

Përfundime

Ballkani Perëndimor përbën investimin politik dhe operacional më të vjetër dhe më jetëgjatë të Aleancës, dhe sigurisht më sfiduesi duke pasur parasysh kompleksitetin rajonal dhe fragmentimin e tij politik, etnik dhe fetar. Rajoni përfshin: vende anëtare të NATO-s, partnerë të NATO-s, një vend neutral (Serbinë) dhe së fundi është rajoni ku NATO është ende duke kryer operacionin e vetëm ushtarak përmes KFOR-it në Kosovë.

Është e pamohueshme se në tërësi zgjerimi i NATO-s, duke përfshirë këtu edhe zgjerimin në Ballkanin Perëndimor, ka prodhuar debat në raport me qëllimet e Ruisë. Nëse i referohemi Henry Kissinger ai që në fillesat e zgjerimit të

²⁸ Dimitar Bechev, “*Understanding Russia’s influence in the western Balkans*”, Semptember, 2018. Vizita e kancelares Angela Merkel dhe e Sekretarit të Mbrojtjes James Mattis në Shkup para referendumit të 30 Shtatorit, ishte një tregues se Rusia ishte gatshme për të minuar votën popullore dhe për ta manipuluar atë.

²⁹ Speech by NATO Secretary General Jens Stoltenberg previewing the NATO Summit in Brussels at event organised by NATO, The German Council on Foreign Relations (DGAP) and The Brookings Institution

aleancës në Evropën Qendrore dhe Lindore deklarohet i shqetësuar për “hatërmbetjet” e Rusisë, që do të materializoheshin në “minime” të NATO-s në territoret e reja.

Në optikën e politikës së jashtme të Putinit kjo do të përkthehet me teorinë e “zero sulme”, që do të thotë se çdo fitore e Perëndimit është humbje e pastër e Moskës. Zgjerimi i aleancës është parë nga Moska si një manifestim i aspiratave të Uashingtonit për hegjemoni në Ballkan, por për ta përmbyllur ndër të gjithë argumentet e sjella stabiliteti rajonal, kundër hegjemonisë, është arsyetimi strategjik që shpjegon më së miri zgjerimin e NATO-s në rajon. Në politikën e NATO-s, sigurisht që mund të identifikojmë një përpjekje për të kontribuar në stabilizimin demokratik të vendeve të Ballkanit Perëndimor që tashmë i janë bashkuar aleancës. Nga njëra anë, siç tregohet në këtë studim, shtytja drejt zgjerimit të NATO-s në rajonin tonë mund të mos ketë pasur ndikim aq të rëndësishëm në demokratizim sa shpresonin ithtarët e saj, të cilët e nisën këtë proces në mesin e viteve ‘90. Por ana tjetër, zgjerimi ka pasur një efekt shumë pozitiv në sigurinë euroatlantike. E thënë ndryshe aty ku “fqinjët” e NATO-s janë stabil, NATO është e “qetë dhe sigurt”.

Kjo do të thotë se aleanca është përpjekur të konsolidojë vizionin e përcaktuar nga sekretarja e shtetit Albright në takimin e vitit 1997, kur deklaronte se qëllimi i hapave të mëtejshëm të zgjerimit ishte që “të bëhej për Evropën Lindore ajo çfarë NATO kishte bërë 50 vjet më parë për Evropën Perëndimore: integrimi i demokracive të reja, eliminimi i urrejtjeve të vjetra, mbështetje në rikuperimin ekonomik dhe frenimi i konflikteve.”³⁰ Ngjarjet e ndodhura në Ballkan në fillim të viteve 90-të ndikuan fuqishëm në evolucionin e NATO-s pas Luftës së Ftohtë dhe anasjelltas prania aktive NATO-s në rajon jo vetëm ka parandaluar shpërthimin e armiqësive dhe zjarreve nacionaliste por ka ndihmuar secilin prej shteteve të Ballkanit Perëndimor që individualisht të bëhen pjesë e zonës euroatlantike në mënyrë të suksesshme. Larg mundësive të shpërthimit të konflikteve të armatosura serioze, paqja e rajonit mbetet e brishtë. Prandaj dhe aleanca duhet t’i rivlerësojë strategjitë ndaj rajonit për t’ju përgjigjur sfidave aktuale. Parandalimi dhe mbrojtja do të mbeten gur themeli i NATO-s dhe falë zbatimit praktik të politikës së dyerve të hapura të NATO-s, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor, tani aleatë, kontribuojnë në mënyrë aktive në të. Prandaj është e gjithë pranuese tashmë se asnjë vizion i ardhshëm i NATO-s nuk mund të dështojë të lërë jashtë Ballkanin Perëndimor si një të tërë dhe jo thjesht në skemën e sotme 3 brenda, 3 jashtë.

³⁰ Madeleine K. Albright, Prepared Statement before the North Atlantic Council, NATO Headquarters, Brussels, Belgium, February 18, 1997.

Shënim: Të gjitha idetë e shprehura në këtë artikull i përkasin autores dhe jo institucionit ku ajo punon.

Bibliografia

1. ALBRIGHT, Madeleine. Prepared Statement before the North Atlantic Council, NATO Headquarters, Brussels, Belgium, February 18, 1997
2. BECHEV, Dimitar “*Understanding Russia’s influence in the western Balkans*”, Semptember, 2018
3. BECHEV, Dimitar *Rival Power; Russia in Southeast Europe*’. Yale University Press.
4. BRZEZINSKI, Z and LAKE, A, *The Moral and Strategic Imperatives of NATO Enlargement*. International Herald Tribune, 1 July 1997.
5. KISSINGER, Henry, A World We Have Not Known, Newsweek, 27 January 1997
6. SMAÇI, Etleva. *Shqipëria në Traktatin e Varshavës*, UETPRESS, Tiranë:2023
7. TALBOTT, Strobe *The Russia Hand*, The Random House Trade Paperback Edition, 2003.
8. ZAMFIRESKU, Elena. *NATO and Balkans*, Perceptions Journal of International Affairs, March-May 1999, Volume IV, Number 1.
9. HOLBROOKE, Richard *America, A European Power*, Foreign Affairs, March/April 1995.
10. Perry, W and Warren Christopher. *NATO’s True Mission*. The New York Times, October 21, 1997.
11. WATKINS dhe GLIGORIJEVIÇ, S. *NATO dhe Ballkani: Shembulli për një integrim më të gjerë*, Çështje të Sigurisë, Instituti për Ndërmjetësim dhe Demokraci, nr.5, Tiranë:2007

Burime arkivore

12. National Archives Record Administration (NARA), Records of the U.S Department of State Relating to International Affairs of Albania, 1960 -1963, Box 1926, November 17, 1961.

Burime interneti

13. Albania, wary of Russia, reopens Soviet-era air base to NATO | Reuters
14. <https://euronews.al/en/wars-of-the-west-propaganda-nato-will-attack->

russia-through-albania-and-kosovo/ <https://sputnikglobe.com/20240305/perennial-puppet-state-albania-logic>

15. <https://shqiptarja.com/lajm/rama-gati-te-bashkefinancojme-bazen-e-re-detare-te-natos-ne-porto-romano-nato-te-garantoje-kufirin-mes-kosoves-e-serbise>
16. <https://idmalbania.org/publications/en/AlbPerceptionOnNATOintegrations.pdf>

Lufta hibride, roli i teknologjisë dhe i inteligjencës artificiale

Nënkolonel (R) Msc. Kanan HIMAJ

Trajtesë e shkurtuar.

Lufta hibride është ndër konceptet më të debatuar në shkencën bashkëkohore, në mënyrë të veçantë në atë të sigurisë dhe mbrojtjes. Një pyetje kritike ende e pazgjidhur është nëse koncepti përshkruan një fenomen krejtësisht të ri empirik? Shumë studiues pohojnë se lufta hibride është e re vetëm për aq sa teknologjitë e reja përdoren si armë luftar. Prandaj, sot shumë studiues dalin në përfundimin se lufta hibride është e kufizuar në nivelet e sigurisë njerëzore, sepse risitë teknologjike nuk e ndryshojnë rrënjësisht mënyrën se si njerëzit marrin vendime strategjike.

Ky punim (leksion i orientuar) sfidon këtë supozim bazuar në marrëdhënien midis luftës hibride, teknologjisë bashkëkohore dhe inteligjencës artificiale¹. Natyrshëm shtrohet pyetja: Në çfarë shkalle ndikon shfaqja e inteligjencës artificiale në fenomenin e luftës hibride? Në këtë aspekt, shkrimi do të synojë të argumentojë që teknologjia mund të jetë e rëndësishme vetëm për nivelet më të ulëta të luftës, ndërsa inteligjenca artificiale ka implikime të nivelit strategjik për sjelljen dhe mbrojtjen kundër luftës hibride. Kështu, në epokën e luftës hibride, risia e inteligjencës artificiale nuk kufizohet në nivelet më të ulëta të luftës, por është e përhapur gjerësisht në thellësi dhe hapësirë.

¹ Inteligenca artificiale i referohet aftësisë së një kompjuteri për të kryer funksione dhe arsyetime që aktualisht janë tipike vetëm të mendjes njerëzore.

Duke pasur parasysh natyrën shkatërruese të teknologjive të bazuara në inteligjencë artificiale², komuniteti perëndimor i sigurisë duhet të thellojë studimet e orientuara nga inteligjenca artificiale përmes partneriteteve më të forta shkencore. Sfidat dhe mundësitë diskutohen shkurtimisht duke shqyrtuar një iniciativë të fundit të organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, të ashtuquajtur “Përshpejtuesi i Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut”.

Ky punim shqyrton konceptin e luftës hibride, duke ofruar një rishikim kritik të marrëdhënies së saj me teknologjinë; fazën aktuale të zhvillimit të inteligjencës artificiale në sfondin e hulumtimit të konfliktit; përshkruan se si inteligjenca artificiale mundëson dhe kundërshton luftën hibride edhe nëse kjo ka efekte strategjike dhe së fundmi, përshkruan implikimet për Perëndimin dhe përdor DIANA si një shembull të praktikave më të mira.

Fjalë kyçe: Luftë hibride, inteligjencë artificiale, inovacion mbrojtës, NATO, BE, institucionet arsimore dhe shkencore, teknologjia e informacionit.

Hyrje

Koncepti i luftës hibride mendohet si një qasje e re ndaj luftimeve që u shfaq pas Luftës së Ftohtë. Për Frank Hoffman, arkitektin kryesor të konceptit, janë metoda të ndryshme të kombinuara për të arritur sinergji në hapësirën e betejës.³ Megjithatë, shumë studiues pohojnë se një luftë e tillë shumë modale ka ndodhur gjithashtu në të kaluarën e largët dhe janë skeptikë për luftën hibride që është një fenomen krejtësisht i ri.⁴ Ata argumentojnë se lufta hibride është e re vetëm në atë shkallë që teknologjitë e reja, të tilla si aftësitë kibernetike, i shtohen përzierjes së metodave të luftimit.

Aftësia për të vepruar në mjediset A2/AD¹¹ mbetet një nga kontributet e IA, që lidhet me zbulimin dhe parandalimin e ndërhyrje së agresionit të forcave kundërshtarë në zona të caktuara brenda rajoneve tokësore, hapësirave detare dhe atyre ajrore, me qëllim përfshirjen, ekspozimin e kontrolluar dhe të reduktuar të forcave ushtarake në operacione. IA mund të korrigjojë vendimet njerëzore dhe të ndihmojë në simulimin, trajnimin e burimeve njerëzore dhe forcave operacionale. Njësitë luftarake përdorin aktualisht sisteme të pavarura për të kryer detyra të vështira, kryesisht në dhënien e zgjidhjeve ndaj skenarëve komplekse të konflikteve, në operacionet asimetrike dhe luftën hibride.¹² IA përpunon të dhënat e mbledhura nga dronët, sensorët tokësorë, detarë dhe ajrorë, duke krijuar mundësinë për një analizë më të shpejtë dhe të saktë të situatës.

IA ka ndryshuar mënyrën e operimit të Forcave Ajrore, duke automatizuar proceset e operacioneve ajrore, analizon të dhënat nga sensorët dhe radarët, zhvillon sisteme autonome ajrore. Kjo ndihmon në zbulimin e kërcënimeve, identifikimin e objekteve dhe përmirësimin e mbrojtjes ajrore. IA përdoret gjithashtu, për zhvillimin e simulimeve të avancuara dhe modeleve të fluturimit, duke përmirësuar trajnimet dhe strategjitë operative. Megjithatë, është e rëndësishme të adresohen sfidat dhe rreziqet potenciale që mund të dalin.

¹¹ A2/AD (Anti-Access/Air-Denial) - Strategji ushtarake për të kontrolluar aksesin brenda një mjedisi operativ, hyrjen dhe manovrimin e një force kundërshtarë në një zonë operacionale.

¹² Msc. Roland Tashi, *Inteligjenca artificiale: përparësi, rreziq dhe masa mbrojtëse*; Revista-Ushtarake-qershor-2023.pdf

2.1. Roli i inteligjencës tradicionale ushtarake në fuqinë ajrore: SIGINT si urë lidhëse

Fuqia ajrore dhe inteligjenca ushtarake janë dy koncepte të ngushtë të lidhura që përmirësojnë aftësitë e mbikëqyrjes, planifikimit të operacioneve dhe marrjes së vendimeve në kohë reale. Kombinimi i këtyre elementeve rrit efektivitetin e forcave ushtarake në përballimin e sfidave të sigurisë. SIGINT (Inteligjenca e Sinjaleve) është një mjet i paçmuar që ndihmon ushtritë në mbledhjen e informacionit strategjik, operacional dhe taktik. SIGINT përfshin grumbullimin, përpunimin dhe analizimin e informacionit nga sinjale elektromagnetike. Informacioni i mbledhur ndihmon në parashikimin e kërcënimeve dhe marrjen e vendimeve të shpejta dhe efektive.¹³

SIGINT ka ndryshuar falë përparimeve teknologjike dhe përfshin elementë të luftës elektronike dhe kibernetike. Avionët dhe satelitët e pajisur me pajisje SIGINT mund të kapin sinjale nga ajri, duke mbuluar zona të mëdha gjeografike. Kjo ndihmon në monitorimin e veprimtarive në zona të largëta dhe në sigurimin e informacioneve të sakta për situatën taktike dhe strategjike.¹⁴ Megjithatë, operacionet SIGINT në hapësirën ajrore, përballen me sfida si shmangia e zbulimit nga kundërshtarët, lufta elektronike dhe menaxhimi i sasisë së madhe të dhënave të mbledhura. Për të përballuar këto sfida, është e nevojshme përdorimi i teknologjive të avancuara dhe praktikave të sigurisë operationale.

SIGINT është vendimtar për njohjen dhe parandalimin e kërcënimeve, duke ofruar informacion të vlefshëm për planifikimin dhe luftën kundër kërcënimeve elektronike. Avionët dhe dronët me pajisje ELINT (Inteligjenca Elektronike) zbulojnë dhe analizojnë sinjalet elektronike të kundërshtarëve, duke përmirësuar mbrojtjen dhe efektivitetin e operacioneve ushtarake.¹⁵

2.2. Bashkëveprimi i fuqisë ajrore dhe zbulimit (ISR).

ISR është një nga pesë misionet thelbësore të qëndrueshme të forcave ajrore dhe hapësinore.¹⁶ Me sfidat e vazhdueshme, është e domosdoshme që udhëheqësit të shfrytëzojnë plotësisht gamën e gjerë të aftësive kombëtare së bashku me ato të shërbimeve simotra, Komunitetit të Inteligjencës (IC) dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë. ISR u ofron vendimmarrësve një pamje të plotë të situatës në terren, në ajër, në det, në hapësirë dhe në hapësirën

¹³ Maxwell Goldstein, *A Guide to Signals Intelligence (SIGINT)*, January 21, 2024

¹⁴ The NSA's New SIGINT Annex January 13, 2021, the National Security Agency (NSA) a redacted version

¹⁵ <https://www.magaero.com/electronic-intelligence-elint-and-its-crucial-role-in-military-aircraft> 13 December 2023

¹⁶ Brown, Jason, *Strategy for Intelligence, Surveillance, and Reconnaissance*, Air University Press, 2014

kibernetike.¹⁷ Ekspertët e ISR vëzhgojnë sjelljen e armikut dhe ndjekin lëvizjet e tyre, për të mbledhur informacion të rëndësishëm për planifikimin luftarak. Komandantët në fushëbetejë përdorin aftësitë ISR për të mbledhur informacionin përkatës, duke përgjuar komunikimet, monitoruar lëvizjet dhe zhvilluar plane dhe strategji. Sistemet ISR mbledhin informacion nga burime të ndryshme, përfshirë komunikimet elektronike, optike, radar dhe imazhe infra të kuqe. Asetet për mbledhjen e të dhënave përfshijnë satelitë, sensorë, avionë pa pilot dhe pajisje të specializuara në tokë, det ose hapësirë.

Saktësia e të dhënave ISR është kritike për sigurimin e inteligjencës me cilësi të lartë dhe për rritjen e efektivitetit të operacioneve ushtarake. Zhvillimi i teknologjisë ka rritur kërkesën për aftësitë ISR në vitet e fundit. ISR përfshin inteligjencën, mbikëqyrjen dhe zbulimin, duke synuar të sigurojë informacion për komandantët për të mbështetur vendimmarrjen dhe planifikimin ushtarak, për të alarmuar forcat miqësore ndaj kërcënimeve dhe për të identifikuar dobësitë e kundërshtarit.

Procedurat e përbashkëta të inteligjencës e bëjnë më të lehtë kuptimin e operacioneve të ndryshme të inteligjencës dhe se si ato lidhen me njëra-tjetrën. Termat inteligjencë dhe ISR shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjellë, por dallimet e tyre janë delikate. ISR mbledh informacion dhe të dhëna të nevojshme për të përmbushur kërkesat e inteligjencës, duke prodhuar inteligjencë përmes procesit të përbashkët të inteligjencës.

2.3. Ndërveprimi i fuqisë ajrore me inteligjencën.

ISR, si një aset i përbashkët, ofron kapacitete të jashtëzakonshme për mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacioneve të inteligjencës në mbështetje të operacioneve. Kombinimi i fuqisë ajrore dhe ISR përbën një pjesë të rëndësishme të aftësive të forcave të armatosura moderne. Fuqia ajrore siguron një platformë të gjerë dhe të lëvizshme për mbledhjen e informacioneve të zbulimit, të pajisur me një gamë të gjerë pajisjesh ISR, përfshirë sensorë dhe kamera optike.

Përdorimi i avionëve të pajisur me sisteme ISR ofron një pamje të gjerë dhe të detajuar të teatrit të luftës dhe zonave të interesit.¹⁸ Informacioni i mbledhur nga platformat ISR është baza për planifikimin dhe zbatimin e operacioneve ushtarake. Fuqia Ajrore e pajisur me ISR mund të zbulojë kërcënime potenciale

¹⁷ Armed Forces Communications and Electronics Association and Intelligence & National Security Alliance, 2019 Summit: Military Service Intelligence Priorities Panel, September 24, 2019, at <https://www.youtube.com/watch?v=6-I8dt2gL9A>

¹⁸ Amble, John, "Intelligence and the Future Battlefield, with Lt. Gen. Scott Berrier," Modern War Institute, October 25, 2019, at <https://mwi.usma.edu/mwi-podcast-intelligence-future-battlefield-lt-gen-scott-berrier/>.

dhe të monitorojë veprimtarinë e kundërshtarëve, duke lejuar marrjen e masave mbrojtëse për të zvogëluar rrezikun nga kërcënimet. Përdorimi ISR nuk kufizohet vetëm në operacionet ushtarake, por ofron mbështetje për misione humanitare dhe operacione të mbrojtjes civile, duke përfshirë identifikimin e zonave të nevojshme për ndihmë humanitare dhe monitorimin e rrjedhës së refugjatëve.

Ndërveprimi i Fuqisë Ajrore me inteligjencën ISR është thelbësor për suksesin e operacioneve ushtarake dhe menaxhimin e situatave komplekse, duke përmirësuar aftësinë për të parashikuar, parandaluar dhe reaguar ndaj kërcënimeve të mundshme.¹⁹

3. Përmirësimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit midis forcës ajrore dhe inteligjencës ushtarake në Shqipëri

Në mjedisin global të sigurisë së sotme, roli i bashkëpunimit mes Forcave Ajrore dhe Inteligjencës Ushtarake është gjithnjë e më thelbësor për të përballuar sfidat, përfshirë kërcënimet asimetrike. Në Shqipëri, ky ndërveprim është veçanërisht i rëndësishëm për shkak të pozicionit gjeostrategjik të vendit në Ballkan.

Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit midis Forcës Ajrore dhe Inteligjencës Ushtarake, është një nga mënyrat kryesore për të rritur efektivitetin. Një koordinim më i mirë dhe përdorimi më i efektshëm i burimeve të inteligjencës ndihmojnë në identifikimin e kërcënimeve asimetrike dhe ofrojnë një përgjigje më të shpejtë. Krijimi i një kulture të hapur dhe bashkëpunuese, duke përfshirë specialistët e inteligjencës në stafet e Forcës Ajrore dhe anasjelltas, është thelbësor. Shfrytëzimi i teknologjive si dronët Bajraktar me softuer të integruar për transmetim *live* dhe helikopterët e pajisur me sisteme vëzhgimi ofron një avantazh të madh në operacionet ushtarake. Sensorët elektro-optik dhe infra të kuq, së bashku me teknologjitë moderne të gjetësit të rrezeve dhe emërtimit lazer, përmirësojnë saktësinë dhe efikasitetin në zbulimin dhe neutralizimin e kërcënimeve.

Të dhënat nga satelitët “Albanian 1” dhe “Albanian 2” dhe avionët e zbulimit të NATO-s “Global Hawk” ndihmojnë në prodhimin e inteligjencës me cilësi të lartë, duke ofruar mbulim të vazhdueshëm dhe informacion të rëndësishëm në lidhje me hapësirën dhe kërcënimet potenciale. Global Hawk, si sistem i zbulimit ajror pa pilot, ofron informacion në kohë reale duke përdorur IMINT, SIGINT dhe MTI.

¹⁹ <https://www.nationaldefensemagazine.org/articles/2023/5/1 JUST IN: Air Force Updating, Clarifying ISR Vision, By Laura Heckmann>

Trajnimi i përbashkët dhe zhvillimi i aftësive të përbashkëta ndihmon në krijimin e një njohurie dhe kuptimi të përbashkët të sfidave, duke përmirësuar koordinimin dhe përgjigjen ndaj kërcënimeve asimetrike. Ndërtimi i një infrastrukture të përbashkët teknologjike dhe komunikimi për shkëmbimin e informacionit në kohë reale është gjithashtu i rëndësishëm për një përgjigje më të shpejtë dhe të koordinuar ndaj kërcënimeve.

Në një mjedis të ndryshuar të sigurisë, bashkëpunimi dhe koordinimi mes forcave ajrore dhe inteligjencës ushtarake do të përmirësojnë aftësitë për të parandaluar dhe për të reaguar ndaj kërcënimeve të emergjencës së sigurisë.

Përfundime

Bashkëpunimi midis fuqisë ajrore dhe inteligjencës ushtarake, me të dhëna të nivelit strategjik, është thelbësor për kuptimin e gjithanshëm të mjedisit operacional, i cili mundëson një reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj kërcënimeve në mjedisin e luftës asimetrike. Koordinimi i informacionit dhe shkëmbimi i inteligjencës ndihmon në evidentimin dhe/ose zbutjen e rreziqeve të sigurisë.

Ndryshimet në mjedisin e luftës asimetrike kanë sjellë sfida të reja për Fuqinë Ajrore. Është e rëndësishme të zhvillohen strategji dhe taktika të përshtatshme për të përballuar këto ndryshime dhe për të ruajtur avantazhin ajror në konflikte moderne.

Teknologjitë e mbikëqyrjes/vëzhgimit ajrore dhe inteligjenca artificiale ofrojnë mundësi të mëdha për identifikimin dhe monitorimin e kërcënimeve, duke përmirësuar masat e sigurisë dhe aftësitë e përballimit.

Integrimi i inteligjencës artificiale në mjetet ajrore mund të rrisë aftësinë e tyre për zbulimin dhe identifikimin e kërcënimeve në kohë reale, duke optimizuar efikasitetin e operacioneve ajrore, sidomos të atyre jo kinetike.

Rekomandime

Shtetet duhet të investojnë në trajnime të përbashkëta dhe ndërveprime të personelit të Forcës Ajrore dhe Inteligjencës Ushtarake për të përmirësuar bashkëveprimin. Pavarësisht se Shqipëria nuk ka asete të mirëfillta ISR, ekziston mundësia që me blerjet e fundit të dronëve “Bayraktar” dhe helikopterëve “Black Hawk” të integrohen sensorë që përdoren për mbledhje informacioni inteligjence. Zhvillimi i teknologjive të avancuara për zbulimin dhe parandalimin e sulmeve elektronike, menaxhimin e spektrit elektromagnetike, përfshirë inteligjencën artificiale, duhet të jetë një prioritet për forcën tonë ajrore.

Shtetet duhet të thellojnë bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar për të ndarë informacionin dhe për të zhvilluar strategji të përbashkëta për të përballuar kërcënime asimetrike.

Një opsion për vendin tonë, do të ishte krijimi i një rrjeti të dhënave të mbikëqyrjes/vëzhgimit ajror dhe hapësinor që mund të përftohesh jo vetëm nga asetet tona kombëtare si satelitët “Albania 1” dhe “Albania 2”, dhe dronët “Bayraktar”, por edhe nga sistemet e vëzhgimit dhe zbulimit si nga platformat e helikopterëve “Cougar” dhe “Black Hawk”, por ashtu edhe nga radarët e vëzhgimit ajror.

Nga ana tjetër, vendi ynë mund të aplikojë në Aleancë për të marrë të dhënat e aseteve të NATO-s “Global Hawk” të stacionuar në Bazën Ajrore Sigonella në Itali dhe/ose nga burime të tjera të vendeve partnere.

Në Shqipëri, së bashku me rekomandimet e mësipërme, një hap i parë i mundësive reale është shfrytëzimi i të dhënave të dronve “Bayraktar”, helikopterëve “Black Hawk” dhe Cougar për qëllime të mirëfillta inteligjence duke i pajisur me sensorë dhe pajisje për interceptimeve SIGINT, krijimi i kapaciteteve teknike dhe teknologjike për ruajtjen dhe arshivimin e të gjitha të dhënave të zbulimit të përfuara nga platformat ajrore dhe hapësinore.

Mbetet sfida e forcës ajrore që të administrojë të gjitha këto të dhëna në servera/database përkatëse dhe e IASM për krijimin e protokolleve për mundësimin e aksesit, analizimit dhe shpërndarjes së produkteve të tyre te palët e interesuara.

Bibliografia

1. IA-r Force Doctrine Publication 2-0, Intelligence. 1 June 2023.
2. Dobbs, Thomas; Fallon, Garth; Fouhy, Sarah (9 September 2020). *Grey Zone*. The Forge (Report). *Australian Defence College*. Archived from the original on 8 April 2022. Retrieved 18 March 2022.
3. Jérôme Lespinois (de) , “Gjeopolitika e ajrit dhe fati i Evropës”.
4. Tami Davis Biddle IA-r power and warfare: a century of theory and history strategic studies institute and U.S. Army War College Press March 2019.
5. The Role of IA-r Power Going Into the 21st century Benjamin S. Lambeth.
6. The Future Relevance of Smaller IA-r Forces by Sanu KIA.
7. 1st Edition, Understanding Contemporary IA-r Power, By Viktoriya Fedorchak.
8. Enhancing NATO IA-r and space power in an age of Global Competition A Review of the JAPCC’s Joint IA-r and space power conference 2022 By Colonel Thomas Schroll, GE AF Joint IA-r power competence centre (2020-2022)
9. Frank G. Hoffman, conflict in the 21st Century: The rise of hybrid wars

- (Arlington, VA: Potomac institute for policy studies, 2007), p. 28av
AI lable at <http://www.potomacinstitute.org/> Accessed on February 7, 2018; Frank G Hoffman, "Hybrid Warfare and Challenges," Joint Forces Quarterly, Issue 52, 1st quarter 2009.
10. War in Ukriane by the center for preventive action updated March 06, 2024
 11. IA-r strategy and the underdog', in P. Gray (ed.), IA-r Power 21: Challenges for the New Century (London: The Stationery Office, 2000).
 12. The NSA's New SIGINT Annex January 13, 2021, the National Security Agency (NSA).
 13. A Guide to signals intelligence (SIGINT) Maxwell Goldstein MAXWELL GOLDSTEIN JANUARY 21, 2024.
 14. Inteligenca artificiale: përparësi, rreziqe dhe masa mbrojtëse Msc. Roland Tashi Revista-Ushtarake-qershor-2023.pdf.
 15. Rand corporation, military applications of artificial intelligence, ethical concerns in an uncert IA-r World, 2020.
 16. Brown, Jason, strategy for intelligence, surveillance, and recon IS science, IA-r University Press, 2014.

Burime elektronike

1. Allied IA-r Command | Home (nato.int).
2. <https://defence.IA/industry-news/atlantic-council-militaries-IA/> August 15, 2023.
3. <https://www.atlanticcouncil.org/content-series/IARpower-after-ukriane/> <https://www.IA-r>
4. andspaceforces.com/space-superiority-democratization-of-IA-r-power-are-the-future/ Sept. 21, 2022 | By Chris Gordon
5. <https://www.magaero.com/electronic-intelligence-elint-and-its-crucial-role-in-military-IArcraft> December 2023 Electromagnetic spectrum.
6. <http://www.britannica.com/EBchecked/topic/183297/electromagnetic-spectrum> (online, cit. 2015-01-10).

RUBRIKA E TRETË

ARSIMIMI DHE STËRVITJA

Mbështetja logjistike e integruar në konceptin logjistik të NATO-s

Kolonel (R) Arben DHULI

Trajtesë e shkurtuar.

Në këtë punim, kam synuar që, përmes fakteve të mbledhura nga burime profesionale të logjistikës, si nocion, të sjell në vëmendjen e lexuesit dhe kryesisht të specialistëve të fushës, risitë dhe tendencat që revolucioni teknologjik ka ofruar. Për këtë, kam analizuar termin “logjistikë e integruar”, si ndryshon ajo nga logjistika tradicionale dhe se si zbatimi i suksesshëm mund t’i ndihmojë si kompanitë private, por edhe logjistikën ushtarake të NATO-s, të kenë sukses në një mjedis kompleks dhe dinamik biznesi.

Termi “logjistikë e integruar” është përdorur në vitet 1980, të cilat shënuan një pikë kthese duke theksuar nevojën për një perspektivë holistike (një qasje ndaj kërkimit shkencor që merret me studimin e sistemeve komplekse), që integron të gjitha funksionet e logjistikës për të rritur efikasitetin dhe konkurrencën. Me futjen e teknologjisë së informacionit në vitet 1990, ajo fitoi edhe më shumë mbështetje nëpërmjet analizave moderne në kohë reale dhe sistemeve të menaxhimit të të dhënave.

Në shekullin e 21-të, logjistika e integruar është bërë një pjesë e rëndësishme e strategjisë së biznesit, e njohur për aftësinë e saj për të ulur kostot, për të përmirësuar kënaqësinë e klientëve, si dhe për të forcuar konkurrencën. I zhvilluar fillimisht për qëllime ushtarake, MIL¹ tani përdoret gjerësisht edhe

¹ Military integrated logistik

në organizatat komerciale të shërbimit ndaj klientit. Qëllimi kryesor i MIL është të krijojë sisteme që zgjasin më shumë, kërkojnë më pak mbështetje dhe në fund të zvogëlojnë kostot duke rritur kthimin e investimeve.

Mbështetja e Integruar Logjistike përfshin aspekte të ndryshme të mbështetjes, jo vetëm gjatë blerjes, por edhe gjatë gjithë ciklit të jetës operacionale të sistemit. Elementet kryesore të MIL përfshijnë inxhinierinë e besueshmërisë, planifikimin e mirëmbajtjes, mbështetjen e furnizimit, fuqinë punëtore dhe personelin, trajnimin, të dhënat teknike dhe më shumë. Duke integruar këto disiplina, MIL synon të optimizojë mbështetjen e produktit dhe të ulë kërkesën për logjistikë.

Fjalët kyçe: Mbështetja e Integruar Logjistike, strategji, mbështetja tradicionale logjistike, menaxhim, planifikim, qasje holistike, plan i integruar i mbështetjes logjistike etj.

1. Mbështetja me logjistikë të integruar (MLI)

Mbështetja e Integruar Logjistike (MIL) është një qasje gjithëpërfshirëse e disiplinuar e unifikuar ndaj menaxhimit dhe aktiviteteve teknike të nevojshme që siguron mbështetje efikase për sistemet gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor. E zhvilluar fillimisht për qëllime ushtarake, MIL tani përdoret gjerësisht edhe në organizatat komerciale të shërbimit ndaj klientit. Qëllimi kryesor i MIL është të krijojë sisteme që zgjasin më shumë, kërkojnë më pak mbështetje dhe në fund të zvogëlojnë kostot duke rritur kthimin e investimeve. Ajo përfshin aspekte të ndryshme të mbështetjes, jo vetëm gjatë blerjes, por edhe gjatë gjithë ciklit të jetës operacionale të sistemit. Elementet kryesore të MIL përfshijnë inxhinierinë e besueshmërisë, planifikimin e mirëmbajtjes, mbështetjen e furnizimit, fuqinë punëtore dhe personelin, trajnimin, të dhënat teknike dhe më shumë. Duke integruar këto disiplina, MIL synon të optimizojë mbështetjen e produktit dhe të ulë kërkesën për logjistikë.

Mbështetja e integruar logjistike² është planifikimi dhe veprimi i integruar i një numri disiplinash në bashkëpunim me njëra-tjetrën, për të siguruar disponimin e sistemit. Planifikimi i secilit element të MIL zhvillohet në mënyrë ideale në koordinim me përpjekjet inxhinierike të sistemit dhe me njëri-tjetrin. Mund të kërkojnë shkëmbime ndërmjet elementeve në mënyrë që të fitohet një sistem që është i përballueshëm (kostoja më e ulët e ciklit jetësor), funksional, i qëndrueshëm, i transportueshëm dhe i trajtuar ndaj efekteve mjedisore. Në disa raste, një proces i dedikuar i Analizës së Mbështetjes Logjistike do të përdoret për të identifikuar detyrat brenda çdo elementi të mbështetjes logjistike.

“Mbështetja e Integruar Logjistike është një strategji menaxhimi për

² <https://acc.dau.mil/CommunityBrowser.aspx?id=280255&lang=en-US>

planifikimin dhe zhvillimin e mbështetjes efikase për sistemet gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor. MIL mund të aplikohet në çdo moment gjatë zhvillimit të një produkti ose sistemi”.

Ndryshimi ndërmjet Mbështetjes së Integruar Logjistike dhe Mbështetjes Tradicionale Logjistike, vihet re në dy aspekte:

- **Qasja holistike** (një qasje ndaj kërkimit shkencor që merret me studimin e sistemeve komplekse). Sistemet trajtohen si tërësi koherente, pjesët përbërëse të të cilave kuptohen më mirë në kontekst dhe në lidhje si me njëri-tjetrin ashtu edhe me të tërën.

MIL merr një qasje gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh të gjithë ciklin e jetës së një sistemi ose produkti. Ajo mbulon fazat e planifikimit, blerjes, funksionimit dhe asgjësimit. Ndërsa mbështetja tradicionale logjistike shpesh fokusohet në aspekte specifike (p.sh., transporti, menaxhimi i inventarit), pa marrë parasysh kontekstin më të gjerë.

MIL integron disiplina të ndryshme, duke përfshirë inxhinierinë e besueshmërisë, mirëmbajtjen, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, trajnimin dhe të dhënat teknike. Ndërsa logjistika tradicionale tenton të trajtojë funksionet individuale veçmas.

MIL i jep përparësi mbështetjes gjatë gjithë jetës së sistemit. Ajo synon të minimizojë kohën e ndërprerjes, të rrisë besueshmërinë dhe të reduktojë kostot e mirëmbajtjes. Logjistika tradicionale mund t'i japë përparësi kursimeve të kostos pa theksuar mbështetjen afatgjatë.

- **Reduktimi afatgjatë i kostos.** MIL synon të reduktojë kostot e përgjithshme të ciklit jetësor duke optimizuar proceset mbështetëse. Ndërsa logjistika tradicionale mund të fokusohet më shumë në kursimet afatshkurtra të kostos.

Në përmbledhje, MIL ofron një qasje holistike dhe të integruar për mbështetjen logjistike, duke theksuar efikasitetin afatgjatë. Ndërsa logjistika tradicionale priret të jetë më e fragmentuar dhe reaktive.

Po japim disa shembuj të Mbështetjes së Integruar të Logjistikës (MIL) të cilat janë:

- **Menaxhimi i inventarit vetëm në kohë:** Një strategji që minimizon nivelet e inventarit duke ofruar materiale ose pjesë saktësisht kur nevojiten, duke reduktuar kostot e magazinimit dhe mbetjet.
- **Sistemet e gjurmimit në kohë reale:** Zbatimi i teknologjive si ajo GPS për të monitoruar lëvizjen e mallrave, automjeteve ose aseteve në kohë reale.
- **Menaxhimi efikas i magazinës:** Optimizimi i paraqitjes së magazinës, vendosja e inventarit dhe proceset e përmbushjes së porosive për të rritur efikasitetin dhe për të ulur kostot.

- **Bashkëpunimi me furnizuesit:** Koordinim i ngushtë me furnitorët për të siguruar dërgesat në kohë, kontrollin e cilësisë dhe burimet me kosto efektive.
- **Optimizimi i rrugëve të shpërndarjes:** Përdorimi i analitikës së të dhënave dhe softuerit të planifikimit të rrugës për të minimizuar kohën e transportit, konsumin e karburantit dhe vonesat e dorëzimit.
- **Përdorimi i teknologjive të informacionit:** Përdorimi i sistemeve softuerike për menaxhimin e inventarit, përpunimin e porosive dhe dukshmërinë e zinxhirit të furnizimit.
- **Riciklimi dhe paketimi i qëndrueshëm:** Përfshirja e praktikave (miqësore) me mjedisin në logjistikë, të tilla si riciklimi i materialeve dhe përdorimi i paketimeve të ndërgjegjshme për mjedisin.
- **Trajnimi i vazhdueshëm i personelit:** Sigurimi që stafi i logjistikës të marrë trajnime të vazhdueshme për të qëndruar i përditësuar mbi praktikatat më të mira dhe teknologjitë e reja.

Këta shembuj ilustronë sesi logjistika e integruar nuk është vetëm një teori strategjike, por një realitet operacional që drejton suksesin e kompanive të ndryshme në industri të ndryshme. Zbatimi efektiv i këtyre qasjeve tregon aftësinë e logjistikës së integruar për të përmirësuar efikasitetin, për të ulur kostot dhe për të forcuar pozicionin konkurrues në treg.

Kompanitë e logjistikës gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në këtë skenar dhe kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të logjistikës së integruar. Logjistika integrale jo vetëm që luan një rol vendimtar në mjedisin e sotëm të biznesit, por rëndësia e saj do të vazhdojë të rritet në mënyrë të qëndrueshme në të ardhmen.

2. Logjistika e integruar, pjesë e rëndësishme e strategjisë së biznesit

Logjistika e integruar, e cila u shfaq si një paradigmë revolucionare në menaxhimin e biznesit, ka pësuar një zhvillim të jashtëzakonshëm që nga shfaqja e saj e parë në vitet 1950. Fillimisht e fokusuar në logjistikë dhe transport, globalizimi dhe kompleksiteti i zinxhirëve të furnizimit kanë çuar në një tranzicion të qartë drejt një strategjie të integruar. Vitet 1980 shënuan një pikë kthese për termin “logjistikë e integruar”, duke theksuar nevojën për një perspektivë holistike që integron të gjitha funksionet e logjistikës për të rritur efikasitetin dhe konkurrencën. Me futjen e teknologjisë së informacionit në vitet 1990, ajo fitoi edhe më shumë vull nëpërmjet analizave moderne në kohë reale dhe sistemeve të menaxhimit të të dhënave.

Në shekullin e 21-të, logjistika e integruar është bërë një pjesë e rëndësishme

e strategjisë së biznesit, e njohur për aftësinë e saj për të ulur kostot, për të përmirësuar kënaqësinë e klientëve dhe për të forcuar konkurrencën. Nga fillimet e vogla në një rol qendror në strategjitë e sotme, logjistika e integruar po shfaqet si një forcë transformuese që po evoluon vazhdimisht për të përballuar sfidat e së nesërme. Përkufizimi i logjistikës së integruar si një qasje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, nga prokurimi i lëndëve të para deri te dorëzimi përfundimtar i produkteve te klientët. Të gjitha elementet logjistike, duke përfshirë transportin, magazinimin, përbushjen dhe shpërndarjen, janë të koordinuara në mënyrë efikase, duke siguruar qetësi dhe efikasitet në çdo fazë të procesit.

Dallimi midis logjistikës dhe logjistikës së integruar është më shumë se nuanca semantike. Ai përfaqëson një ndryshim thelbësor në mënyrën se si kryhet menaxhimi i zinxhirit të furnizimit. Ndërsa logjistika tradicionale fokusohet në detyra specifike, të grimcuara, të tilla si transporti ose magazinimi, logjistika e integruar përfshin një qasje holistike. Një qasje holistike merr në konsideratë të gjithë personin, jo vetëm nevojat e tij për shëndetin mendor. Ai gjithashtu merr parasysh mirëqenien e tyre fizike, emocionale, sociale dhe shpirtërore.

Dëgjimi, pyetja dhe kontrollimi janë aftësi kyçe kur ofrohet mbështetje gjithëpërfshirëse, duke ditur se përvoja e çdo personi është unike dhe e ndikuar nga faktorë të ndryshëm si moshja, kultura dhe besimet. që kërkon të integrojë dhe optimizojë të gjitha aktivitetet. Logjistika tradicionale tenton të adresojë problemet afatshkurtra dhe aktivitetet specifike pa marrë gjithmonë parasysh marrëdhëniet dhe varësitë midis pjesëve të ndryshme të zinxhirit të furnizimit. Logjistika e integruar, nga ana tjetër, merr një perspektivë afatgjatë dhe pranon se të gjitha funksionet e logjistikës duhet të koordinohen për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm. Fokusi ndaj klientit është një tjetër diferencues. Ndërsa logjistika tradicionale fokusohet më shumë në uljen e kostove operative, logjistika e integruar shkon më tej duke i dhënë përparësi përmirësimit të vazhdueshëm të përvojës së klientit.

Ne i kushtojmë vëmendje të veçantë faktorëve të tillë si koha e dorëzimit, disponueshmëria e produktit dhe aftësia për t'u përshtatur me kërkesat në ndryshim të tregut. Në praktikë, logjistika e integruar përfshin bashkëpunim të ngushtë midis departamenteve të ndryshme brenda një kompanie dhe futjen e teknologjive të avancuara. Çelësi është të pranohet se çdo element i zinxhirit të furnizimit është i ndërlidhur dhe se përmirësimi i tij do të ketë një ndikim pozitiv në performancën e përgjithshme.

Si përfundim, ndryshimi i rëndësishëm ndërmjet logjistikës tradicionale dhe logjistikës së integruar qëndron në qasjen dhe filozofinë e tyre. Kështu që Logjistika e integruar kërkon pjekurinë globale duke parë të gjithë zinxhirin e furnizimit. Ndërsa Logjistika tradicionale fokusohet në komponentë

individualë. Ky ndryshim në perspektivë është thelbësor në një botë biznesi që kërkon efikasitet, fleksibilitet dhe përvoja të jashtëzakonshme të klientit. Logjistika e integruar përqendrohet në fleksibilitet, duke u mundësuar kompanive të përshtaten shpejt me ndryshimet në kërkesën e tregut duke shmangur rezervat e tepërta ose duke shmangur stoqet.

Për të krijuar një sistem logjistik gjithëpërfshirës, që plotëson nevojat e tregut të sotëm dhe është i pozicionuar në mënyrë strategjike për të përmbushur sfidat e biznesit të së nesërme, është e nevojshme ndërthurja e objektivave të mëposhtëm:

Bashkëpunimi i brendshëm dhe i jashtëm: nxitja e bashkëpunimit të ngushtë me partnerë të jashtëm në të gjitha departamentet e kompanisë dhe në të gjithë zinxhirin e furnizimit për të promovuar komunikim efektiv dhe vendimmarrje të përbashkët.

Qëndrueshmëria: minimizimi i ndikimit mjedisor të zinxhirit të furnizimit, duke marrë parasysh praktikatat e qëndrueshme të logjistikës.

Përmirësimi i vazhdueshëm: logjistika e integruar përpiqet të zbatojë një proces përmirësimi duke vlerësuar vazhdimisht operacionet dhe duke zbatuar rregulla për të ruajtur efikasitetin afatgjatë.

Integrimi efektiv i logjistikës së integruar në një kompani përfshin bashkëpunim të ngushtë midis të gjitha departamenteve që lidhen me zinxhirin e furnizimit. Zbatimi i teknologjive të avancuara të informacionit, të tilla si: softueri i logjistikës, sistemet e menaxhimit të depove dhe softueri TMS, është thelbësor për të koordinuar në mënyrë efikase operacionet. Përveç kësaj, trajnimi i stafit dhe përafrimi i objektivave të biznesit me strategjitë e logjistikës janë thelbësore për sukses.

3. Analiza e mbështetjes logjistike

Analiza e mbështetjes logjistike është kritike për rritjen e efikasitetit të mirëmbajtjes dhe uljen e kostove të mbështetjes duke planifikuar paraprakisht të gjitha aspektet e MIL. Ndikimi i logjistikës në ekonominë globale ka dy efekte mbi organizatat dhe ekonominë globale. Së pari, një kompani kryen shpenzime të shumta, një prej të cilave është kostoja e logjistikës. Këto shpenzime dhe kosto logjistike ndikojnë në vendimet ekonomike dhe anasjelltas. Së dyti, logjistika lejon shitjen e produkteve dhe shërbimeve, si dhe shërbimin e lidhur me klientët dhe një sërë operacionesh ekonomike. Shumë biznese i kushtojnë një vlerë të lartë shërbimit ndaj klientit dhe logjistika mund t'i ndihmojë ata të fitojnë një avantazh konkurrues. Një MIL i suksesshëm kërkon zbatimin e një plani të integruar të mbështetjes logjistike (PIML). Ky plan krijohet gjatë fazës së konceptit të prokurimit të sistemit dhe përditësohet gjatë gjithë ciklit jetësor të sistemit.

Më poshtë janë disa nga avantazhet e zbatimit efektiv të një plani të integruar të mbështetjes logjistike (PIML):

- Një sistem më efektiv që përdoret nga klienti gjatë gjithë jetëgjatësisë së sistemit.
- Një sistem që i përmbahet deklaratave operative dhe të kërkesave të përdoruesit gjatë gjithë ciklit jetësor të sistemit.
- Një biznes më efikas që plotëson buxhetet duke projektuar në mënyrë realiste, duke matur shpenzimet aktuale dhe duke shmangur surprizat.
- Nuk do të ketë përmirësime, modifikime apo riparime të kushtueshme në krizë si rezultat i aktiviteteve të parakohshme.
- Nëpërmjet këtij plani shmangen dështimet e kushtueshme në produktet vitale, të shtrenjta dhe që kërkojnë kohë. Gjithashtu ruajtja e të dhënave, komunikimi dhe teknologjia e informacionit (IT) kanë një rritje teknologjike në kapacitet. Sasia e dokumentacionit të prodhuar në një mjedis inxhinierik (do të mbushte ngarkesat e kamionëve nëse printohej). Për fat të mirë, në ditët e sotme, këto dokumente mund të ruhen në mënyrë elektronike.
- Një mënyrë për të menduar për këtë proces është si një proces i vazhdueshëm përmirësimi i cili do të thotë se çdo detaj do të shqyrtohet dhe rregullohet mirë për të maksimizuar funksionalitetin. Kjo mund të arrihet nëpërmjet përdorimit të shërbimeve të tilla si: mirëmbajtja rutinë, riparimet, kurset e trajnimit dhe testet. Pas testimit, krijohet një raport që përshkruan rekomandimet për ndryshim ose përmirësim. Ai do të identifikojë gabimet e njohura që ndërhyjnë në efikasitetin operacional, ngadalësojnë proceset dhe shkaktojnë pakënaqësi të punonjësve dhe menaxhmentit. Kjo është arsyeja pse është thelbësore për të zhvilluar kompetencat e këtyre individëve në mënyrë që ata të mund të lulëzojnë në një atmosferë me kërkesa të larta dhe me presion të lartë.
- Dy mënyra të zakonshme janë testimi psikometrik dhe/ose i aftësisë. Këto do t'ju ndihmojnë të përcaktoni personalitetin, aftësitë dhe talentet e një punonjësi. Më pas, menaxhmenti mund ta përdorë këtë informacion për të caktuar individët në role bazuar në rezultatet e këtyre vlerësimeve. Kjo është metoda më e shpejtë dhe më e drejtpërdrejtë për të zbuluar një përputhje të përsosur midis të dyjave.


Forma dhe funksionaliteti efektiv operacional i mbështetjes së produktit dhe sistemeve të shërbimit ndaj klientit varet nga mirëmbajtja rutinë. Është thelbësore në MIL që të ketë funksionim optimal të sistemit, i cili mund të arrihet përmes një plani të rregullt të përditësimit, mirëmbajtjes dhe riparimit. Kjo strategji proaktive dhe jo reaktive siguron që një sistem të jetë gjithmonë i shëndoshë operacionalisht. Kjo zvogëlon gjasat e një humbje prodhimi të shkaktuar nga një avari, ndërprerje ose mosfunksionim i sistemit. Pasojat e

dështimit të pajisjeve për shkak të mungesës së mirëmbajtjes mund të jenë të rënda. Modeli tradicional i biznesit merr parasysh shpenzimet e riparimeve dhe, duke përdorur një qasje afatshkurtër, e bën këtë vetëm kur lind një problem. Marrja e një pamje afatgjatë me MIL është një procedurë afatgjatë që synon të parandalojë shfaqjen e problemeve. Ata përdorin më së miri burimet e disponueshme duke zbatuar një sërë masash mbështetëse gjatë gjithë jetës së projektimit të një produkti ose sistemi të shërbimit ndaj klientit. Shumë kompani bëjnë gabim duke u fokusuar vetëm në mbijetesën afatshkurtër. Në tregun e sotëm ultra-konkurrues, kjo mund të jetë një recetë për katastrofë. Qasja e Mbështetjes së Integruar të Logjistikës (MIL) siguron qëndrueshmërinë dhe suksesin afatgjatë të një kompanie. Programet MIL shkurtojnë mbetjet, thjeshtojnë operacionet dhe u japin punonjësve tuaj më shumë kontroll.

4. Mbështetja logjistike e blerjes

Zbatimi i strategjisë për blerjen/prodhimin e ri të materialit ofron mundësinë për të maksimizuar ndikimin e dobishëm të elementeve jo vetëm gjatë fazës së blerjes, por gjatë gjithë ciklit të jetës së tij operacionale. Mbështetja Logjistike e blerjes ka përvojë/ekspertizë në kryerjen e mbështetjes logjistike në faza të ndryshme të procesit të blerjes. Ajo përdor Kornizën e Përvetësimit të Mbrojtjes (DAF) të përshkruar më poshtë si një udhëzues për menaxhimin e programeve të blerjes së sistemit.

Acquisition Logistics



Pra, tabela e mësipërme sqaron qartë se **blerja para sistemit** ka në vetvete si fazë të parë përzgjedhjen e materialeve (faza e analizimit) dhe fazën e zhvillimit teknologjik, ndërsa **sistemi i blerjes** përfshin Fazën e Zhvillimit dhe Prodhimit Inxhinierik dhe Fazën e prodhimit dhe të zhvillimit, dhe e fundit është **mbajtja** që përfshin operacionet dhe fazën e mbështetjes.

Procesi i planifikimit të logjistikës së blerjes përfshin një rishikim të aftësive të sistemit dhe analizën e çështjeve dhe shqetësimeve të besueshmërisë, mirëmbajtjes dhe mbështetjes së sistemit ekzistues.

- Të dhënat nga analiza përdoren për të përcaktuar strategjinë e mbështetjes dhe konceptin e mirëmbajtjes. Strategjia mbështetëse identifikon qasjen e programit për të përmbushur objektivat e logjistikës së ciklit jetësor. Koncepti i mirëmbajtjes përcakton në terma të gjerë se si sistemi do të mirëmbahet për të përmbushur objektivat e pragut të disponueshmërisë. Strategjia e mbështetjes dhe koncepti i mirëmbajtjes përbëjnë themelin e procesit të zhvillimit të mbështetjes së produktit.

- Hapi tjetër në procesin e planifikimit të logjistikës së blerjes është kryerja e anketave të tregut për të përcaktuar nëse tendencat aktuale të projektimit adresojnë përsosin më tej çështjet dhe identifikojnë tendencat e tregut ku duhet të fokusohemi. Bazuar në analizën e kryer, strategjia e mbështetjes është dedikuar për të përzgjedhur alternativën e mbështetjes me kosto efektive për sistemin dhe konceptin e mirëmbajtjes së tij.

Përfundime

- Perspektiva e së ardhmes për logjistikën e integruar në botën e biznesit po shfaqet si një mundësi kyçe e suksesit të logjistikës ushtarake kombëtare por dhe të NATO-s.

- Ndërsa kompanitë përpiqen vazhdimisht të përmirësojnë operacionet dhe të përmbushin pritshmëritë e klientëve, zbatimi efektiv i logjistikës në fund po bëhet një diferencues kryesor.

- Aftësia për të përqaftuar inovacionin teknologjik, për t'iu përgjigjur sfidave mjedisore, për t'u përqendruar në përvojën e klientit dhe për të nxitur bashkëpunimin global po vendoset si një element kyç i strategjisë që ndihmon organizatat private dhe shtetërore jo vetëm të mbijetojnë, por edhe të lulëzojnë në një mjedis dinamik biznesi.

- Entet shtetërore përfshirë këtu edhe ato ushtarake edhe në këtë fushë duhet të ndjekin ritmin, idetë dhe procesin transformues teknologjik të sipërmarrjeve private, pasi ata janë në pararojë të implementimit të “logjistikës së integruar”.

Bibliografia

1. US Defense Acquisition University on Integrated Logistics Support (ILS) Elements
2. James V. Jones, *Integrated Logistics Support Handbook*, third edition.
3. United Kingdom Ministry of Defence (UK MoD) Through Life Support (TLS) - Directorate into the following elements and promulgated in UK Defence Standard (DEFSTAN) 00-600
4. “Defense Acquisition University”. *Archived from the original on 2009-04-*

23. Retrieved 2016-07-06 SX000i - International guide for the use of the S-Series of Integrated Logistics Support (ILS) specifications

5. Doktrina Logjistike e FARSH.
6. NATO Logistics Handbook, STANAG 2115. Njësia bazë e konsumit të karburantit (Fuel consumption unit).

Forca përmes dijes: Roli kyç i Edukimit Ushtarak Profesional në sigurinë kombëtare të Shqipërisë

Kolonel (R) Dr. Çlirim TOCI

Kolegji i Vendeve të Baltikut, Estonia

Trajtesë e shkurtuar.

Në një botë që ndryshon me shpejtësi dhe ku sfidat e sigurisë kombëtare zhvillohen çdo ditë, Shqipëria, si anëtare e NATO-s që nga viti 2009, është në një kërkim të vazhdueshëm për të zhvilluar dhe përsosur sistemin e saj arsimor ushtarak. Ky sistem nuk është thjesht një platformë për të mësuar teknikat dhe strategjitë e luftës, por një bazë për të ndërtuar dhe formuar udhëheqësit e ardhshëm ushtarakë që do të përballojnë sfidat e një mjedisi kombëtar dhe ndërkombëtar të ndërlikuar dhe të pandalshëm. Siç thotë rilindësi i madh shqiptar, Naim Frashëri: ‘dhe drita e dijes, gjithmonë përpara do na shpjerë’, kështu edhe ne kërkojmë që drita e dijes të udhëheqë ushtarakët tanë drejt një të ardhmeje më të sigurt dhe më të qëndrueshme.

Edukimi Ushtarak Profesional (EUP) në Shqipëri synon të përgatitë individë të aftë për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin kombëtar nëpërmjet një kuptimi të thellë të kërcënimeve tradicionale dhe jotradicionale. Përgatitja e ushtarakëve është një mision i ndërlikuar që kërkon një përshtatje ndaj një mjedisi strategjik që ndryshon vazhdimisht.

Ky shkrim do të trajtojë rolin e EUP si një kolonë e sigurisë kombëtare, duke ndërtuar një trupë ushtarake të përgatitur dhe të përkushtuar. Do të analizojë rolin e edukimit në përbaljen e sfidave të sotme dhe të ardhshme dhe një përmirësim të vazhdueshëm të zhvillimeve në EUP, duke u bazuar në përvojat dhe praktikatat më të mira të vendeve anëtare të NATO-s dhe vendeve të Baltikut.

Fjalët kyçe: Edukimi Ushtarak Profesional, NATO, mjedis strategjik, sistemi arsimor ushtarak, aftësi drejtuese, siguri kombëtare etj.

1. Rëndësia e edukimit ushtarak profesional: domosdoshmëri dhe nevojë për të ardhmen

Siguria kombëtare e Shqipërisë është një koncept i gjerë që përfshin shumë aspekte të ndryshme të mbrojtjes dhe mirëqenies të vendit. Një nga faktorët kyç për forcimin e kësaj sigurie është Edukimi Ushtarak Profesional, i cili është thelbësor për përgatitjen e individëve për rolet dhe përgjegjësitë ushtarake. EUP përfshin një gamë të gjerë përgatitjesh dhe zhvillimesh, që synojnë të përgatisin individët jo vetëm me njohuri teknike dhe taktike, por edhe me aftësi strategjike, mendimin kritik dhe aftësitë drejtuese (leadership).

Çfarë kuptojmë me EUP?

Në kushte të tilla, përgatitja e ushtarakëve, duhet të marrë një rëndësi të veçantë. Të mësuarit dhe dija janë dy koncepte, të cilat ndikojnë jo vetëm në përgatitjen e ushtarakëve por edhe në përmirësimin dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura (FA). Siç thekson ish-presidenti i SHBA, J.F. Kennedy, “Drejtimi dhe mësimi janë të pandashme nga njëri-tjetri.” Ky parim është themelor për të kuptuar rëndësinë e EUP në përgatitjen e drejtuesve ushtarakë dhe në zhvillimin e FA-ve.

Dokumenti i miratuar nga NATO në vitin 2011, ‘Generic Officer: Professional Military Education – Reference Curriculum’, thekson se ‘qëllimi themelor i arsimimit është të ngulitë dëshirën dhe aftësinë për të mësuar vazhdimisht. Sipas Eric Hoffer ‘arsimimi nuk ka për qëllim vetëm të prodhojë njerëz të përgatitur, por të formojë individë që e duan të mësuarit dhe vazhdojnë të mësojnë në mënyrë të pavarur’.¹ Kjo qasje ndaj EUP thekson rëndësinë e zhvillimit të mendimit kritik dhe aftësive për zgjidhjen e problemeve, që janë thelbësore për personelin ushtarak dhe civil të FA-ve.

Roli i EUP-së në Sigurinë Kombëtare.

EUP ka një rëndësi strategjike dhe shërben si gur themeli në sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Ky edukim pajis drejtuesit ushtarakë me cilësitë dhe aftësitë e nevojshme për të përballuar dhe kontrolluar sfidat e sigurisë në shekullin e 21-të. Nëpërmjet EUP-së, zhvillohet mendimi krijues dhe zgjerohen dijet, të cilat janë të rëndësishme për përshtatjen dhe ndryshimin e mjedisit të sigurisë.²

Cila është lidhja dhe ndërveprimi midis EUP dhe sigurisë kombëtare? Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme e cila në radhë të parë kërkon të kuptojmë lidhje midis këtyre dy koncepteve dhe ndikimit të tyre në përgatitjen e personelit.

¹ NATO (2011) ‘Generic Officer Professional Military Education: Reference Curriculum’, p.4.

² Mie Augier and Wayne Hughes (2019) ‘Innovative Thinking: The Role of Professional Military Education’, <https://cimsec.org/innovative-thinking-the-role-of-professional-military-education/>, gjetur më 05 qershor 2024.

EUP është thelbësore për Sigurinë Kombëtare të Shqipërisë, pasi ofron bazën teorike dhe aftësitë praktike të nevojshme për zbatimin efektive të politikave të mbrojtjes kombëtare. Kurrikula e EUP-së shpesh përafrohet me dokumentet kryesore strategjike, duke siguruar që udhëheqësit ushtarakë janë përgatitur për të mbështetur dhe zbatuar strategjinë kombëtare.³ Kjo lidhje siguron që të diplomuarit e EUP-së janë të aftë jo vetëm në njohjen e strategjive të mbrojtjes, por edhe në kontributin e tyre në zhvillimin e këtyre strategjive.

Përgatitja e udhëheqësve ushtarakë për mjedisin e ri të sigurisë.

Një sistem i zhvilluar i EUP-së luan një rol të rëndësishëm në ruajtjen e vlerave kombëtare dhe në përgatitjen e ushtarakëve për të mbrojtur interesat e vendit.⁴ Njëpërmjet EUP-së ushtarakët fitojnë aftësitë për të përcaktuar prioritetet dhe interesat kombëtare dhe për të mbështetur parimet e sigurisë kombëtare. Edukimi i vazhdueshëm dhe përshtatja me sfidat e reja ndihmojnë në sigurimin e një ushtrie të mirë trajnuar dhe të arsimuar, e cila është e gatshme të përballojë tensionet dhe konfliktet që mund lindin në rajon dhe më gjerë. Përveç kësaj, EUP luan rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe vlerësimin e vlerave kombëtare. Ky sistem ngulit te personeli ushtarak ndjenjën e detyrës dhe përgjegjësisë në mbrojtjen e vlerave kombëtare dhe zhvillimin e vendit, e cila është e lidhur ngushtësisht me cilësinë e nivelit arsimor të bashkëkombësve tanë.

Sistemi i EUP i rekomanduar nga NATO.

Në vitin 2011, NATO prezantoi një propozim mbi zhvillimin dhe funksionimin e EUP-së, me qëllimin mbështetjen e vendeve të NATO-s dhe ato partnere në ndërtimin e një sistemi funksional për përgatitjen e ushtarakëve dhe civilëve. Në sistemin e rekomanduar nga NATO (shih tabelën nr.1)⁵ paraqiten tre nivele të EUP-së. Ky propozim nuk prezanton dhe nuk rekomandon se si do të bëhet përgatitja e ushtarakëve dhe civilëve në nivelin e katërt (të fundit të EUP). Sistemi i EUP-së në Shqipëri dhe i vendeve të Baltikut e ka të përfshirë përgatitjen e nivelit të katërt. Mungesa e këtij niveli mund të krijojë së pari paqartësi në kuptimin dhe funksionimin e EUP- së dhe së dyti sa i vlefshëm do të jetë ky sistem për vendet e NATO-s dhe ato partnere.

Mungesa e koordinimit ose e përfshirjes së nivelit të katërt mund të paraqesë për shembull për FA të RSH, vështirësi në aplikimin e formulës së propozuar.

³ S. Huffington, A Oler, and D Tretler (2021) ed 'A National Security Strategy Primer ... The Assumptions pivotal to the National Security Strategy', National Defence University Press, Washington, D.C. p. 7.

⁴ S. I Radda (2014) 'The Role of Education in Promoting National Security', Sociologica Department, Bayero University, Kano, Nigeria, pp ...

⁵ NATO, PfP Consortium and Canada., Generic Officer Professional Military Education: Reference Curriculum, NATO publication 2011, p. 5-6.

Mungesa e nivelit të katërt mund të krijojë probleme në ekuivalentimit e programeve mësimore dhe studentëve të cilët vijnë nga vende të tjera, për të studiuar në sistemin e EUP-së të Republikës së Shqipërisë. Në kapitullin pasardhës, lexuesi do të ketë mundësi të marrë dhe kuptojë më shumë mbi nivelet e EUP-së në FA të RSH.

Nivelet e edukimit	Funksionet	Grada
Kursi bazë i përgatitjes të oficerit	Të aftë për të drejtuar trupat në nivelin e togës	OF1/OF2 (Nëntoger/Toger)
Oficerët e rinj	Të aftë për të drejtuar trupat në nivelin e kompanisë	OF3/Major (i sapo graduar)
Niveli i mesëm/lartë	Të projektuar për të shërbyer shtabet e përgjithshme të komandimit për nivelet batalion, brigade etj.	OF3/OF4 (Major (me eksperiencë)/Nënkolonel)

Tabela nr. 1: Sistemi i EUP i rekomanduar nga NATO

Sistemi i EUP në Kolegjin e Vendeve të Baltikut.

Kolegji i Vendeve të Baltikut është krijuar në vitin 1999, si element i rëndësishëm në rritjen dhe përsosjen e përgatitjes së oficerëve dhe civilëve nga vendet krijuese si: Estonia, Letonia dhe Lituania. Ish-presidenti i Estonisë z. Lennart Mery në ceremoninë e hapjes së kolegjit do të theksonte tre detyra kryesore për t'u ndjekur në përgatitjen e studentëve:

- 1) Ndërtimi i një bashkëpunimi sa më të ngushtë midis tre vendeve të Baltikut në përballimin e sfidave të sigurisë.
- 2) Forcimi dhe përgatitja sa më mirë e strukturave të forcave të armatosura.
- 3) Angazhimi me fqinjët në krijimin e paqes në rajon.⁶

Që nga ajo kohë Kolegji ka një mision shumë të rëndësishëm në përgatitjen e udhëheqësve të së ardhmes më cilësitë e nevojshme dhe aftësitë krijuese në kuptimin sa më mirë të sfidave të sigurisë. Kurrikula është e hartuar për të përballuar sfidat e ndërlikuara në rajonin e detit të Baltikut me vëmendje të veçantë mbi Federatën Ruse, rolin dhe interesat e NATO-s dhe BE-së.⁷ EUP në vendet e Baltikut përfshin një numër kursesh dhe programesh të përgatitjes dhe arsimimit të oficerëve të rinj dhe të oficerëve të niveleve të larta. Në sistemin e EUP-së, ka katër nivele të përgatitjes dhe zhvillimit. Niveli i parë dhe i dytë ofrojnë përgatitjen bazë dhe arsimimin e oficerëve të rinj. Këto nivele përgatitjeje janë përgjegjësi e vendeve të Baltikut.

⁶ Corum J., Johanson A., (Quoted here) 20th Years of the Baltic Defence College: Professional Military Education in the Baltic States, Valipress OU Estonia, 2019, pp. 5.

⁷ BALTFDECOL, HCSC 2024 Course Plan (Plani i Kursit), Tartu, Estonia, fq. 5-6 & 20

Ndërsa kolegji është përgjegjës për nivelin e tretë (kursin e Komandave dhe Shtabeve të Bashkuara) dhe nivelin e katërt kursin e lartë (të studimeve të komandimit). Kjo përjasje në lidhje me përgatitjen dhe zhvillimin e oficerëve paraqitet në tabelën nr. 2.⁸

Niveli i Parë	Niveli i Dytë	Niveli i Tretë	Niveli i Katërt
Niveli Bazë	Oficeri i Ri	I avancuar	Niveli i Lartë
Niveli Taktik	Niveli Taktik	Niveli Operacional	Niveli Strategjik
Niveli bazë dhe kurset për specialitet	Kursi i Kapitenit dhe Kursi i nivelit të mesëm	Kursi i Komandave dhe Shtabeve të Bashkuara	Kursi i Lartë i Studimeve të Komandimit
Akademia kombëtare ose ndërkombëtare	Akademia kombëtare ose ndërkombëtare	Kolegji i Vendeve të Baltikut ose Kolegje ndërkombëtare ose të luftës	Kolegji i Vendeve të Baltikut ose Kolegje ndërkombëtare ose të luftës
OF 1 (Nëntoger)	OF 1 – OF 2 (Nëntoger-Toger)	OF 3 – OF 4 (Major-Nënkolonel) dhe civil	OF 4 – OF 5 (Nënkolonel-Kolonel) dhe civil

Tabela nr. 2 Sistemi i EUP-së të Vendeve të Baltikut

2. Vështrimi historik dhe vizioni i EUP në FA


EUP-ja në Shqipëri ka një histori të gjatë dhe komplekse, duke luajtur një rol thelbësor në përgatitjen e trupave ushtarake për sfidat e sigurisë. Historia fillon nga periudha e shtetit të Arbrit, ku familjet fisnike si Ballshajt, Muzakajt, Dukagjinasit dhe Kastriotët mbanin forca të armatosura të trajnuara dhe të paguara individualisht për të përballuar situatat luftarake. Në raste të veçanta, këto familje kontribuonin për ushtrinë e shtetit të Arbrit. Më konkretisht, origjina e zhvillimit të edukimit ushtarak fillon në vitet 1797-1822, ku pashallëku i Janinës, me në krye Ali Pashë Tepelenën, në Bonilë, krijoi shkollën e parë të artilerisë, xhenios dhe kalorësisë, me pjesëmarrjen e instruktorëve francezë, italianë dhe shqiptarë. Në fund të shekullit XIX, Shqipëria u përball me sfida të mëdha nga Perandoria Osmane dhe ambiciet e Perandorisë Ruse. Në këtë periudhë, u krijua Lidhja e Prizrenit (1878), e cila synonte mbrojtjen e territoreve shqiptare dhe krijimin e një shteti të pavarur. Lidhja organizoi dhe mobilizoi forcat ushtarake, megjithëse përballoi vështirësi të mëdha.

Pas shpalljes së pavarësisë në 1912, ushtarakët shqiptarë ishin kryesisht të përgatitur në shkollat osmane. Gjatë Luftës së Parë Botërore (1913-1919),

⁸ HCSC (Higher Command Studies Course/Kursi i Lartë i Studimeve të Komandimit), zhvillimi i kurrikulës, (2024), Tartu, Estoni, fq. 6.

vende si Austro-Hungaria, Italia dhe Franca kontribuan në përgatitjen e ushtarakëve shqiptarë. Në 1919, qeveria e përkohshme hapi një shkollë për përgatitjen e oficerëve dhe xhandarëve.

Institucionalisht shkolla e parë ushtarake u krijuar më 26 tetor 1926. Nga 1920 deri në 1939, në Shqipëri funksionuan shkolla që ofronin kurse gjashtëmujore për përgatitjen e oficerëve. Mbretëria Shqiptare e asaj kohe krijoi shkollën për përgatitjen e ushtarakëve në vitin 1928. Ndërsa, gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ushtria Nacionalçlirimtare (UNÇL) përgatiti kuadrot e saj në kushte të vështira, sipas nevojave luftarake. Pas çlirimit të Shqipërisë më 29 nëntor 1944, autoritete vendore të asaj kohe, vendosën të krijonin bazat e edukimi ushtarak, duke krijuar më 8 nëntor 1944 Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, që më vonë mori emrin “Enver Hoxha”. Kjo shkollë përgatiste oficerët për armët e këmbësisë, artilerisë dhe prapavijës. Gjithashtu, në Vlorë u hapën shkollat për përgatitjen e oficerëve të detarisë dhe aviacionit. Ndërsa Shkolla e Mesme Ushtarake Skënderbej u krijua më 28 mars 1945, për përgatitjen e partizanëve të rinj. Vendimi përfundimtar u mor më 10 maj 1958, duke krijuar bazën ligjore për krijimin e Shkollës së Lartë Ushtarake. Më vonë më 15 shtator 1961, me vendim të qeverisë u emërtua Akademia Ushtarake. Akademia Ushtarake ose e Mbrojtjes, ka ofruar kualifikime të avancuara dhe strategjike për oficerët nga vitin 1958 deri në ditët e sotme. Por cila ishte në të vërtetë sistem EUP para viteve 90, në Shqipëri. (Shih figurën)



3. Edukimi Ushtarak Profesional në Republikën e Shqipërisë, pas vitit 1992

Le ta fillojmë me pyetjen: Cili është misioni i Edukimit Profesional në Shqipëri? EUP në Shqipëri synon të formojë një trupë drejtuesish të aftë, oficerë dhe nënoficerë, të përgatitur për të kryer me sukses detyrat e ngarkuara dhe për t'i shërbyer kombit. Këta drejtues duhet të pajisen me aftësi për të menduar dhe analizuar në mënyrë kritike dhe krijuese për drejtimin e FA-ve, ndërveprimin me aleatët në NATO dhe ballafaqimin me rreziqet e krijuara nga kundërshtarët e mundshëm. Përgatitja ushtarake e personelit dhe devotshmëria ndaj atdheut dhe kombit janë objektivat kryesorë të misionit dhe qëllimeve të EUP. Edukimi ushtarak profesional në Shqipëri është pjesë integrale e sistemit

të arsimit kombëtar. Institucionet kryesore që merren me arsimimin e ushtarakëve (oficerëve dhe nënoficerëve) dhe civilëve janë Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) dhe Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS). Këto institucione synojnë arsimimin dhe përgatitjen e ushtarakëve dhe civilëve në të gjitha nivelet e drejtimit të FA-ve dhe institucioneve të tjera vendore që trajtojnë çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes. Misioni i arsimit ushtarak është thelbësor për të kuptuar natyrën dhe aftësitë përgatitëse të këtyre institucioneve.⁹

Objektivat e përgatitjes.

Sipas statusit të Akademisë të Forcave të Armatosura të miratuar në vitin 2017, janë përcaktuar objektivat dhe detyrat për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e arsimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë. Akademitë kanë për detyrë të përgatisin dhe edukojnë personelin ushtarak dhe civil në të gjitha nivelet e FA-ve. Këtu përfshihet edukimi i ushtarakëve në nivelin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt. AFA-ja ofron edukimin në Bachelor, Master (në Arte ose në Shkenca) dhe studimet në doktoratë. Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë përgatit oficerë nga grada e Kapitenit deri në gradën e Kolonelit, duke kaluar nga niveli i dytë deri tek i katërti i EUP-së.

Rëndësia e Kurrikulës në Edukimin Ushtarak.

Përgatitja e kurrikulave luan një rol thelbësor në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe në arritjen e objektivave edukative të trupës studentore ushtarake. Kurrikula ndikon në mënyrë të konsiderueshme në aspekte të ndryshme të filozofisë, psikologjisë dhe sociologjisë, duke qenë një element thelbësor, kompleks dhe i rëndësishëm për pedagogjinë. Qëllimi kryesor i kurrikulës është zhvillimi i procesit mësimor dhe përgatitja e studentëve ushtarakë për të përmbushur objektivat e tyre mësimore. AFA dhe KMS duhet të përqendrohen në përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulës, me synim përshtatjen ndaj rreziqeve bashkëkohore dhe kuptimin e mjedisit të sigurisë, i cili po bëhet gjithnjë e më i paparashikueshëm. Për ta arritur këtë, kurrikula duhet të rishikohet çdo vit dhe të ndryshohet sipas një përqindjeje të përcaktuar me ligj ose rregullore të brendshme (SOP)¹⁰ të institucioneve arsimore ushtarake. Kjo kërkon mbështetje të fuqishme nga institucionet eprora, si Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura (SHPFA), në mënyrë morale, financiare dhe materiale, për të siguruar një sistem arsimor të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Iniciativa e Qeverisë së Shqipërisë për përmirësimin e EUP.

Në vitin 2021, Qeveria e Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes deklaruan se do

⁹ Statusi i AFA-së, miratuar në vitin 2017.

¹⁰ SOP – Standard Operating Procedure (*Standarde të Procedurave Operative/Operacionale*).

t'i kushtojnë më shumë vëmendje përgatitjes dhe arsimimit në fushën e mbrojtjes. Kjo iniciativë synon shfrytëzimin e dy burimeve kryesore: (1) përvojën brenda Forcave të Armatosura dhe (2) përvojën e vendeve më të zhvilluara anëtare të NATO-s. Shqipëria ka dërguar dhe përgatitur një numër të madh ushtarakësh në akademitë ushtarake më të njohura të SHBA, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Greqisë dhe vendeve të tjera, duke përfutur nga përvoja dhe marrëdhëniet e krijuara me institucionet simotra. Këto përvoja dhe marrëdhënie do të kontribuojnë në reformimin dhe përmirësimin e sistemit të arsimimit ushtarak në Shqipëri.

Panorama e Edukimit Ushtarak Profesional.

Arsimimi Ushtarak Profesional përgatit oficerët në 4 nivele ose fusha kryesore:

Niveli i parë - Përqendrohet në përgatitjen e oficerëve të rinj, përgjegjësi e Akademisë të Forcave të Armatosura. Në të shkuarën, ky nivel ishte i lidhur me Akademinë Ushtarake 'Skënderbej'.

Niveli i dytë, i tretë dhe i katërt - Të gjitha nivelet e tjera duhet të jenë përgjegjësi e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Këto nivele përfshijnë përgatitjen taktike, operacionale dhe strategjike të oficerëve (Shih tabelën 3).

Edukimi Ushtarak Profesional në Forcat e Armatosura të RSH

Niveli i parë	Niveli i dytë	Niveli i tretë	Niveli i katërt
Përgatitja bazë (Programi Bachelor - 3 vjet) kadet / student	Përgatitja e oficerëve të rinj	Niveli i avancuar	Niveli i lartë
Niveli Taktik	Niveli Taktik	Niveli Operacional	Niveli Strategjik
Kurse të tjera të përgatitjes të oficerit të ri (kontingjente nga UT – 9 muaj kurs)	Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit (KTHOSH)	Kursi i Komandës dhe i Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP). Kursi i Lartë i Oficerit (KLO)	Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM)
Institucioni përgjegjës: Akademia e Forcave të Armatosura	Institucioni përgjegjës: Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Institucioni përgjegjës: Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë	Institucioni përgjegjës: Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë

Grada: Nëntoger -Toger (OF1)	Grada: Kapiten (OF-2)	Grada: Major-N.kolonel (OF3 - OF4&Civil)	Grada: N.kolonel - Kolonel (OF4 – OF5 & Civil)
(Programet Master (MA & MSc) & Doktorata (PhD)) Institucioni përgjegjës: Akademia e Forcave të Armatosura			

Tabela nr. 4. Akademia e Forcave të Armatosura/Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë

4. Sfidat dhe perspektivat për të ardhmen

AFA merret me përgatitjen e studentëve/kadetëve ushtarakë, ndërsa KMS zhvillon disa kurse, si Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH), Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP), Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) dhe Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM). Këto kurse janë krijuar për të përgatitur ushtarakët me grada OF2/OF3/OF4 dhe OF5. Ndërsa mjedisi i sigurisë dhe arti ushtarak ndryshojnë, kurrikula duhet të përshtatet në lidhje me ndryshimet. Në këtë kontekst, lindin disa pyetje kyçe të cilat kërkojnë përgjigje:

- Çfarë duhet përmirësuar në AFA dhe KMS?
- Si duhet ndërtuar sistemi arsimor?
- Cilat do të jenë burimet financiare dhe njerëzore?

Për të përmirësuar AFA-në dhe KMS-së, disa masa janë të nevojshme:

- **Zhvillimi i strukturës:** Struktura aktuale duhet të vazhdojë të zhvillohet jo të ndryshojë (*evolution not revolution*). Është e nevojshme që stafi akademik të vlerësohet dhe të rifreskohet.

- **Pasurimi i kurrikulës dhe literaturës:** Literatura (si në formë të shtypur ashtu edhe online) duhet të pasurohet për të pasqyruar zhvillimet më të fundit në fushën ushtarake dhe atë të sigurisë.

- **Rishikimi i nivelit të tretë të edukimit ushtarak:** Niveli i tretë i arsimit duhet të rishikohet në përputhje me praktikën e vendeve anëtare të NATO-s. Ligji që rregullon sistemin arsimor në fushën e mbrojtjes mund të ketë nevojë për ndryshime për të reflektuar këto zhvillime dhe përparimet teknologjike.

Ndryshimet e nevojshme në kurset e KMS.

Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) dhe Kursi i Lartë i Oficerit (KLO) përbëjnë nivelin e tretë të edukimit në fushën e mbrojtjes. Këtu ekziston nevoja për ndryshim dhe përmirësim. Përvojat më të mira të vendeve perëndimore dhe Kolegjit të Baltikut ofrojnë modele që mund të përshtaten me mjedisin shqiptar. Për shembull, KMS mund të integrojë KKSHP dhe KLO në një kurs të përbashkët të emërtuar Kursi i Komandave të Bashkuara dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKBSHP).

Ky kurs i integruar do të kursejë kohë dhe burime financiare dhe do të përshtatë kurrikulën për të reflektuar ndryshimet në natyrën e luftës dhe të mjedisit të sigurisë. Kursi i ri do të zgjasë jo më shumë se 10-11 muaj. Ndërsa disa pjesë të programit të KKSHP mund të transferohen në Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH), duke e zgjatur këtë kurs nga 4 në 5-6 muaj, në përputhje me standardet e vendeve të Baltikut. Ndërsa, Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM) duhet të zgjasë rreth 5 muaj ose 23 javë, duke përfshirë një gamë të gjerë temash në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si mjedisi ndërkombëtar i sigurisë, NATO/Rusia, politika e mbrojtjes, planifikimi/planëzimi i mbrojtjes (strategjik) dhe menaxhimi, parandalimi i rreziqeve, etj. Kjo do të përfshijë më shumë aktorë nga brenda dhe jashtë vendit.

Stafi Akademik dhe puna kërkimore në AFA dhe KMS.

AFA dhe KMS duhet të kenë një trupë akademike të përgatitur me standardet më të mira brenda dhe jashtë vendit. Njohja e gjuhës angleze është thelbësore për të përthithur informacionin dhe dijen e nevojshme. Institucioni duhet të konsiderohet si shtylla kurrizore e FA-ve. Pa të, nuk ka zhvillim të qëndrueshëm dhe siguri kombëtare.

Për të rritur cilësinë e edukimit, është thelbësore të përmirësohet vlerësimi i stafit akademik. Ata që shërbejnë në AFA dhe KMS, duhet të jenë ndër më të mirët dhe të kenë një avantazh ndaj të tjerëve në sistem. Pa trupë akademike cilësore nuk ka ushtarakë të përgatitur. *Arsimimi*, thotë Nelson Mandela, është arma më e fuqishme, me të cilën ju mund të ndryshoni botën. Botën e brendshme të FA-ve dhe pjesëtarëve të saj. *Qëllimi i edukimit profesional ushtarak*, siç thotë Louis Simpson, *nuk duhet të jetë vetëm përgatitja e burrave për luftë, por për një kohë më të gjatë.*

AFA dhe KMS duhet të ketë një sistem të brendshëm komunikimi (*intranet/computer network*) për të lehtësuar komunikimin me stafin akademik dhe studentët. Për shembull, në Kolegjin e Baltikut përdoret ILIAS (*software*) për komunikimin e brendshëm. Po ashtu, faqja zyrtare e internetit e AFA-së dhe KMS-së, duhet të vetë-menaxhohet dhe të ofrojë informacionin e nevojshëm për publikun dhe komunitetin akademik.

Institucionet e edukimit ushtarak duhet të jenë model jo vetëm në fushën e arsimit, por edhe të vlerave që ajo mbart. Sot na duhen ushtarakë me njohuri jo vetëm në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, por edhe në politikë apo në fushën e ekonomisë. Për ta ilustruar, dua të sjell një thënie të kolonel Lincoln në një letër drejtuar ish-përgatitësit të tij në West Point: *‘Unë kam filluar të mendoj se ne na duhet një model i oficerit të shtabit, i cili të ketë tre koka – një për politikë, një për ekonomi dhe një për çështjet ushtarake.’*¹¹

Përfundime

Ndërtimi dhe përmirësimi i mbarëvajtjes në institucionet akademike në fushën e mbrojtjes kërkojnë vullnet, mbështetje dhe transparencë. Akademitë ushtarake janë përgjegjëse për përgatitjen e ushtarakëve me dijet dhe njohuritë e nevojshme në të gjitha nivelet e EUP. Zbatimi i politikave arsimore dhe kurrikulës akademike kërkon dy gjëra kryesore: infrastrukturën e duhur dhe stafin akademik të arsimuar. Arritja e këtyre objektivave kërkon investim dhe vëmendje ndaj personelit (*invest in people*). Akademitë ushtarake duhet të përgatisin mendje krijuese që do të drejtojnë njësitë dhe formacionet luftarake sipas standardeve të NATO-s.

EUP duhet të krijojë dhe mundësojë kurrikulë të përditësuar, sipas kërkesave dhe standardeve të diktuara nga zhvillimet teknologjike dhe mjedisi i sigurisë. Kurrikula e rishikuar dhe e përmirësuar duhet të krijojë mjedis akademik tërheqës dhe cilësor për përvetësimin e dijeve dhe metodave të reja të luftimit dhe përballimit të rreziqeve. Në një mjedis sigurie gjithnjë e më të paparashikueshëm, akademitë ushtarake janë vendet ku mund të përvetësohen dhe debatohen rreziqet dhe sfidat e shekullit të 21-të. Lufta kibernetike dhe informacioni i rremë po dominojnë mjedisin e sigurisë dhe sigurinë kombëtare dhe ne duhet të jemi të përgatitur për këto sfida. Kjo realizohet përmes institucioneve të standardizuara dhe trupës mësimdhënëse të përgatitura.

Ushtarakët e përgatitur dhe mendimi kritik do ta lehtësojnë kuptimin e mjedisit të sigurisë dhe përballimin e rreziqeve. EUP gjithmonë do të ndikohet nga sfidat dhe mundësitë e reja. Ne duhet të kuptojmë se çfarë duam të mësojmë në Akademi, kush duhet të vijë në AFA dhe KMS dhe kush duhet t’i përgatisë? Objektivi i reformimit duhet të jetë përmirësimi i mjedisit akademik dhe ndryshimet duhet të jenë efektive dhe të nevojshme. Ndërsa ne mund të ndryshojmë ose ristrukturojmë institucione të arsimit ushtarak, përgatitja e trupës akademike mbetet thelbësore. Pa një trupë të përgatitur mësimdhënëse, çdo përpjekje është e destinuar të dështojë. Pedagogët dhe instruktorët janë

¹¹ Fred Kaplan (2014) *‘The Insurgents: David Petraeus and the Plot to Change the American Way of War’*, Simon & Schuster Paperbacks, New York, pp.6.

‘*thembra e Akilit*’ në reformimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve të arsimimit ushtarak.

Ky shkrim nuk pretendon të japë përgjigje ose zgjidhje për modelin ose sistemin më të mirë të përgatitjes në fushën e EUP-së në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Stafet akademike, hartuesit e kurrikulave dhe njohësit e arsimimit ushtarak mund të japin përgjigje më të sakta. Të gjithë duhet të biem dakord që akademitë dhe kolegjet ushtarake duhet të marrë vendin që u takon. AFA dhe KMS do të jenë gur themeli në formësimin dhe përgatitjen e ushtarakëve me dijet dhe njohuritë e nevojshme për mbrojtjen e vendit dhe përballimin e rreziqeve. Ne duhet të ndërtojmë sisteme që do t’i rezistojnë kohës.

Bibliografia

1. Mie Augier and Wayne Hughes (2019) *Innovative Thinking: The Role of Professional Military Education*, <https://cimsec.org/innovative-thinking-the-role-of-professional-military-education/>, gjetur më 05 qershor 2024.
2. S. Huffington, A Oler, and D Tretler ed. *A National Security Strategy Primer ... The Assumptions pivotal to the National Security Strategy*, National Defence University Press, Washington, D.C. (2021).
3. S. I Radda, *The Role of Education in Promoting National Security*, Sociologica Department, Bayero University, Kano, Nigeria, (2014).
4. NATO, PfP Consortium and Canada., *Generic Officer Professional Military Education: Reference Curriculum*, NATO publication 2011.
5. Corum J., Johanson A., *20th Years of the Baltic Defence College: Professional Military Education in the Baltic States*, Valipress OU Estonia, 2019.
6. HCSC (Higher Command Studies Course/Kursi i Lartë i Studimeve të Komandimit), zhvillimi i kurrikulës, (2024), Tartu, Estoni.
7. Sabri Godo, *Ali Pasha*, Tirana, 1989.
8. Fred Kaplan ‘*The Insurgents: David Petraeus and the Plot to Change the American Way of War*’, Simon & Schuster Paperbacks, New York, (2014).
9. Rupert Smith ‘*The Utility of Force: The Art of War in the Modern World*’, Penguin, London, (2009).

Krijimtaria dhe suksemi

Prof. Asoc. Dr. Edmond BRANESHI

Shef Grupi në Shkenca Komunikimi, FMS

Trajtesë e shkurtuar.

Deri para disa vitesh, dija ishte ajo që e bënte një organizatë të ishte “njëshi” në fushën e saj. Njohuritë, kërkimet, trajnimet dhe përvoja ishin karakteristikat që u jepnin organizatave përparësi ndaj konkurrentëve. Por tani, kohët dhe mjedisi kanë ndryshuar. Sigurisht, që informacioni dhe njohuritë janë akoma pika kyçe për çdo organizatë në fushat përkatëse, por ato nuk janë të mjaftueshme për të garantuar mbijetesën dhe qenien në krye. Për këtë arsye, duhet të jemi në gjendje të përshtatemi dhe evoluojmë, duke iu përgjigjur ndryshimeve të vazhdueshme dhe të papritura që lindin, si brenda organizatës ashtu edhe në drejtim. Suksemi ynë varet nga ajo që ne jemi në gjendje të krijojmë. Prandaj krijimtaria merr një rëndësi të madhe për ecurinë dhe suksesin e organizatës. Ne duhet të vetë ndërgjegjësohemi se krijimtaria ekziston brenda nesh, thjesht duhet të mësojmë ta bëjmë atë të rishfaqet.

Çdo punonjës (vartës) në organizatë duhet të sjellë, të eksplorojë dhe të zhvillojë ide të reja, për të cilat do t'i njihet merita. Paaftësia për të sjellë ide të reja nënkupton paaftësi për ta bërë siç duhet punën. Fatkeqësisht, një numër jo i vogël njerëzish bëjnë shumë pak, për të mos thënë aspak, në lidhje me mendimin krijues. Ata kanë mbetur brenda zonës së rehatisë, duke u përpjekur t'i ruajnë të pandryshuara ato rezultate që kanë arritur në të kaluarën. Këta njerëz janë duke humbur një nga mundësitë më të mëdha për të ecur drejt përparimit dhe suksesit.

Drejtimesit duhet të besojnë se risitë duhet të jenë të vijueshme në organizatën që drejtojnë dhe duhet të përkrahen pa rezerva. Në këtë kuadër, drejtimesit

duhet të krijonjë mjedis të këndshëm, ku krijimtaria të jetë pjesë e mendësisë së punës së kujtdo, kudo në çdo çast. Ajo duhet të bëhet pjesë e ADN-së së strukturave dhe tipar dallues i çdo punonjësi në organizatë. Edhe synimi i këtij shkrimi është që të japë konceptin bazë mbi krijimtarinë, rëndësinë që ka ajo në suksesin e organizatës, karakteristikat e njerëzve krijues, si dhe roli i drejtuesit për të pasur një mjedis krijues të përhershëm në organizatë, me qëllim që “ëndrrat e projektuara” të bëhen realitet. Krijimtaria luan një rol jetësor në kohën e sotme dhe ne duhet të mësojmë të kemi një qasje krijuese për zgjidhjen e problemeve dhe sfidave që do të hasim.

Fjalë kyçe: krijimtari, proces krijues, veprimtari krijuese, rëndësia e krijimtarisë, njerëz krijues, karakteristikë, risi, drejtues, organizatë, sfidë.

Hyrje

Zhvillimi i vullshëm dhe sfidat e njëpasnjëshme që përçon mjedisi bëjnë që shumë faktorë, të cilët më parë përbënin përparësi për organizatat, sot të mos jenë më të tillë. Kjo ndodh si për aftësitë, ashtu edhe për informacionin apo teknologjinë. Ne nuk mund të mbetemi me shpresën se organizatat e tjera, që janë konkurrentet tanë nuk do të jenë po aq të zot sa ne, sepse edhe sikur të duam, nuk mund ta ndalim dot përmirësimin dhe ecurinë e tyre. Sot kushdo mund ta gjejë informacionin apo teknologjinë që i nevojitet, mjafton që të investojë për to. Nëse ndërgegjegjësohemi se sot, pothuajse çdo gjë është e arritshme nga të gjithë, ajo që ngelet unike dhe që do të bëjë ndryshimin, është aftësia për të krijuar vlerë edhe në këto kushte. Pikërisht kjo është krijimtaria, e cila nuk është një talent hyjnor të cilin e zotërojnë vetëm pak njerëz. Ajo është një shprehje të cilën të gjithë ne mund dhe duhet ta zhvillojmë. Për këtë arsye, krijimtaria është një mjeshtri, e cila njëlloj si ngarja e biçikletës, ose si puna me një kompjuter mund të mësohet dhe të zhvillohet, duke u praktikuar. Një ide ose një perceptim i ri, mund të jetë i mjaftueshëm për ta ndryshuar rrjedhën e drejtimit të një karriere, ose të një organizate të tërë.

Ne duhet të sfidojmë konceptet dhe perceptimet e pranura nga të gjithë jo sepse ato janë të gabuara apo të papërshtatshme, por sepse kështu mund të gjejmë dhe më pas të zhvillojmë një alternativë më të mirë. Këtë mënyrë të menduari duhet ta përqafojmë në organizatën që drejtojmë dhe të gjithë drejtuesit vartës duhet që ta nxisin, pavarësisht pozicionit në nivelin e hierarkisë. Vetëm në këtë mënyrë, krijimtaria do të konsiderohet si një pritshmëri prej të gjithëve dhe si një proces shumë i rëndësishëm për të qenë vazhdimisht të renditur në krye.

1. Koncepti mbi krijimtarinë

Origjina e fjalës “krijimtari” vjen nga latinishtja “*creare*” që do të thotë “*të krijosh nga asgjëja*”. Thelbi i krijimtarisë është krijimi i diçkaje të re, që nuk

ka ekzistuar më parë. Me krijimtari nënkuptojmë aftësinë e njeriut për të qenë krijues, inteligjent, me një imagjinatë të aftë që e ndihmon të ketë një jetë dhe veprimtari më tërheqëse dhe interesante¹. Krijimtaria është aftësia për të sjellë diçka të re në jetë. Ajo paraqitet në mendimet dhe veprimet e njerëzve. Prodhimet krijuese lindin nëpërmjet procesit të krijimtarisë që ndodh tek një person ose grup personash. Këto prodhime mund të jenë shumë të ndryshme si për shembull, të paprekshme (një ide, një teori shkencore, një kompozim muzikor, formimi i një sistemi të ri filozofik etj.) ose një objekt fizik (një shpikje, një projekt i ri, një vepër letrare apo arti, etj.). Prodhimet krijuese dallohen nga njëri-tjetri nga origjinaliteti, zgjedhja, vlerat, përdorimi etj.

Te njerëzit krijues, pavarësisht moshës së tyre, prejardhjes etnike, kombësisë etj., ne gjejmë trajta të caktuara përsëritëse: aftësi për të menduar në mënyrë metaforike, analogjike, logjike, pavarësinë e gjykimit, kundërshti të thjeshtësisë etj. Krijimtaria është një ndër kualifikimet më kyçe për drejtuesit, pasi roli që luan FA në një shoqëri demokratike është mjaft i rëndësishëm. Koncepti i “krijimtarisë” është një koncept shumë i gjerë, vetë termi “krijimtari” është një ndër termat më të përdorur në mënyrë të veçantë, në dy dekadat e para të këtij shekulli, dhe i tillë ka për të mbetur edhe në të ardhmen, pasi zhvillimi i shoqërisë është një proces gjithnjë i vazhdueshëm.

Psikologë, psikoanalistë etj., shpeshherë e paraqesin krijimtarinë si pjesën më të qëndrueshme të personalitetit të njeriut. Studiues të shumtë (Rohrbach, Köstler, Taylor, Frojd, Geyer etj.) japin përkufizime të ndryshme për krijimtarinë, por thelbi i çështjes qëndron në sintezën e pikëpamjeve të tyre. Ajo që bie në sy është se krijimtaria cilësohet aftësia për të gjeneruar ide të reja dhe për të njohur perspektiva të reja dhe të dallueshme për një problem ose mundësi. E përbashkëta e tyre është se veprimtaria krijuese kurrë nuk lind nga “hiçi, pra nga “asgjëja”, përkundrazi, sekretet e krijimtarisë qëndron në atë që, dy modele të menduari deri tani të para si të shkëputura (logjika) lidhen me një ide të re (fantazia), nëpërmjet përfytyrimit të dyfishtë².

Krijimtaria kërkon thyerje të rutinës, të mendosh jashtë kornizave, të jesh mendjehapur. Njerëzit që janë kuriozë për të zbuluar, të hapur ndaj eksperimenteve, entuziastë nga natyra, optimistë për arritjet, që nuk dekurajohen nga dështimet janë më të prirur për të qenë krijues. Kur përpiqeni të bëni inovacion, asnjëherë nuk mund të jeni 100% të sigurtë që do të funksionojë. Mos u trembni nga dështimi. Dështimi ju mëson të paktën çfarë të mos bëni.

¹ Vasil Naçi, Alma Bici, “Roli i marketingut dhe Kreativiteti”, botuar nga Agna Leadership Academy, Viti 2012, faqe 89.

² Q. Orhani, E. Braneshi, M. Cukalla, “Udhëheqja Ushtarake 2”, shtypur në Shtypshkronjën “Grand Prind”, Tiranë 2011, faqe 159.

Thomas Edison-i, shpikësi i madh i kohërave moderne u bind se eksperimentimi ishte thjesht një proces eliminimi. Si pasojë, ai mbante të dhëna të sakta për çdo eksperiment. Sapo ai kishte vendosur se një shpikje ishte e mundur, ai i përkushtohej procesit të eliminimit të rrugëve që nuk do të funksiononin derisa metoda e vetme e mbetur të ishte e vetmja që do të funksiononte. Njerëzit duhet të bëjnë të njëjtën gjë. Në çdo kohë që ata përpiqen dhe dështojnë, duhet ta konsiderojnë atë si një përvojë të nxëni e cila i çon një hap më pranë suksesit. Ashtu siç thekson edhe Henry Ford: “*Dështimi është thjesht një mundësi për të nisur sërish më zgjuarsisht*”.³ Pra, provoni mënyra të reja që mund të funksionojnë më mirë.

Të gjithë kanë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese, si dhe aftësinë për të përdorur më shumë pjesën e trurit që mendon siç duhet. Thjesht të qenit i vetëdijshëm për nevojën për të qenë më krijues në punë mund t’ju ndihmojë të keni një paraqitje më të mirë në punën tuaj brenda organizatës.

Organizatat sot kanë nevojë për krijimtari dhe ato duhet ta ushqejnë atë. Krijimtaria kërkon kurajë, kërkon të besojmë se gjithkush mund të jetë krijues, kërkon fokus të zgjidhjet, mendim pozitiv, rritjen dhe shkëmbimin e njohurive dhe zhvillimin e kurajës për të qenë ndryshe. Krijimtaria kërkon që të jemi të hapur, të zgjerojmë imagjinatën, të shikojmë dështimin si mundësi për të mësuar, të zgjedhim miq krijues, të gjejmë kohë për të praktikuar krijimtarinë dhe të kujdesemi për veten. Dave Brailsford-i e përmbledh shumë saktë përshkrimin e njerëzve që do në ekip dhe kulturën që ata duhet të përçojnë. “*Dua një kulturë urie dhe ambicieje që nuk sheh pengesa, që krijon vazhdimisht, por të organizuar e të disiplinuar, përndryshe situata mund të dalë jashtë kontrollit*”.⁴ Në këtë qasje, krijimtaria kërkon njerëz të vetëdisiplinuar. Pa njerëz të vetëdisiplinuar, nuk ka mundësi për punë krijuese. Puna më e vështirë është të bashkojmë disiplinën me krijimtarinë, por pa lejuar që në emër të disiplinës të pengohet krijimtaria dhe pa e lejuar krijimtarinë të shkatërrojë disiplinën.⁵ Ky është një tjetër paradoks që ne duhet ta bëjmë pjesë të punës dhe kulturës sonë.

2. Krijimtaria dhe rëndësia e saj

Çdokush në vetvete është krijues. Krijimtaria është një karakteristikë e natyrshme natyrshme dhe spontane e individëve pozitivë që kanë një vlerësim të lartë ndaj vetes. Drejtuesit që krijojnë një mjedis pozitiv pune përfitojnë një rrjedhë

³ Brian Tracy, “Ndryshoni të menduarit tuaj, ndryshoni jetën tuaj, si të zbulosh potencialin tënd për sukses e arritje”, Botimet Elta BS, Viti 2009, ISBN: 987-9951-544-08-5, faqe 254.

⁴ Alastair Campbell, “Fitimtarët dhe si arrijnë suksesin”, Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë 2015, ISBN: 978-9928-190-55-0, faqe 96.

⁵ Vasil Naçi, Alma Bici, “Është rruga jonë, rruga e suksesit në AGNA Group”, botuar nga AGNA Leadership Academy, viti 2015, faqe 114.

të qëndrueshme nga të gjithë pjesëtarët e stafit. Një mori studimesh tregojnë se 95% e njerëzve shfaqin dukurinë se kanë potencial për t'i kryer punët në nivele të larta krijimtarie. Sipas kërkimeve të kryera nga Hauwrd Gardneri në Universitetin e Harvardit, studiuesit kanë dalë në përfundimin se ekzistojnë disa lloj mënyrash të ndryshme të menduari dhe se çdo person është një gjeni i mundshëm, të paktën në një lloj fushe. Ajo që kuptojmë prej kësaj është se, kyçi për t'i dhënë liri krijimtarisë tuaj zë fill nga ajo që, ju duhet të filloni dhe të mendoni për veten tuaj se jeni një person jashtëzakonisht krijues. Në librin “Roli i marketingut dhe Kreativiteti”, theksohet: “Çdokush është krijues nëse e lejon veten të jetë i tillë. Është koncepti i *gabuar se ‘disa njerëz janë krijues’*. *Truri ynë ka një fuqi krijuese të jashtëzakonshme. Disa njerëz thjesht nuk janë të trajnuar për të nxjerrë në pah potencialin e tyre krijues*”.⁶

Të qenurit inovativ përfshin krijimtarinë në prodhimin e ideve që janë origjinale dhe të vlefshme. Ndonjëherë shfaqet një problem i ri, ose një problem i vjetër kërkon një zgjidhje të re. Drejtuesit duhet të shfrytëzojnë të tilla mundësi për të menduar në mënyrë krijuese dhe për të sjellë diçka të re. Koncepti kryesor për të menduarit krijues është zhvillimi i ideve dhe mënyrave të tjera për të nxitur vartësit me qasje dhe ide të reja.⁷ Në këtë kuadër, krijimtaria dhe inovacioni mbështesin njëra-tjetrën. Organizatat përballen me një dilemë: nëse nuk krijojnë risi ato nuk mund të mbijetojnë. Por edhe nëse krijojnë risi dhe ato nuk rezultojnë të suksesshme, organizatat përsëri nuk mund të mbijetojnë. Për këtë arsye, krijimtarinë dhe inovacionin duhet ta bëjmë pjesë të punës sonë të përditshme. Idetë e mira nuk vijnë çdo ditë dhe jo çdo ide mund të jetë e suksesshme, por organizatat që vjetrohen në ide dhe ndalen së krijuari, janë të destinuara të dalin përfundimisht nga misioni.

Krijimtaria dhe inovacioni duhet të bëhen mendësi dhe zakon pune. “*Më të suksesshmit e të suksesshmëve – thekson G. Cardone, - shkojnë përtej konceptit të ndryshimit dhe sfidojnë mendësinë tradicionale. Vështroni organizatat si Google, Apple dhe Facebook, e do të vëreni kompani që sfidojnë traditat dhe krijojnë mënyra të reja për t'i bërë gjërat. Ata e thyejnë atë çfarë tashmë funksionon, në mënyrë që të përmirësojnë. Më të suksesshmit kërkojnë të krijojnë tradita të reja – jo të ndjekin ato që tashmë ekzistojnë. Mos u bëni një i burgosur i mendësisë së rënë dakord prej të tjerëve. Zbuloni mënyra për të shfrytëzuar në maksimum mendësinë tradicionale e cila pengon të tjerët*”.⁸ Prandaj është e rëndësishme të jemi më krijues se konkurrentët tanë. Në ditët

⁶ Vasil Naçi, Alma Bici, “Roli i marketingut dhe Kreativiteti”, botuar nga Agna Leadership Academy, Viti 2012, faqe 93.

⁷ FM 6-22, Army Leadership Competent, Confident, and Agile, October 2006, faqe 6-2.

⁸ Grant Cardone, “10 X: Rregulli i vetëm që bën dallimin ndërmjet suksesit dhe dështimit”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-2611-2-8, faqe 187.

e sotme teknologjia dhe inovacioni kanë krijuar një botë të re. Për të ruajtur avantazhet konkurruese, një organizatë duhet të vlerësojë jashtëzakonisht rolin e krijimtarisë. Përdorimi i krijimtarisë në prodhim, pajisje, kosto dhe në të gjitha aspektet e tjera, jo vetëm që ndihmon organizatën që të rritet, por gjithashtu krijon përparësi, krahasuar me të tjerat. Një organizatë ka nevojë për fuqinë krijuese të njerëzve për të përballuar sfidat e kohës. Idetë janë motorrët e progresit. Ato përmirësojnë jetën e njerëzve duke krijuar mënyra më të mira për të bërë gjërat. Ato ndërtojnë dhe rrisin organizatat e mëdha duke i mbajtur ato gjithmonë të suksesshme.

Aftësia jonë gjeniale për krijimtarinë qëndron në fuqinë për të rikombinuar dhe integruar me freski elementet ekzistuese. Krijimtaria është vepër e gjimnastikës mendore dhe përfshin pjesën ndërgjegjësore të trurit. Ai tërheq gjithçka nga njohuritë, logjika, imagjinata, intuita e deri tek aftësia për të parë lidhjet dhe dallimet mes ideve dhe gjërave.

Meqë shumica e proceseve dhe sistemeve tona edukuese i janë përkushtuar zhvillimit të funksionit të të menduarit gjykues (aftësisë për të marrë vendime, për të krahasuar dhe vlerësuar situatat, për të bërë dallimin midis së duhurës dhe jo korrektes etj.,) shumë njerëz nuk e kuptojnë fuqinë e aftësive krijuese vetjake. Në të vërtetë, potenciali ynë në këtë fushë është përherë i pranishëm dhe mund të zhvillohet në masë shumë më të madhe tejet lehtësisht. Asnjëherë nuk duhet ta humbim besimin në aftësitë tona krijuese.⁹ Krijimtaria kërkon përkushtim, dedikim, orë të gjata dhe vazhdimisht njohuri të reja. Si në çdo aspekt të jetës, pa pasion dhe dashuri për krijimtarinë, asgjë e madhe nuk mund të ndodhë. Nëse keni shpirtin krijues, ju do të gjeni ide të reja ndërkohë që jeni duke përmbushur detyrat tuaja të përditshme.

Aftësia për të menduar në mënyrë krijuese, për t'i analizuar problemet dhe mundësitë në mënyra të reja dhe inovative, përbën një nga zotësitë më të vyera që mund të zhvillojmë në vetvete dhe brenda organizatës sonë. Për këto arsye, krijimtaria merr rëndësi të veçantë sepse:

- rrit produktivitetin, sjell gëzim, rrit kënaqësinë, ju mban të freskët, ju bën më konkurrues dhe e ndihmon organizatën të rritet, duke pasur në vijimësi avantazhet e nevojshme;
- i jep kuptim jetës, ju jep fuqi të provoni qasje të reja, ju mban zgjuar, ju ndihmon të bëheni më elastikë e më të përshtatshëm;
- ju çon në rezultate shumë të mira përmes një përqasjeje tjetër që askush nuk e ka parë më herët, duke e bërë kontributin dhe suksesin tuaj origjinal dhe unik.

⁹ Dale Carnegie & Associates, "Si të bëhesh udhëheqës i zoti", Shtëpia Botuese "Pema", Viti 2019, ISBN: 978-9951-721-77-6, faqe 175.

- ju ndihmon të gjeni mjete të reja për të arritur rezultatet.
- ndihmon organizatën të bëjë vetë progres.

3. Karakteristikat e njerëzve që mendojnë në mënyrë krijuese

Të menduarit krijues është procesi i përdorimit të trurit për të gjeneruar ide rreth diçkaje. Krijimtaria duhet të sjellë rezultate cilësore. Të menduarit krijues do të thotë ide cilësore për problemin, për t'i dhënë organizatës një energji më të madhe. Sipas Michael Schrage-it *krijimtaria e vërtetë nuk ka të bëjë vetëm me idetë. Ka të bëjë me përkthimin e ideve në produkte, shërbime dhe zgjidhje të zgjuara*.¹⁰ Ka vend për krijimtari në çdo aspekt të jetës. Krijimtaria dhe epërsia (përsosmëria) janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Ata që dëshirojnë më të mirën, duhet ta bëjnë krijimtarinë mënyrë jetese. Walt Disney thotë se nëse ëndërron diçka, mund ta bësh.

Aftësitë krijuese janë “ar i kulluar”, pavarësisht se çfarë pune bën në jetë. Annette Moser-Wellman, autore e librit “The Five Faces of Genius, thotë: *“Pasuria më e vlefshme që mund t’i sjellësh punës dhe organizatës janë aftësitë e tua krijuese. Ajo që ka më shumë rëndësi, krahasuar me atë se çfarë bën, me rolin që luan, me titullin që mban, me rezultatin që jep – janë idetë e tua”*¹¹. Pavarësisht rëndësisë që ka zotësia e dikujt për të menduar me aftësi krijuese, duket se shumë pak veta e kanë këtë zotësi me bollëk.

Njerëzit krijues, asnjëherë nuk janë të kënaqur me atë që kanë arritur. Ata kërkojnë zgjidhje të reja të problemeve. Kanë një dëshirë të fortë për të krijuar, kanë ndjenjë të thellë përgjegjësie dhe qartësie për qëllimet që duan të arrijnë. Kanë durim dhe përqendrim, janë elastikë, kanë ndjeshmëri ndaj problemeve, janë kureshtarë. Porë në këtë këndvështrim, karakteristikat më tipike të njerëzve krijues janë:

Njerëzit krijues i vlerësojnë idetë. Annette Moser-Wellman vërejt: *“Njerëzit me një mënyrë të menduari tepër krijuese janë të përkushtuar ndaj ideve. Ata nuk mbështeten vetëm në talentin, por edhe në disiplinën e tyre. Imagjinata është si një lëkurë e dytë për ta. Dhe dinë si ta përdorin në masën më të plotë”*.¹² Të kesh aftësi krijuese, do të thotë të kesh ide, shumë ide. Do të keshide vetëm nëse i vlerëson ato.

Njerëzit krijues eksplorojnë mundësitë. Eksplorimi i sa më shumë mundësive stimulon imagjinatën dhe imagjinata është thelbësore për aftësinë

¹⁰ Vasil Naçi, Alma Bici, “Roli i marketingut dhe Kreativiteti”, botuar nga Agna Leadership Academy, Viti 2012, faqe 89.

¹¹ John C. Maxwell, “Si mendojnë njerëzit e suksesshëm” Shtëpia Botuese “Bota shqipëtare”, Tiranë 2020, ISBN: 978-9928-00-455-0, faqe 65.

¹² Po aty, faqe 67.

krijuese. Sikurse thotë Albert Ajnshtajni, imagjinata është më e rëndësishme se njohuria. Në këtë kuadër, njerëzit duhet të vlerësojnë shumë mundësitë, pasi ato kanë çelësin për të gjetur përgjigjet më të mira, jo përgjigjen e vetme. Ata që dinë të mendojnë, gjejnë përgjigjet më të mira. Ata krijojnë plane rezervë që u japin alternativat. Ata gëzojnë një liri që të tjerët nuk e zotërojnë. Kështu ata do të kenë ndikim tek të tjerët dhe do t'i udhëheqin.

Njerëzit krijues janë të hapur ndaj interpretimeve të ndryshme. Shkrimtari H. L. Mencken thotë se njeriu mendjelehtë është gjithmonë i sigurt dhe njeriu i sigurt është gjithmonë mendjelehtë. Njerëzit me aftësi krijuese nuk e ndiejnë nevojën për të përjashtuar pasiguritë. Ato i shohin të gjitha mospërputhjet dhe hendeqet e jetës, dhe shpesh kënaqen t'i eksplorojnë këto hendeqe, apo të përdorin imagjinatën për t'i mbyllur këto hendeqe.

Njerëzit krijues i ngazëllon e pazakonta. Është në vetë natyrën e aftësive krijuese që shpesh eksplorojnë përtej shtigjeve të zakonit dhe të shkojnë kundër rrymës. Diplomati dhe presidenti për një kohë të gjatë i Universitetit Yale, Kingman Brewster, thekson se ekziston një lidhje mes aftësive krijuese dhe çmendurisë, prandaj duhet ta durojmë me gëzim çmendurinë. Që të ushqesh aftësi krijuese te vetja ose te të tjerët, mos ki merak të jesh dhe pak i çuditshëm. Ja një shembull domethënës: Në vitin 1878, Thomas Edisoni nuk ishte i vetmi që eksperimentonte me llamba inkandeshente, por ishte i vetmi që provoi 6.000 filamente të ndryshme; në këtë mënyrë, ai përparoi milimetër pas milimetri derisa zbuloi zgjidhjen përfundimtare. Dhe sigurisht, më në fund e gjeti këtë zgjidhje, duke dëshmuar se gjenialiteti është shpesh, thjesht çështja e këmbënguljes së maskuar.¹³ Duke shfrytëzuar gjithë forcën e tij fizike dhe mendore, duke mos u lodhur kurrë dhe duke mos hequr dorë për asnjë çast, Edisoni iu rezistoi konkurrentëve të paduruar, kur zbuloi në një copë bambuje mënyrën se si të ndriçonte botën.

Njerëzit krijues lidhin ato që duket se s'kanë lidhje. Ngaqë aftësitë krijuese përdorin idetë e të tjerëve, është shumë e vlefshme të jesh në gjendje të lidhësh idetë me njëra – tjetrën, sidomos ato ide që duket sikur s'kanë lidhje. Dizajneri grafik Tim Hansen thotë: “*Aftësitë krijuese shprehen veçanërisht në zotësinë për të bërë lidhje, për të bërë shoqërizime, për t'iu rikthyer gjërave e për t'i shprehur ato në një mënyrë të re*”¹⁴. Të menduarit në mënyrë krijuese është pak a shumë kështu:

¹³ Ryan Holiday, “Pengesja është rrugëdalja”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-13-5, faqe 90.

¹⁴ John C. Maxwell, “Si mendojnë njerëzit e suksesshëm” Shtëpia Botuese “Bota shqipëtare”, Tiranë 2020, ISBN: 978-9928-00-455-0, faqe 69.



Kur ia nis të mendosh, je i lirë të mbledhësh. Pyet veten: Çfarë materiali ka lidhje me këtë ide? Pasi të kesh gjetur materialin pyet: *Cilat ide mund të më ndihmojnë të mendoj më mirë?* Kështu mund të fillosh të ngresh idenë në një nivel tjetër. Pas kësaj mund të korrigjosh ose të qartësosh duke pyetur: *Cilat ndryshime mund ta përmirësojnë këtë ide?* Së fundi, lidhi idetë, duke i vendosur në kornizën e duhur për ta bërë mendimin të plotë e të fuqishëm.

Njerëzit krijues nuk kanë frikë nga dështimi. Aftësia krijuese kërkon të kesh zotësinë për të mos pasur frikë nga dështimi, sepse të krijosh është baras të dështosh. Charles Frankel pohoi se ankthi është gjendja thelbësore e krijimit intelektual dhe artistik. Ndërsa Steve Jobs-i është më i drejtpërdrejtë kur pohon: *“Ndonjëherë, kur ju jeni novator, ju bëni gabime. Mënyra më e mirë është që t’i pranoni ato shpejt dhe t’i futeni punës për të përmirësuar risitë e tjera.”*¹⁵

4. Krijimtaria, detyrë drejtuese

Aftësi për të krijuar e marrë vendime është një kualifikim kyç për drejtuesin. Drejtuesi ushtarak duhet t’u japë rrugëzgjdhje bindëse dhe rezultative problemeve. Kjo do të realizohet nëse ai ka aftësi të mira për të krijuar dhe marrë vendime të drejta. Aftësia për të krijuar, krahas të tjerave evidentohet: në përcaktimin e strukturave të reja për të përballuar situatat dhe zgjidhjen e problemeve; në aftësinë për të braktisur modelet e vjetra të drejtimit; në aftësinë për të përballuar volumin e detyrave gjithnjë në rritje; në rolin e tij si moderatori i konferencave apo debateve të përcaktuara, ku të gjejnë zbatim rregullat e normat e punës së grupeve joformalë. E thënë ndryshe, në aftësinë për t’i lënë hapësirën e nevojshme vartësve në diskutime e debate, duke fituar argumenti dhe jo pozicioni si drejtues. Kjo do të thotë që vartësve t’u hiqet tutela e drejtuesit dhe ata të jenë të lirshëm në dhënien e ideve e mendimeve, pa pasur “frikën” e nënqeshjes (shpotisë) apo ndëshkimit. Referuar Charlie Brower-it: *“Një ide e re është delikate. Atë mund ta vrasësh me një tallje a një thumb; mund ta presësh për vdekje me një nënqeshje e ta kërcënosh me vdekje me një ngryseje vetullash në ballin e njeriut të duhur”.*¹⁶ Mjediset negative vrasin çdo minutë mijëra ide të mëdha. Në krahun tjetër, një mjedis krijues

¹⁵ Bryan Tracy, “Kreativiteti dhe zgjidhja e problemeve” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2015, ISBN: 978-9951-642-38-5, faqe 101.

¹⁶ John C. Maxwell, “Si mendojnë njerëzit e suksesshëm” Shtëpia Botuese “Bota shqiptare”, Tiranë 2020, ISBN: 978-9928-00-455-0, faqe 79.

bëhet si një serrë ku idetë mund të mbillen, të çelin syth e të lulëzojnë. Për këtë arsye drejtuesi duhet të shohë “peshën” e përfitimeve të organizatës kur ai arrin të përshtatet me ndjenjat e bashkëpunëtorëve të tij, të dijë si të përballet me mosmarrëveshjet në mënyrë që ato të mos përshkallëzohen, duke krijuar lehtësira që stafi përkatës të punojë me ritmin e duhur dhe pa stres. Aftësia për të drejtuar nuk do të thotë të sundosh të tjerët, por t’i bindesh të përpiqen për arritjen e qëllimit të përbashkët.¹⁷ Është detyrë e drejtuesit që të zotërojnë aftësitë për të kuptuar thellë vartësit, që padyshim janë të lidhur me detyrën dhe me ndryshimet që duhet të ndërmarrin në mënyrë që puna të japë më shumë kënaqësi.

Receta e suksesit për një drejtues kërkon: së pari, të krijojë reputacionin e njeriut krijues; së dyti, të rrethojë veten me bashkëpunëtorë që janë më të mirë se ai; së treti, t’i lërë ata të bëjnë punën. Pra aftësia për të krijuar, krahas krijimtarisë vetjake të drejtuesit, shihet edhe në metodologjinë e ndjekur prej tij për të shfrytëzuar aftësitë krijuese të vartësve e të bashkëpunëtorëve në të mirë të realizimit të detyrës, objektivit, misionit. Për këtë drejtuesi herë pas here duhet të pyesë vartësit e vet: “Si mund të të ndihmoj, si të ta lehtësoj më tej punën? Ç’praktikë e imja ta bën punën të vështirë. Ç’vendime e ç’shtil të shqetësojnë vërtet ty?” Në qoftë se drejtuesi nuk i bën të tilla pyetje ai vetëm sa do t’i prekë problemet, por nuk do t’i zgjidhë ato. Ju si drejtues mund të mendoni se po bëni një punë të madhe, ndërsa të tjerët në organizatë mund të harxhojnë mjaft kohë për të pakësuar pasojat e gabimeve tuaja. Prandaj, drejtuesi duke qenë vazhdimisht në kontakt me vartësit, duke ndjekur në vijimësi problemet, duke konstatuar çfarë shkon e çfarë nuk shkon, është në gjendje të krijojë situata të favorshme që mbështesin punën e vartësve aftësitë e tyre krijuese, të krijojë procedura të reja me qëllim që çdo gjë të kryhet e zbatohet sipas rregullave, normave e procedurave përkatëse.

Drejtuesit, gjithmonë duhet të jenë krijues të hapur. Drejtues të mirë janë vetëm ata mendja e të cilëve kurrë nuk mbyllet, ata të cilët janë të interesuar të dëgjojnë ide e pikëpamje të reja, që i hyjnë me zell zgjidhjes së çështjeve të reja¹⁸. Për shembull, edhe kur janë marrë vendimet një drejtues duhet të jetë i gatshëm të dëgjojë mendimet e kundërta dhe të vlerësojë ndryshimet dhe kushtet e reja që janë krijuar. Drejtuesit nuk duhet të ndryshojnë vazhdimisht mendjen, pasi kanë marrë një vendim të madh, por në qoftë se nuk vlerësojnë situatën, ata do të tregojnë kokëfortësi dhe intolerancë, të cilat do të sjellin shqetësime për organizatën.

¹⁷ Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721517, faqe 182.

¹⁸ Perri Smith, “Përgjegjësia”, Shtëpia Botuese e Ushtresë, Tiranë 1994, faqe 31.

Marrja e vendimit është një çast shumë i rëndësishëm në veprimtarinë krijuese dhe drejtuese, pasi ai është thelbi në bazë të të cilit do të planëzohet vijueshmëria e tërë punës së mëpastajme. Prandaj drejtuesi duhet të kuptojë dhe zotërojë procesin e marrjes dhe të zbatimit të vendimit. Si merren vendimet? Çfarë metodologjie ndiqet për t’i marrë ato? Ç’vendime lënë që t’i marrin vartësit? Cilat vendime duhet të miratojnë ata në autoritetin më të lartë? Këto janë disa lloj pyetjesh, të cilave drejtuesit duhet t’u japin përgjigje. Ata duhet të dinë gjithashtu si të zbatojnë vendimet sepse ato bëhen të pavlefshme në qoftë se mbesin vetëm në letër. Kjo është dhe arsyeja që drejtuesit duhet të dinë të zhvillojnë strategjinë e zbatimit. Ata duhet të gjejnë rrugën që vendimet të zbatohen me çdo kusht, të zbatohen me krijimtari në formë e në përmbajtje.

Një drejtues i mirë, angazhon stafin e tij në marrjen e vendimit, duke e moderuar konsultën në mënyrë të tillë, që të rezultojë kursi më i saktë i veprimit dhe vendimi të jetë produkt i stafit të vartësve dhe bashkëpunëtorëve, ku padyshim pjesëtar është edhe drejtuesi. Kjo bën që për zbatimin e plotë të çdo vendimi të kesh gjithmonë mbështetjen e padiskutueshme të vartësve të tu, që ju i keni angazhuar me maturi e profesionalizëm, duke u lënë në dorë hapësirën e nevojshme dhe fushën e përgjegjësisë për të dhënë idetë, mendimet e tyre dhe për të bërë vlerësimet përkatëse. Një sesion i zhvilluar për marrjen e vendimit është pothuajse i ngjashëm me “stuhi mendimesh”¹⁹, pasi përcaktimi i saktë i kurseve të veprimit kërkon shumë ide, pas kësaj bëhen analiza, gjykime, këndvështrime të ndryshme, seleksionime, lidhje të atyre të mbetura e deri sa arrihet përfundimi i duhur. Edhe në këtë proces është shumë e rëndësishme që të gjejnë zbatim kriteret e Osbornit²⁰ dhe kjo është përgjegjësi e drejtuesit.

Në qoftë se vartësve u jepet mundësi e plotë për të shprehur pikëpamjet e tyre para se të merret vendimi, ata do të jenë të gatshëm për ta zbatuar atë edhe sikur vendimi të mos jetë ai që do të kishin dashur ata. Kjo është e lidhur dhe me klimën dhe besueshmërinë e dyanshme midis drejtuesit dhe të drejtuarve. Gjenerali C. Powell-i e shpjegon thjesht këtë dukuri: *“Kur jemi duke debatuar për një çështje besnikëri do të thotë të më jepni mua opinionin tuaj të ndershëm,*

¹⁹ Koncepti “Stuhia e mendimeve” (brainstorming) jepet për herë të parë nga Alex Osborn-i, qysh nga fillimi i vitit 1939. Ai është një personazh legjendar i reklamave të viteve 40 të shekullit të kaluar. Për Osbornin, zgjidhja nuk ishte që vartësit të punonin të pavarur, por të shmangej kritika në grup. Kështu, ai krijoi konceptin “Stuhi mendimesh”, një proces gjatë të cilit pjesëtarët e grupit sjellin ide në një mjedis aspak gjykues. Teoria e Osbornit pati ndikim të madh për kohën dhe u përfaqua me entuziazëm nga drejtues të ndryshëm kompanish. (Shënimi i autorit)

²⁰ Katër rregullat bazë të konceptit “Stuhia e mendimeve” janë: 1. Mos i gjyko ose kritiko idetë e të tjerëve; 2. Shprehu i lirshëm, sa më e zgjuar ideja, aq më mirë; 3. Sasia është e rëndësishme, sa më shumë ide, aq më mirë; 4. Krijo ide të reja, mbështetur tek ato të kolegëve. (Susan Cain, “Pushteti i të heshturve”, Shtëpia Botuese “Living”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-216-59-5, faqe 92-93)

sido që ta mendoni, në e pëlqej unë apo jo. Mendimet e ndryshme në këtë fazë më stimulojnë mua. Por sapo të jetë marrë vendimi, debati mbaron. Që nga ky çast e tutje besnikëri do të thotë zbatimi i vendimit, sikur atë ta kishit marrë vetë”²¹.

Kjo metodë nuk vlen vetëm për nxitjen e ideve risi nga të tjerët, por është edhe një lloj prirjeje për të mbajtur mendjen të hapur. Jo më kot, Gjenerali amerikan Xhorxh Patoni këshillonte: “...Mos u thuaj kurrë njerëzve si t’i bëjnë gjërat. Thuaju atyre vetëm çfarë duhet të bëjnë dhe ata do të të habisin me mendjemprehtësinë e tyre”²². Drejtimi duke qenë imponim vullneti tek të tjerët është veprimtari e një grupi njerëzish të cilët duhen orientuar drejt prioritetëve kryesorë. Prandaj për drejtuesin është parësore njohja dhe përdorimi i parimeve të punës në grup duke gërshtuar me kujdes modelin e të menduarit me teknikat përfytyruese. Por gjithsesi, të krijosh dhe të marrësh vendime do të thotë të kesh një strategji të qartë mendimi, qëndrimi dhe sjelljeje. Aftësia për të krijuar e marrë vendime është një kualifikim kyç që kërkon të kuptosh e të konceptosh se mësohet çdo ditë dhe krijohen ide, mendime, si dhe përcaktohen metodologji apo metoda efikase për të vepruar me efikasitet dhe për të pasur sukses.

Përfundime

Krijimtaria është një proces i rëndësishëm për drejtuesin dhe organizatën pasi është i lidhur me suksesin dhe jetëgjatësinë e saj.

Një drejtues, një përqindje të caktuar të kohës së tij e kalon duke zgjidhur probleme vetë ose bashkë me të tjerët, që i shërbejnë drejtpërsëdrejti punës. Aftësia drejtuese për t’u përballur me vështirësitë dhe për t’i zgjidhur problemet, do të përcaktojë më shumë se çdo gjë tjetër, gjithçka që ndodh në karrierën e tij dhe në ecurinë e organizatës që drejton.

Megjithëse, krijimtaria është përgjegjësi e gjithsecilit, drejtuesi duhet të krijojë një mjedis të hapur që ta nxisë atë, ku secili të shfaqë talentin e tij krijues, duke orientuar të gjithë energjitë e tyre në përmbushjen e misionit. Ajo triumfon kur kemi kulturën që fuqizon procesin krijues. Krijimtaria nuk duhet të ndodhë vetëm njëherë apo në mënyrë sporadike. Mendo në mënyrë krijuese, rri me njerëz që janë krijues dhe përfshihen në procese krijuese. Kështu ju mund të ndani me ta pasionin për krijimtari dhe ta forconi këtë pasion. Shpërbleni krijimtarinë. Bëjini njerëzit të ndihen që po bëjnë një punë të shkëlqyer. Inkurajojini të bëjnë më shumë.

²¹ Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999, faqe 237.

²² Perri Smith, “Përgjegjësia”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994, faqe 22.

Njerëzit krijues nuk janë të kënaqur me atë që kanë arritur. Ata, vazhdimisht kanë pritshmëri të larta, duke kërkuar zgjidhje të reja problemore. Ata kanë qartësi për atë që dëshirojnë të arrijnë, dinë të ndërthurin gjykimin me fantazinë, kureshtjen me elasticitetin për të dhënë zgjidhjet e duhura, për të shmangur pengesat e ndryshme dhe për ngritur “stekën” e standardeve.

Krijimtaria është proces i pafund. Drejtuesi, nëpërmjet strukturave përkatëse duhet të inkurajojë dhe të mbështesë idetë e reja; duhet të parashikojë një buxhet për të investuar në projektet e reja premtuese; duhet të tërheqë talentet e nevojshëm për të zbatuar këto ide.

Hapësira të pafundme për aspektet e reja, këputja e “prangave” dhe braktisja e zakoneve “të dashura” të rutinës së përditshme, për të siguruar rrugë të lirë për shndërrime të reja e të suksesshme është një çështje parimore në veprimtarinë krijuese. Dhuntia krijuese e njerëzve duhet të përcaktojë drejt gjykimin e qëllimit dhe zgjidhjen e problemit, si dhe shmangien e propozimeve jo të rëndësishme. Personeli dhe përmasat specifike të grupeve të punës si dhe strukturat e tyre, ndikojnë drejtpërsëdrejti mbi krijimtarinë.

Për të inkurajuar krijimtarinë dhe inovacionin brenda organizatës, gjithashtu duhet të evidentohen disa faktorë me rëndësi të veçantë: këto kanë të bëjnë me elemente njerëzore brenda organizatës, si respekti, besimi, përkushtimi dhe mirënjohja.

Bibliografia

1. Susan Cain, “Pushteti i të heshturve”, Shtëpia Botuese “Living”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-216-59-5.
2. Alastair Campbell, “Fitimtarët dhe si arrijnë suksesin”, Shtëpia Botuese Universitare “UET Press”, Tiranë 2015, ISBN: 978-9928-190-55-0.
3. Grant Cardone, “10 X: Rregulli i vetëm që bën dallimin ndërmjet suksesit dhe dështimit”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Viti 2020, ISBN: 978-9928-2611-2-8.
4. Dale Carnegie & Associates, “Si të bëhesh udhëheqës i zoti”, Shtëpia Botuese “Pema”, Viti 2019, ISBN: 978-9951-721-77-6.
5. Daniel Goleman, “Inteligjenca emocionale”, Shtëpia Botuese “Pema”, Prishtinë 2018, ISBN: 978-9951-721-51-7.
6. Ryan Holiday, “Pengesa është rrugëdalja”, Shtëpia Botuese “Minerva”, Tiranë 2019, ISBN: 978-9928-265-13-5.
7. John C. Maxwell, “Si mendojnë njerëzit e suksesshëm” Shtëpia Botuese “Bota shqipëtare”, Tiranë 2020, ISBN: 978-9928-00-455-0.

8. Vasil Naçi, Alma Bici, “...Është rruga jonë, rruga drejt suksesit në Group”, botuar nga Agna Leadership Academy, Viti 2015.
9. Vasil Naçi, Alma Bici, “Roli i marketingut dhe Kreativiteti”, botuar nga Agna Leadership Academy, Viti 2012.
10. Brian Tracy, “Kreativiteti dhe zgjidhja e problemeve” Shtëpia Botuese “Damo”, Prishtinë 2015, ISBN: 978-9951-642-38-5.
11. Brian Tracy, “Ndryshoni të menduarit tuaj, ndryshoni jetën tuaj, si të zbulosh potencialin tënd për sukses e arritje”, Botimet Elta BS, Viti 2009, ISBN; 987-9951-544-08-5.
12. Q. Orhani, E. Braneshi, M. Cukalla, “Udhëheqja Ushtarake 2”, shtypur në Shtypshkronjën “Grand Prind”, Tiranë 2011.
13. Kolin Pauell, “Udhëtimi im amerikan”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1999.
14. Perri Smith, “Përgjegjësia”, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1994.
15. FM 6-22, Army Leadership Competent, Confident, and Agile, October 2006.

Përgatitja dhe zhvillimi i oficerëve të sotëm për mënyrat e reja të luftës së nesërme

Nënkolonel (R) Msc. Besnik DACI
Specialit në IKSHU

Trajtesë e shkurtuar.

Natyra e re ndryshuese e luftës dhe e konflikteve në shekullin e 21-të, kërkojnë të transformojmë zhvillimin e drejtuesve ushtarak, për t'i përgatitur me sukses, për luftëra të reja që vendi ynë mund të përballet në të ardhmen.

Qëllimi është të edukojmë oficerë dhe të përcjellim tek ata aftësitë e duhura, për realizimin me sukses të misionit dhe detyrat themelore të FA, në kryerjen e spektrit të plotë të operacioneve ushtarake, në kuadër të angazhimeve kombëtare e ndërkombëtare, të “Armatosur” me strategji, që mendojnë në mënyre kritike dhe mund të aplikojnë ide të reja, në fuqinë ushtarake për të kontribuar në strategjinë e sigurisë kombëtare dhe atë ushtarake dhe për të luftuar në të gjitha kushtet dhe rrethanat.

Kjo temë, ofron vizionin e përgatitjes dhe zhvillimit të oficerëve të sotëm për mënyrat e reja të luftës së nesërme, për rezultatet që kërkojnë, ju ofron udhëzime për t'i arritur ato. Ka si synim të udhëheqë zhvillimin e strategjive të reja të drejtuesve, ofrimin e talenteve dhe menaxhimin e tyre, si dhe të formojë drejtues ushtarak të niveleve të ndryshme për nevoja të kombit.

Fjalë kyçe: Arsimi Ushtarak Profesional (AUP); Arti i luftës; fuqia ushtarake; qasje shtrirëse dhe holistike; forca e përbashkët; forca e përbashkët e bashkuar; elitë ushtarake; operacione të integruara; inovacion; sinergji.

1. Zhvillimi i oficerëve të sotëm për mënyrat e reja të luftës së nesërme

Për të mbrojtur arritjet tona të deritanishme dhe aftësitë për tu përshtatur e për të synuar vlerat më të mira jo vetëm kombëtare por edhe më tej, duhet që më shumë se sa blerja e pajisjeve ushtarake; të fitojmë dhe të mbajmë përparësitë intelektuale. Gjithashtu, duhet të aplikohet komunikimi dhe efektshmeria e forcës në mënyrë të përshtatshme për të parandaluar, luftuar dhe fituar kundër kundërshtarëve tanë. Kjo nuk mund të arrihet pa përmirësimin e konsiderueshëm të kapaciteteve zbuluese të luftëtarëve të përbashkët, për të krijuar, projektuar dhe zbatuar strategji integruese, për të treguar aftësitë tona përkrah vendeve të NATO-s, për të sfiduar kundërshtarët që sjell koha, dhe për të reaguar ndaj aktiviteteve që nuk sjellin konflikte të armatosura.

Shekulli i 21-të kërkon që oficerët tanë të jenë më shumë të arsimuar dhe më të aftë për të drejtuar dhe integruar instrumentin ushtarak të kombit tonë. Kapacitetet intelektuale të përshkruara më lartë zhvillohen gjatë një karriere dhe jo si rezultat i mundësive edukative episodike, sidomos kur ato mundësi nuk janë as aktuale as rigoroze. Përkundrazi, këto aftësi përmirësohen gjatë mijëra orësh praktike dhe pune, duke zgjeruar kufijtë njohës dhe performancën intelektuale.

Karriera e një oficeri duhet të jetë e dizajnuar për të zhvilluar, përshtatur dhe ushtruar vazhdimisht aftësi intelektuale të reja, sidomos në ecurinë e karrierës e deri në gradat më të larta.

Për të arritur qëllimin për zhvillim të drejtuesve, nevojitet një trajektore e re për Arsimimin Ushtarak Profesional, (AUP) që duhet të përfshijë sisteme të lidhura të menaxhimit të talenteve. Vizioni duhet të jetë për një AUP dhe sistem të plotë të menaxhimit të talenteve, që identifikojnë, zhvillojnë dhe përdorin lidhshmëri me strategji, të cilët mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative në artin e luftës dhe në aplikimin praktik dhe etik të fuqisë luftarake.

2. Mjedisi i sigurisë dhe operacionet globale të integruara

Deri më tani, programet tona të AUP kanë prodhuar oficerë që i kanë shërbyer me nder vendit tonë dhe Forcës së Përbashkët në strukturat e NATO-s. Strategjia e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjia Ushtarake bëjnë të qartë se mjedisi ynë i sigurisë po ndryshon. Kthimi i konkurrencës së fuqishme rrit stërvitjen dhe inovacionin. Ndërsa ndryshimi është i përbashkët në kuptimin tonë të karakterit të luftës, shpejtësia e rritjes dhe konvergjenca e teknologjive të reja parashikon ndryshime dramatike në mënyrën se si zhvillohen konfliktet dhe, kështu, kërkon ndryshim të thellë në mënyrën tonë për të planifikuar dhe ekzekutuar operacionet. Për të arritur suksesin në parandalimin ose fitimin e konflikteve të ardhshme, ne duhet të adaptojmë gjithashtu ndjeshëm shërbimin tonë të zhvillimit të drejtuesve dhe të mos shmangemi nga ndryshimet themelore kur të jetë e nevojshme. Për Forcën e Armatosur, ndryshimet në

karakterin dhe kryerjen e luftës dhe operacioneve kërkojnë:

- Integrim të vazhdueshëm të instrumenteve kombëtare të pushtetit dhe ndikimit në mbështetje të objektivave kombëtare;
- Mendim kritik, strategji në gjithë spektrin dhe struktura të tjera të përbashkëta.
- Përdorim qasje kreative për luftën në mbrojtjen e vendit dhe fushatat e përbashkët me aleatët;
- Bashkëpunim dhe integrim të efektshëm i koalicionit, me aleatët, partnerët ndërkombëtarë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti;
- Kuptimi më i thellë i pasojave të teknologjive të rrezikshme dhe të ardhshme për kundërshtarët dhe veten tonë.

Këto kërkesa intelektuale në zhvillimin aktual të drejtuesve tanë nuk kanë qenë fokusi ynë i vetëm. Ne mund të bëjmë më të mirën në lidhje me zgjedhjen e studentëve tanë, shkollën ku ata studiojnë dhe çfarë ata mësojnë aty, profilet e tyre, dhe detyrat e tyre të mëtutjeshme. Ne duhet të përcjellim mendim kritik dhe kreativ, mësim të vazhdueshëm dhe zhvillim profesional, të identifikojmë bashkërisht detyrat e mëtutjeshme që vazhdojnë të ushtrojnë dhe ndërtojnë kapitalin intelektual të rikrijuar përmes AUP-së. Vendit tonë i nevojiten liderë luftarakë dhe oficerë stafi të aftë për të zhvilluar dhe udhëhequr në një mjedis dinamik, globalisht të integruar. Ne nuk mund të mbështetemi thjesht në masë ose në teknologjinë më të mirë. Sot dhe në të ardhmen, teknologjia mund të jetë në duart e kundërshtarëve tanë. Puna jonë është të mësojmë si të aplikojmë aftësitë tona më mirë dhe në mënyre me kreative.

Këto kërkesa rrisin kërkesat në vazhdimësinë e zhvillimit të drejtuesve tanë që ende nuk i plotësojmë. Thjesht, ne kërkojmë liderë në të gjitha nivelet që mund të arrijnë nivelin apo mbizotërim intelektual kundër kundërshtarëve. Për të arritur këtë, duhet inovacion dhe përshtatja nëpërmjet programeve tona AUP, dhe përpjekjeve të menaxhimit të talenteve për të zhvendosur politikat tona, sjelljet dhe kulturat në përputhje me ndryshimin e karakterit të luftës. Kapacitetet njohëse që këta drejtues sjellin në operacionet e integruara globalisht nuk janë thjesht produkt i një kursi 10-mujor; ato janë produkt i një Etosi (karakterit) të zhvillimit profesional të qëndrueshëm gjatë karrierës dhe një vazhdimësie të edukimit/mësimit.

3. Statet e preferuara të vazhdimësisë së mësimdhënies

Zhvillimi i liderëve kërkon një qasje shtrirës dhe holistike¹ në nivelin e shërbimit të përbashkët. Zhvillimi i përbashkët i liderëve për shekullin 21-të, është produkti i një vazhdimësie të mësimit të përbërë nga trajnime, përvojë

¹ https://sq.wikipedia.org/Edukimi_holistik_-_Wikipedia_

stafi dhe operacione, arsim, ushtrime, vetëzhvillim dhe përmirësim. Për të arritur mbizotërimin intelektual kundër kundërshtarëve, duhet të prodhohmë oficerë më të aftë, më të ushtruar dhe më kritikë. Atributet e liderit të dëshiruar dhe udhëheqësit në këtë drejtim. Më poshtë është vizioni për stafet e fundit të vazhdimësisë së edukimit/mësimi të përmirësuar për AUP dhe menaxhimin e talenteve.

Stafet e fundit të detyrueshme të AUP.

Programet AUP duhet t'i sigurojnë studentëve njohuritë dhe aftësitë fillestare për t'i përgatitur ata për shërbim si drejtues luftarakë të përbashkët, oficerë, si stafi më të lartë të elitës ushtarake, që:

- perceptojnë dimensionet ushtarake të një sfide që prek interesin kombëtar, çështjet në nivelin e politikës dhe të rekomandojnë opsione ushtarake të qëndrueshme brenda strukturave mbizotëruese të operacioneve kombëtare dhe ato globalisht të integruara;
- parashikojnë dhe udhëheqin adaptimin dhe inovacionin e shpejtë gjatë një periudhe dinamike të përshpejtimit në shkallën e ndryshimit në luftë nën kushtet e konkurrencës të fuqisë dhe teknologjisë;
- kryejnë luftë të përbashkët, në nivelet operative dhe strategjike, si në të gjitha hapësirat, pjesëmarrje në luftë globale të integruar, duke përfshirë aftësinë për të integruar kontributet tona me ato të aleatëve dhe partnerëve; dhe
- janë drejtues që mendojnë strategjikisht ose elitë në mënyrën se si janë të aftë për të aplikuar dhe që mund të ekzekutojnë dhe të adaptojnë strategjinë përmes fushatave dhe operacioneve. Të gjithë absolventët² duhet të posedojnë aftësitë e mendimit kritik dhe krijues, inteligjencën emocionale dhe aftësitë efektive të komunikimit të shkruar, të folur dhe të vizualizuar për të mbështetur zhvillimin dhe implementimin e strategjive dhe operacioneve komplekse.

Programi/kurrikula arsimore duhet rivlerësuar për t'iu përshtatur e përgjigjur sfidave që shtrën Strategjia e Sigurisë Kombëtare me ndryshimet përkatëse, ky program i kohës nuk është një rastësi, as nuk vjen lirë; ai duhet të vijë si rezultat i një dizajni me ndryshimet e ndodhura dhe të parashikuara në të ardhmen, i integruar me fakultetet më të mira të vendit tonë dhe vendeve të Aleancës. Zhvillimi i mëtejshëm dhe menaxhimi i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në sistemin e AUP kërkon kujdes më të shtuar.

Ne duhet të inkurajojmë oficerët e duhur të ndjekin detyrimet e fakultetit dhe shërbimet të lehtësojnë këto detyrime. Kështu, shërbimet duhet të zbatojnë një gamë të plotë të programeve të menaxhimit të talenteve për të inkurajuar detyrimet e fakultetit. Një detyrim fakulteti duhet të jetë konkurrues, të përmirësojë karrierën, të theksohet gjatë bordit të promovimeve dhe të ndiqet

² <https://sq.wikipedia.org/wiki/Absolventi>.

për të siguruar që detyrimet e mëtejshme të përfitojnë nga aftësitë e fituara. Një ndryshim kulturor i këtij procesi kërkon që drejtuesit, në të gjitha nivelet, të vlerësojnë në mënyrë kooperative detyrimet e fakultetit, të eliminojnë pengesat që bllokojnë progresin, dhe të hiqet çdo stigmë që zvogëlon rëndësinë e edukimit të liderëve të ardhshëm. Në këtë mënyrë, duhet të marrim në konsideratë kreditet e përbashkëta për detyrimet e fakultetit në programet e akredituara të AUP, duke lejuar dhe programet tona të dominojnë në disa pozita si të përbashkët.

Ne duhet të shpërblejmë talentet me forma e metoda të ndryshme; tërheqim, zhvillojmë dhe mbajmë fakultetin profesional të lartë (FMS) cilësor në institucionet tona të edukimit/mësimit ushtarak; dhe të bashkëpunojmë me fakultetet profesionale civile me akreditimet për të mësuar në nivelet e kërkuara. Për shkak se kurrikulat e AUP duhet të jenë dinamike si mjedis, fakulteti duhet të jetë plotësisht i gatshëm për mësimin praktik, hulumtimin dhe dizajnin e kursit, dhe për vlerësimin, përmirësimin dhe integrimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Suksesi gjithashtu kërkon që të investojmë plotësisht në arkitekturën tonë akademike të mbështetjes. Përveç objekteve tona, duhet të sigurojmë burime, të mbajmë dhe të mbrojmë funksionet e rëndësishme të mbështetjes akademike, përfshirë teknologjinë e edukimit dhe informacionit dhe aktivitetet organizative të nevojshme për të fuqizuar fakultetin dhe për të mundësuar studentët të arrijnë rezultatet e kërkuara me përgjegjësitë që duhet të arrijë.

3.4. Të konsiderojmë AUP si një pasuri strategjike³.

Ne duhet të përdorim programet dhe kurrikulat e AUP-së si një pasuri strategjike për të ndërtuar besim dhe operacionalitet në të gjithë Forcën e Armatosur dhe për t'u integruar me aleatët dhe partnerët ndërkombëtarë. Për të përparuar në këtë element:

- Institucionet tona të AUP-së duhet të jenë një strukturë fleksibël dhe të prirur për adaptim. Bashkëpunimi në rrjetin tonë AUP përmirëson programet tona, ndërton sinergji dhe kuptim më të thellë, dhe na lejon të përqendrohemi në problemet kyçe. Në proces, enti i edukimit mund të shërbejë studentëve/kursantëve ushtarakë me studime dhe hulumtime rigorozë, zhvillim konceptesh dhe dizajnimin e ushtrimeve. AUP duhet të jetë dinamik. Për të mbetur relevante, duhet të vlerësojmë periodikisht programet tona, të validojmë misionet dhe fokuset, si dhe të përcaktojmë boshllëqet dhe nevojën për programe të reja. Në të njëjtin kohë, duhet të përpiqemi për të bërë entin tonë AUP të qasshëm për Forcën tonë të Armatosur dhe të mbështesim programet e zhvillimit vetjake dhe të zhvillimit profesional të Forcave e njëjse, duke

³ <https://www.jcs.mil/doctrine/>.

njohur që këto t'i përgjigjen misionit bazë.

- Ne duhet të vazhdojmë të përfshijmë dhe shkëmbejmë eksperiencën në studime brenda sistemit tonë AUP dhe sistemet arsimore ushtarake jashtë vendit, studentët tanë dhe ato aleatë dhe partnerë, për të përgatitur më mirë oficerët tanë për operacione të përbashkëta. Marrëdhëniet e forta mes institucioneve AUP janë gjithashtu të rëndësishme për tu integruar në programet e AUP të vendeve të tjera aleate në mënyrë që ne të zhvillohemi, duke krijuar mundësi për lidhje më të ngushta dhe bashkëpunim më të thellë, si dhe për pjesëmarrje më të madhe të studentëve tanë.

- Ne duhet të përfshijmë si Forcën e Armatosur ashtu edhe civilë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe dikastere të tjera të vendit dhe vendeve aleate në programet e zhvillimit në nivelin më të lartë të AUP për të siguruar që ata të kontribuojnë në të ardhmen. Gjithashtu, duhet të forcojmë perspektivat tona me institucionet e tjera të vendit tonë dhe ato partnere.

3.5. Të rregullojmë edukimin dhe përdorimin e talentit.

Përdorimi me qëllim i të diplomuarve të AUP është një detyrë themelore që lidhet drejtpërdrejt me rezultatet më të mira të procesit. Sot kërkohen procese efektive për caktimin dhe përdorimin e personelit të diplomuar në AUP për të siguruar që në detyrat e marra gjatë karrierës të përfitojnë nga arritjet akademike dhe edukimi i marrë. Ne duhet të përdorim me qëllim përvojën akademike, hulumtimin dhe mësimin eksperimental të të diplomuarve të AUP-së në një shkallë më të madhe. Duhet të sigurojmë që vlerësimet akademike të kapin arritjet dhe ekspertizën e oficerëve për të ndihmuar proceset e menaxhimit të talenteve. Për të arritur vizionin e përcaktuar këtu, duhet të shpërblejmë oficerët ekselent me detyra të përshtatshme dhe potencialin për të mbetur konkurrues në karrierën e tyre. Gjithashtu, duhet të sigurohemi që po prodhojmë një numër të mjaftueshëm oficerësh të kualifikuar të përbashkët në sistemin tonë AUP për stafet e strukturave të FA dhe ato të përbashkëta.

3.6. Të përdorim ushtrime të përbashkëta.

Përdorimi i ushtrimeve gjithashtu është një pjesë kyçe e vazhdimësisë të edukimit ushtarak. Ne duhet të jemi të gatshëm të vendosim pjesëmarrësit në ushtrime në situata të paqartësisë dhe kompleksitetit, ku krijimi, adaptimi, mendimi kritik dhe iniciativa janë theksuar dhe treguar. Planifikimi dhe zbatimi i aftësive të avancuara duhet të jetë një pjesë kyçe e këtyre ushtrimeve për të përforcuar kapacitetet në zhvillim, për të njohur problemet dhe mundësitë dhe për të nisur marrjen e vendimeve të shpejta si një aspekt themelor i operacioneve të integruara të përbashkëta. Ushtrimet tona të përbashkëta duhet të përdoren si një mekanizëm rregullator që lidh çështjet dhe edukimin në zhvillimin tonë të udhëheqjes dhe sistemin tonë AUP. Në anën tjetër, studiuesit/kërkuesit dhe

pedagogët tanë në AUP mund të kontribuojnë me studimet e tyre edukative për të mbështetur gjithashtu drejtuesit ushtarak.

3.7. Të identifikojmë dhe zhvillojmë elitë ushtarake.

Ne kemi nevojë për një grup të zgjedhur oficerësh që mund të kontribuojnë në mënyrë të kuptueshme në formulimin e strategjive. Vendi (Forcat e Armatosura) ka nevojë për procese për të identifikuar dhe zhvilluar elitë, jo vetëm planifikues operacionale dhe fushatë, por edhe shkollat AUP dhe oficerët gjenerues, duhet të luajnë një rol aktive në identifikimin e talenteve elitë dhe inovatorë. Shkollimi civil i avancuar, bursat dhe mundësitë për zgjerim ofrojnë një përmirësim të vlefshëm për sistemin tonë AUP, por duhet të kenë rezultate të qarta dhe nuk kualifikohen si pjesëmarrës në AUP. Një numër i zgjedhur i studentëve në programet tona AUP do të tregojnë potencialin për të qenë më shumë se elitë ushtarake; ata gjithashtu do të kenë aftësi për të dizajnuar kreativitet, strategji politiko-ushtarake të integruara ose për të zhvilluar koncepte doktrinare të reja.

Si rrjedhojë, duhet të krijojmë dhe të ruajmë mundësi në kurrikulat tona për specializim. Ne duhet të identifikojmë këtë elitë ushtarake dhe të përshtatim programe për ta zhvilluar mendimin dhe kontributet e tyre.

Përfundime

Sot, ballafaqohemi me një të ardhme që kërkon ndryshime tërësore nga e sotmja, për të arritur rezultatet e pritshme të së nesërme, për këtë ne duhet të identifikojmë dhe të zgjedhim oficerët që tregojnë përparësi intelektuale dhe që mund të zgjidhin situata përpara kundërshtarëve tanë në luftë mes pasigurisë dhe ndryshimeve të sotme. Krijimi i superioritetit intelektual dhe gatishmëria mendore që ne kërkojmë nuk mund të arrihet me edukim sporadik ose vetëm me përvojë të mëparshme. Ai krijohet nga kombinimi i edukimit, trajnimit, ushtrimeve rigorozë dhe zbatimit në botën reale. Për të përmbushur këtë objektiv, duhet një rrugë e përhershme e transformimit që duhet të filluar. Kërkohen përpjekje të përbashkët në të gjithë FA, për të vendosur bazat për të zbatuar këtë vizion. Rezultati do të jetë një ndryshim kulturor dhe intelektual në FA. Një investim në aspektet njohëse të profesionit tonë nuk është i mjaftueshëm. Ne duhet të sigurojmë që të zhvillojmë mekanizma që integrojnë programet e AUP dhe menaxhimin e talenteve, duke vlerësuar dhe përmirësuar vazhdimisht, duke lëvizur zhvillimin e drejtuesëve ushtarak në rrugën tonë më të arrirë, pra AUP, për të adresuar me krijimtarinë nevojat tona më të rëndësishme luftarake.

Bibliografia

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e RSH 14/2024.
2. Strategjia Ushtarake 2024.
3. Intellectual preparation for future war, by; Mick Ryan.
4. Arsimimi dhe Stërvitja në Forcat e Armatosura Dhjetor 2015.
5. Koncepti i arsimimit dhe trajnimit individual të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
6. <https://www.jcs.mil/doctrine/>.

Realiteti virtual dhe përfitimi i tij në Forcat e Armatosura

Kryekapter Gëzim Mataj

Nënoficer në Regjimentin e Operacioneve Speciale

Trajtesë e shkurtuar.

Realiteti virtual (RV), po shfaqet me shpejtësi si një fushë e re e kërkimit multidisiplinor. Gjatë dy viteve të fundit, qëllimi i tij është rritur përtej kërkimit akademik dhe industria është gjetur duke bërë investime të rëndësishme në këtë fushë si për kërkimin, ashtu edhe për prodhimin e zhvillimit të produkteve të ndryshme të bazuara në RV. Sektorë të ndryshëm industrialë si teknologjia e informacionit, inxhinieria biomjekësore, sektori i teknologjisë së projektimit strukturor dhe ndihmës trajnimit po investojnë në këtë teknologji. Industria ushtarake e cila mbetet gjithmonë në kërkim të ideve të reja po shfaqet ngadalë si një nga investitorët kryesorë në RV. Ky shkrim paraqet një vlerësim rreth rëndësisë së RV për Forcat e Armatosura të RSH.

Fjalë kyçe: Realiteti virtual (RV), bota reale, simulatorët e botës virtuale, luftë, ushtri.

Hyrje

Realiteti virtual (RV) është një nocion shekullor. Por, në vitet e kaluara nuk ishte artikuluar në mënyrën se si bëhet në kohën e sotme. Shumë breza më parë, filozofi grek Platoni (427-347 p.e.s.) u kishte ofruar sundimtarëve të atëhershëm një perspektivë në lidhje me vendimmarrjen politike. Ai u kishte kërkuar atyre që vendimet politike t'i merrnin në mënyrë rigorozë në bazë të njohurive të caktuara dhe jo në bazë të intuitës. Për të shpjeguar argumentin e tij, ai kishte paraqitur një metaforë në formën e “të burgosurve të bllokuar

në shpellë”. Ky formulim paraqet një pikëpamje se njerëzit që kanë kaluar jetën e tyre në shpellë të lidhur me zinxhirë, fillojnë t’i besojnë si të vërteta “hijet” që i shohin në errësirë. Platoni donte që klasa politike të ndante hijet nga substanca. Ndoshta, Platoni mund të shihej se po parashtronte konceptin analog me realitetin virtual në ato kohë. Mund të jetë e diskutueshme nëse ai e shpalli apo hoqi dorë nga koncepti i realitetit virtual; megjithatë, ai ishte padyshim instrumental në nxjerrjen në pah të manifestimit të dukshëm të realitetit “alternativ”. Me kalimin e viteve, koncepti i realitetit virtual ka evoluar ndjeshëm. Në veçanti, zhvillimet e rëndësishme që po ndodhin në fushën e sektorit të teknologjisë së informacionit kanë revolucionarizuar ndjeshëm terrenin e realitetit virtual. Aktualisht, aplikacionet e realitetit virtual po gjejnë shërbime në fusha të ndryshme të jetës, nga shkencat kompjuterike në inxhinierinë mekanike, tek inxhinieria biomjekësore, te mjekësia dhe arkitektura. Forcat e armatosura gjithashtu po identifikojnë aplikacione të ndryshme të bazuara në RV, për përdorimin e tyre. Duket se kjo teknologji ka të ngjarë të gjejë më shumë dobi për forcat e armatosura në vitet në vijim. Ky punim tenton të analizojë efikasitetin e kësaj teknologjie për arkitekturën e sigurisë të shteteve.

1. Ideja e realitetit virtual

Ashtu si shumë zbulime të tjera shkencore, realiteti virtual i ka rrënjët në romanet dhe esetë fantastike-shkencore. Përvoja e parë e RV, mund të thuhet se erdhi në vitin 1962, me krijimin e makinës së quajtur “Sensorama” e cila në thelb ishte lojë duke i dhënë lojtarit një përvojë të ngasjes së një motoçiklete në rrugë.

Kjo u zhvillua nga Morton Heilig i cili me profesion ishte kinematografik. Qëllimi i tij ishte të bashkonte të pesë shqisat në një përvojë virtuale. Që atëherë, realiteti virtual e ka bërë të ndjehet prania e saj kryesisht në arenën e argëtimit, veçanërisht për zhvillimin e lojërave video dhe filmave. Aktualisht, fusha e RV po rritet shumë përtej industrisë së argëtimit dhe mbulon një spektër të gjerë idesh në fushën e përgjithshme të teknologjisë. Ndoshta, natyra përfshirëse e kësaj teknologjie po e bën të vështirë përcaktimin e realitetit në terma të saktë.

Është e vështirë të gjesh përkufizimin standard për RV në literaturë. Sidoqoftë, duket se kanë një kuptim të përbashkët për atë që katërbëjë realiteti virtual, endryshme gjendet vetëm në semantikë nga autori në autor. Termi RV u krijua nga Jaron Lanier, themeluesi i VPL (Virtual Programming Language) Research në SHBA, një nga shtëpitë origjinale të biznesit që shet sisteme të RV. Termi u përkufizua si “një mjedis i krijuar nga kompjuteri, interaktiv, tredimensional në të cilin një person është i zhytur (Aukstakalnis dhe Blatner 1992)”. Në mënyrë të thjeshtë,

RV është një mjedis artificial i krijuar duke përdorur mjete të teknologjisë së informacionit (si Harduer ashtu edhe Softuer) dhe i paraqitet përdoruesit në atë mënyrë që të duket dhe të ndihet si çdo mjedis real. Është e rëndësishme të theksohet se bota virtuale është ndërvepruese, gjë që e bën përdoruesin të zhytet plotësisht në një botë artificiale larg mjedisit real. Për të përjetuar RV, individit duhet të përdorë dy nga pesë shqisat e tij: shikimin dhe zërin. Për të përjetuar/ndjerë kryesisht imazhet tredimensionale, përdoren pajisje të tilla si modulatorët e frekuencës, mausi, leva, kufjet, dorezat speciale, ekrani i montuar në kokë dhe syzet. Të gjitha këto pajisje punojnë në hyrje nga një sistem kompjuterik. Është e rëndësishme të theksohet se kryesisht nuk është e mundur të krijohet një kopje e saktë e botës reale. Gjithmonë do të kishte një lloj ndryshimi midis botës reale dhe asaj virtuale. Prandaj, ekzistojnë dallime thelbësore midis botës reale dhe asaj virtuale. Një punë e cila në fakt është e thjeshtë rezulton të jetë shumë e vështirë në një mjedis të RV si nga pikëpamja e projektimit ashtu edhe nga ana e ekzekutimit.

Një veprim i thjeshtë i mbajtjes së topit në dy duar është shumë i ndërlikuar në botën virtuale. Në realitet, një top mbahet, i mbajtur me dy duar, pozicioni i duarve përcaktohet nga sipërfaqja e topit dhe kontrolli i topit sigurohet nga haptika (haptika = prekja = lidhja) dhe shqisat vizuale të njeriut. Në një mjedis virtual, ku nuk sigurohet reagime haptike, kontrolli i topit duhet të kryhet ekskluzivisht nga sistemi vizual.




Figura nr. 1.

Mbajtja e një topi me dy duar virtuale; duart opake tregojnë pozicionet e duarve virtuale, duart me kornizë teli tregojnë pozicionet e duarve reale të përdoruesit.

Ato, ndryshe nga duart virtuale, janë në gjendje të depërtojnë në top.

Ka disa aspekte që e bëjnë shumë më të vështirë kontrollin e topit në mjedisin virtual sesa në realitet. Prandaj, përdoruesi duhet të trajnohet për të punuar në një atmosferë në të cilën ai/ajo nuk po mban vërtet një top (në fakt ai/ajo nuk

mban asgjë), ai/ajo duhet të pozicionojë duart e tij/saj të vërteta sipas lëvizjes vizuale të riprodhimit të duarve të tij. Kjo shkakton një stimulim krejtësisht të ndryshëm të muskujve të përdoruesit sesa me një top të vërtetë (pa peshë dhe pa kundërforsa nga topi). Gjithashtu, cilësia e pozicionit të riprodhimit të topit dhe të duarve në shumicën e rasteve nuk është perfekte (Fig. 1).

Industria e argëtimit e cila përdor teknikat e realitetit virtual në mënyrë rutinë po përpiket të improvizojë konceptin ekzistues të realitetit virtual. Ideja e 4D dhe realitetit virtual, ka rëndësinë e saj më shumë për industrinë e argëtimit. Termi “4D”, tregon të katërtin dimension. Ky koncept nuk ka nevojë të përfshijë domosdoshmërisht ndonjë rol kryesor për Softuerin kompjuterik, por përfshin më shumë efekte fizike. Këtu spektatorët mbajnë syze 3D dhe sipas kërkesës së skenës së veçantë, teatrot janë krijuar për të tundur, spërkatur ujë, për të futur erëra dhe madje edhe për të spërkatur ajrin tek publiku për të gjeneruar efekte të ndryshme. Ka pak ide të tjera në praktikë që fabrikojnë realitetin. Realiteti i shtuar është një ide e tillë që ka të bëjë me pamjen e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një mjedisi fizik të botës reale. Këtu elementët e realitetit të shtuar nga kompjuteri virtual gjeneron të dhëna shqisore si zëri ose grafika. Nëse realiteti virtual është një zhytje e plotë në një botë digjitale, realiteti i shtuar është më shumë një mbivendosje digjitale në botën reale.

Ai e shton botën reale me të dhëna digjitale duke e bërë atë më emocionues sesa një mjedis krejtësisht fiktiv.

Një shembull i realitetit të shtuar mund të jetë dëshmimi i botës përreth nesh, siç shihet përmes kamerës së telefonit tonë, e krahasuar me hyrje të tjera si informacioni i vendit të bazuar në GPS (Schonfeld 2011). Një koncept tjetër shumë i diskutuar në këtë fushë është ai i realitetit të ndërmjetësuar. Këtu pamja e realitetit modifikohet nga një praktikant kompjuteri që përmirëson perceptimin aktual të realitetit. Një nocion tjetër i ngjashëm është një realitet i përzier. Është një lloj realiteti virtual, por një koncept më i gjerë se realiteti i shtuar, i cili shton botën reale me të dhëna elektronike sintetike. Në anën e kundërt, ekziston një term, virtualiteti i shtuar, i cili përmirëson mjedisin virtual me të dhëna nga bota reale. Realiteti i përzier mbulon një vazhdimësi nga realiteti shtuar në virtual i shtuar Tamura et al.(2001). Aktualisht, literatura dhe debatet e ndryshme në vazhdim mbi temën e realitetit virtual, pikëpamjet e shkencëtarëve që punojnë në këtë fushë dhe perceptimet e përgjithshme tregojnë se realiteti virtual përfshin fusha të mëdha dhe nganjëherë të larmishme idesh dhe teknologjish, duke përfshirë si teleoperatorët ashtu edhe sistemet e mjedisit virtual. Në vende të ndryshme, njerëzit përdorin terminologjitë si realiteti virtual, mjedisi virtual, telerobotika, realiteti i shtuar dhe mjediset sintetike në mënyrë

